



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për auditimin e ushtruar në “Gjykatën e Lartë” (GJL)

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

**“AUDITIM FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE MBI VEPRIMTARINË E
GJYKATËS SË LARTË”**

Tiranë, Shkurt 2023

PËRMBLEDHJE

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
I. Hyrja	8
1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit	9
2. Identifikimi i çështjes	10
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen.....	10
4. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:.....	10
5. Kriteret e vlerësimit	11
6. Standardet e Auditimit	12
7. Metodot e auditimit	12
8. Dokumentimi i auditimit.....	13
II. PËRSHKRIMI AUDITIMIT	14
2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit.....	14
2.1 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit.....	14
2.2 Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave	27
2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare	37
2.4 Auditimi i llogarive vjetore.....	41
2.5 Prokurimet e fondeve publike	52
2.6 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.....	58
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	61
V. ANEKSE.....	66

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Gjykatën e Lartë, më poshtë e emërtuar “GJL”, për periudhën nga data 01.01.2020 deri në 30.09.2022, me objekt “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë”.

Auditimi kishte në fokus gjashtë drejtime kryesore, sipas programit të miratuar me nr. 554/2 prot., datë 10.10.2022 dhe në të u angazhuan 3 (tre) auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi u përqendrua kryesisht në aktivitetin e GJL mbi planifikimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm të njësisë, procedurat e prokurimit publik, zbatimin e kontratave, mbajtjen e evidencës kontabël, menaxhimin e aktiveve etj.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilin prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, me zgjedhje, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë zhvillimit të këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë dhe financiar të KLSH-së, Rregullorja e funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH-së, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Bazuar në rezultatet e auditimit të GJL, për periudhën nga data nga data 01.01.2020 deri në 30.09.2022, grupi i auditimit me një siguri të arsyeshme ka dhënë opinion të pakualifikuar të përputhshmërisë dhe opinion të pakualifikuar për pasqyrat financiare.

Grupi i auditimit ka hartuar këtë Raport Përfundimtar auditimi, duke reflektuar edhe komentet e subjektit, sa i takon projektraportit të auditimit. Rezultatet dhe çështjet kryesore të këtij auditimi janë trajtuar në vijim të raportit përfundimtar, së bashku me konkluzionin e përgjithshëm dhe opinionin e auditimit.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
A/1	<p>Nga auditimi i pagave të gjyqtarëve u konstatua se, pavarësisht se kanë të njëjtin status kushtetues, kryejnë të njëjtën detyrë, me të njëjtën përgjegjësi dhe i nënshtrohen të njëjtave rregulla procedurale, materiale apo disiplinore, pagat e tyre janë të ndryshme:</p> <p>Në GJL janë të emëruar tre grupe gjyqtarësh, nga radhët e juristëve të spikatur, nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatave të Posaçme (shkalla e parë dhe apeli), si dhe nga radhët e gjykatave të apelit të juridiksionit të zakonshëm.</p> <p>- Gjyqtarët që kanë ardhur nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar përfitojnë, respektivisht, pagën e grupit</p>	<p><i>Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 27-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</i></p>	E lartë	<p>Në vijimësi të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 35, datë 22.11.2022, botuar në Fletoren Zyrtare me datë 09.01.2023, Gjykata e Lartë në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësorë të marrin masa për hartimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore mbi trajtimin financiar, sa më të drejtë dhe në masë sa më të përafërt të anëtarëve të GJL, pavarësisht se nga cila gjykatë apo karrierë</p>

<p>G3, së bashku me shtesën për vjetërsi, si dhe një shtesë për vështirësi pune, sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016 "<i>Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë</i>", në masën 80 për qind të pagës bruto fillestare. Ky detyrim që buron nga standardet e gjithëpranuara ndërkombëtarisht dhe që mishërohet edhe në nenin 138 të Kushtetutës, por jo në ligjin 96/2016 është arsyeja që gjyqtarët e zgjedhur në GJL nga gjykatat e posaçme të përfitojnë pagën përkatëse, së bashku dhe me përfitimet e tjera financiare në të njëjtën masë që i përfitonin në kohën kur ushtronin detyrën e gjyqtarit pranë atyre gjykatave, në respektimin e standardit kushtetues të paprekshmërisë së pagës për gjyqtarët e zgjedhur.</p> <p>- Gjyqtarët që kanë ardhur nga radhët e juristëve të spikatur, sipas parashikimit pikës 4, të nenit 12 të ligjit 96/2016, vjetërsia nuk ju llogaritet më shumë se mbi 15 vite punë, në ndryshim nga ata që zgjidhen nga radhët e magjistratëve. Formulë <i>e cila është e diferencuar dhe nuk haset në asnjë nga praktikat evropiane</i>. Në ndryshimet ligjore të ligjit 96/2016, me ligjin nr. 50/2021 të germës d pika 5 të nenit 12, vihet re mospërfshirja e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, në lidhje me shtesën për trajtimin financiar të tyre, çka sjell cënim të konceptit të hierarkisë gjyqësore, pasi gjyqtari më i lartë që kontrollon vendimet e gjyqtarit më të ulët paguhet më pak se ky i fundit.</p> <p>Gjithashtu, në nenin 13/1 të ligjit 96/2016, i ndryshuar me ligjin 50/2021, citohet se "...në rastet kur gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit të juridiksionit të zakonshëm delegohet për çështje të veçanta në gjykatën e posaçme përfiton shtesë të reduktuar për vështirësi pune, por jo me shume se gjysma e shtesës sipas shkronjës "d" të pikës 5 të nenit 12 të këtij ligji", shtesë e cila rezulton në masën 40 për qind të pagës bruto fillestare.</p>			<p>profesionale vijnë, me qëllim rekrutimin e gjyqtarëve më të mirë të vendit, në terma kohorë afatgjatë, duke garantuar ruajtjen e pavarësisë dhe misionit që ka Gjykata e Lartë, si gjykatë karriere.</p>
--	--	--	---

A/4	<p>Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore të lidhura me marrëdhëniet e punësimit në këtë institucion, si dhe njohjen e tyre në kontabilitet rezultoi se shumica e vendimeve gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t'u shlyer. Si rrjedhojë ky detyrim nuk është njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por është njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018, pika 34 dhe 42. Me urdhër shpenzimit nr. 192, datë 28.07.2021 është bërë ekzekutimi pjesor në shumën prej 213,870 lekë i vendimit gjyqësorë të formës së prerë së Gjykatës së Apelit me nr. 31, datë 04.02.2021. Sektori i financës, pjesën e palikuiduar në shumën prej 1,044,269 të këtij vendimi nuk e ka paraqitur si detyrim të papaguar për vitin 2021, veprim në mospërputhje me Udhëzimin nr. 37, datë 6.10.2020. Paraqitje e drejte e këtyre detyrimeve duhet të ishte reflektuar në llogarinë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" në shumën prej 1,044,269 lekë në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021, por pa ndikim në rezultatin financiar</p>	<p><i>Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 52-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</i></p>	E mesme	<p>Sektori i Financës të marrë masa në vijimësi, që pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit të plotë të titullit ekzekutiv, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.</p>
A/6	<p>Nga auditimi i procedurës, për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve materiale afatgjata u konstatua se, janë reflektuar si aktive në përdorim (gjendje pune), aktivet e nxjerra jashtë përdorimi, pas miratimit të marrë nga KLGJ-ja përkatësisht me shkresat nr. 5718/11, datë 11.01.2021 dhe nr. 3023/1, datë 28.10.2021. Konkretisht, në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2020, vlera të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi për llogarinë 218 "Inventar ekonomik" në vlerën 353,674 lekë, llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" në vlerën 1,202,930 lekë, dhe në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021, për llogarinë 215 "Mjete Transporti" në vlerën bruto 8,423,600 lekë, për llogarinë 214 "Instalime</p>	<p><i>Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 52-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</i></p>	E mesme	<p>Sektori i Financës të marrë masa në vijimësi, që pas miratimit të nxjerrjes së aktiveve jashtë përdorimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësorëtë bëjë veprimet kontabël, duke kredituar llogarinë e aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimi dhe debituar përkatësisht llogarinë 219 "Amortizimi i akumuluar i aktiveve afatgjata" dhe llogarinë 24 "Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara".</p>

	<p><i>Teknike makineri, pajisje</i>” ne vlerën 319,800 lekë, duhet të ishin klasifikuar në llogarinë 24 “<i>Aktive afatgjata të dëmtuara</i>”. Sa më sipër, veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, Paragrafi 103-109.</p>			
A/7	<p>Nga auditimi i prokurimeve të fondeve publike u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Regjistrat e parashikimi dhe realizimit nuk janë dërguar në organin qendror blerës, sipas afatit të përcaktuar në pikën 3, të Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021 dhe nenit 3, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021. - Në regjistrat e realizimit nuk janë pasqyruar të gjitha kategoritë e mallrave e shërbimeve vlere e të cilave nuk e kalon shumën 100,000 lekë, pavarësisht se këto procedura nuk i nënshtrohen rregullave të prokurimit publik, veprime në mospërputhje me pikën 2, kreut II të Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021. Për periudhën 2020-2021, nga analiza e shpenzimeve në ditarin e bankës, grupi i auditimit konstaton se këto vlere të realizuar, ishin të pa pasqyruara në regjistrin e prokurimeve, Për periudhën deri me datën 30.09.2022, në regjistrin e realizimit kategoritë e mallrave e shërbimeve vlere e të cilave nuk e kalon shumën 100,000 lekë ishin të pasqyruara. - Në lidhje me procedurat e <i>prokurimit me vlerë të vogël</i>, komisioni i blerjeve të vogla në disa procedurave nuk ka dokumentuar procesverbalet e kalimit nga një OE në një OE të renditur të dytin e kështu me radhë në momentin kur një OE tërhiqen nga procedura, veprime jo në përputhje me nenit 56, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, pika 6. - Të gjithë procedurat e blerjeve të vogla të audituara nuk ishin të inventarizuara e për pasojë të arkivuara në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “<i>Për arkivat</i>”, si dhe nenit 21 “<i>Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë</i>” dhe me pikën 3 të nenit 16 të Ligjit nr. 10 296, datë 	<p><i>Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 52-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</i></p>	E mesme	<p>-Gjykata e lartë të marrë masat në vijimësi, që në çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël, të realizojë inventarizimin e dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, duke bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik fitues, sipas kriterëve të përcaktuara në ftesën për ofertë, me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit.</p>

8.7.2010, i ndryshuar, dhe manualit të MFK.			
---	--	--	--

I.3. Opinioni i Auditimit.

Opinion mbi pasqyrat financiare (i pakualifikuar¹)

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Gjykatës së Lartë (GJL) për periudhën ushtrimore 01.01.2020-31.12.2021, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit GJL paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit GJL në datën 31.12.2021 dhe rezultatet e operacioneve të tyre dhe të flukseve monetare për vitin e përfunduar, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për raportimin financiar" të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin".

Baza për opinionin:

Ne kemi audituar veprimtarinë e Gjykatës së Lartë (GJL) në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe ISSAI 1700 . Auditimi u krye në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, si edhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare", pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10, Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të pakualifikuar.

Nën gjykimin profesional të audituesit është marrë në konsideratë pragu i materialitetit për vitin 2021 (në masën 0.7-2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar) në vlerën 3,088 mijë lekë për shpenzimet, për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar.

Mbi përputhshmërinë: Opinion i pamodifikuar/pakualifikuar².

Mbështetur në, ISSAI 4000 "Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë", Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne

¹ Sipas *Manualit të Auditimit Financiar* të KLSH-së, kapitulli IV, pika 4.2, *Një opinion i pakualifikuar (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se: (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi; (b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse; (c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar dhe (d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.*

² 2 -Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, (Qershor 2020, fq. 104), Kapitulli VII, pika 7.3.3 "Angazhimet e Vërtetimit me Siguri të Arsyeshme", Konkluzionet/ Opinonet e pakualifikuara: "Kur nuk janë gjetur apo konstatuar raste të mospërputhjeve materiale në një angazhim të sigurisë së arsyeshme, audituesi shpreh opinionin të pamodifikuar ose të pakualifikuar që informacioni i përgatitur, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e aplikueshme".

audituar përrputshmërinë e veprimtarisë së institucionit Gjykata e Lartë me kriteret e vlerësimit përrfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përrdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se veprimtaria e institucionit të Gjykatës së Lartë është kryer në përrputhje me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi dhe justifikon dhënien e një “Opinionit të Pakualifikuar”.

Baza për opinionin e pamodifikuar/pakualifikuar të përrputshmërisë:

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit “Gjykata e Lartë” në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000³. dhe ISSAI 100, paragrafi 42 .

Auditimi u krye në përrputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). në përrputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përrputshmërisë të KLSH si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAIs), me parimet INTOSAI-P1, “Deklarata e Limës”; INTOSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përrputshmërisë të një institucioni, të cilat janë përrmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përrputshmërisë”. Ne i kemi përrmbushur përrgjegjësitë tona etike, në përrputhje me standardet e sipërrpërrmendura, përrfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së.

Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga GJL dhe përrgjegjësitë janë përrmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përrshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Përrgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Strukturat drejtuese të Gjykatës së Lartë janë përrgjegjëse për zbatimin e veprimtarisë në përrputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e zbatueshme dhe në fuqi.

Përrgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përrgjegjësia jonë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përrputshmërinë e aktivitetit të Gjykatës së Lartë, në lidhje me menaxhimin e fondeve buxhetore vjetorë të GJL. (më hollësisht trajtuar në seksionin “Përrgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përrputshmërisë”, pjesë e raportit të auditimit).

Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përrmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përrshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përrjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përrfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

I. Hyrja.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 554/2 prot., datë 10.10.2022, në Gjykatën e Lartë, data 10.10.2022-30.11.2022, për periudhën e auditimit 01.01.2020 deri në 30.09.2022, u krye auditim Financiar dhe Përrputshmërie, nga grupi i auditimit me përrbërje:

³ISSAI 4000 – Objektivi i audituesve në një auditim përrputshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni është në përrputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

1. J.G, (përgjegjës grupi)
2. I.I, anëtar
3. J. K, anëtar

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objektivat specifike të auditimit është përputhshmëria e veprimtarisë së subjektit, Gjykata e Lartë me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimit dhe shpenzimet vjetore të institucionit.

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” në nenin 3 të tij ka përcaktuar se, “Auditim i përputhshmërisë nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord”. Në nenin 12 “Auditimi i përputhshmërisë” të po këtij ligji është shprehur se: “Në auditimet e përputhshmërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të përcaktojë: nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik”. Në pikën 2 të po këtij neni ka përcaktuar se “Auditim financiar” nënkupton një vlerësim të pavarur, që rezulton në një opinion me siguri të arsyeshme, nëse gjendja e raportuar financiare e një subjekti të audituar, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar.

ISSAI 4000, paragrafi 23: Objektivi kryesor i auditimit të përputhshmërisë është t’i sigurojë përdoruesit të synuar informacione nëse entitetet publike të audituara ndjekin vendimet parlamentare, ligjet, aktet legjislative, politikat, kode të përcaktuara dhe terma të dakordësuar.

ISSAI 1700, paragrafi 4: Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

Objektivat e auditimit synojnë:

a. Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

b. njehëresh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik).

c. promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare.

- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;

Qëllimi i auditimit është vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar, mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë Gjykata e Lartë (GJL), në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synim të mirë përdorimit të fondeve të financuara nga Buxheti i Shtetit.

2. Identifikimi i çështjes:

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të institucionit të Gjykatës së Lartë, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat nënligjore në fuqi, Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së “Gjykatës së Lartë”, për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2020 deri në 30.09.2022, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive përkatëse të GJL, të cilat realizojnë koordinimin dhe zbatimin e strategjive që orientojnë në hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme të institucionit.

Në funksion të këtij angazhimi, janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e kritereve mbi administrimin e shpenzimeve, buxhetimin dhe menaxhimin financiar, prokurimet publike, respektimin e organigramës dhe të strukturës organike, etj. Në fokusin e angazhimit janë përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare Vjetore nga ana e këtij institucioni në mbështetje të dispozitave ligjore dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi nënligjore në fuqi në fushën e kontabilitetit të sektorit publik dhe pasqyrave financiare, si dhe aspektet e zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr.554/2, datë 10.10.2022.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Niveli menaxherial i Gjykatës së Lartë është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

4. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Audituesit e KLSH-së kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara, e shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit.

Audituesit e KLSH-së kanë përgjegjësi të respektojnë kërkesat etike dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë të arsyeshme për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

Audituesit e KLSH-së kanë përgjegjësi që nëpërmjet auditimit të realizuar, të krijojnë bindjet për të shprehur një opinionin mbi çështjet që janë nën auditim.

Audituesit e KLSH-së kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikën, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje,

instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet etj;

- njëherësh aspektet e përputhshmërisë (respektimi i kritereve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik);
- promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionimi i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;

c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i Buxhetit apo Ligji i Prokurimit Publik, etj;

b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;

c) Interesin publik ose pritshmëritë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, etj.)

d) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj;

Në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, përkatësisht ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit në Sektorin Publik” (*rishikimi i vitit 2019*), paragrafi 41 “Materialiteti” dhe ISSAI 400 “Parimet e auditimit të përputhshmërisë”, (*rishikimi i vitit 2019*), paragrafi 47 , ku nënvizohet se:

“Audituesit duhet të marrin në konsideratë materialitetin gjatë gjithë procesit të auditimit. Përcaktimi i materialitetit është çështje gjykimi profesional dhe varet në interpretimin e auditorit të nevojave të përdoruesve. Një çështje mund të gjykohet material nëse njohuritë për të do të kishin të ngjarë të ndikonin në vendimet e përdoruesit e synuar. Ky gjykim mund të ketë të bëjë me një çështje individual ose me një grup të çështjeve të marra së bashku. Materialiteti shpesh konsiderohet në kuptim të vlerës, por gjithashtu ka aspekte të tjera sasiore si dhe cilësore. Karakteristikat e qenësishme një çështjeje ose grupi të çështjeve mund të jenë materiale nga vetë natyra e saj. Një çështje mund të jetë gjithashtu materiale për shkak të kontekstit në të cilin ndodh”

Sa më sipër, audituesit aplikojnë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

5. Kriteret e vlerësimit:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; i ndryshuar me VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Vendim nr. 643, datë 23.12.2020, “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësiive të kategorive të punonjësve të gjykatës së lartë”;

- VKM nr. 717, datë 23.06.2009, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar me VKM-në nr. 202, datë 15.03.2017;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit";
- Udhëzimi MF nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme";
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";
- Urdhër i MFE nr. 54, datë 15.07.2010 "Për miratimin e manualit të MFK";
- Udhëzimi MFE nr.37, datë 06.10.2020 "Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme";
- Udhëzimet standard të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit;
- Rregullore e brendshme "Mbi Procedurat e auditimit në KLSH", miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH^{së} e ndryshuar;

6. Standardet e Auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranura të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- INTOSAI – P - 1 "Deklarata e Limës";
- INTOSAI – P – 10 - 99 "Parimet themelore të INTOSAI";
- INTOSAI – P - 10 "Deklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAP";
- INTOSAI – P - 12 "Vlerat dhe përfitimet e SAI – sjellja e ndryshimit në jetën e qytetarëve";
- INTOSAI – P - 20 "Parimet e Transparencës dhe Llogaridhënies";
- INTOSAI – P - 50 "Parimet e juridiksionit të SAP";
- ISSAI 100 - 129 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik";
- ISSAI 2000 - 2899 "Standardet e Auditimit Financiar";
- ISSAI 400 "Parimet e Auditimit të Përputhshmërisë";
- ISSAI 4000 "Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë";
- ISSAI 2705 "Modifikimet e opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur";
- Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 64, datë 22.06.2020;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 66, datë 23.06.2020.

7. Medodat e auditimit

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 07-2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Nga përlllogaritjet që grupi i auditimit kreu, për institucionin e Gjykata e Lartë niveli i materialitetit për vitin 2021

rezultoi në vlerën 3,088 mijë lekë.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontroleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të ulët deri në të moderuar.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara, metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Verifikimi i transaksioneve* - duke marrë informacion për një rrethanë ose transaksion nga një burim i caktuar, dhe krahasimin me një informacion të marrë për të njëjtat transaksione, por me origjinë nga një burim tjetër;

b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

c. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht drejtimeve të auditimit;

d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;

g. *Modelimet e thjeshta statistikore* – në lidhje me përzgjedhjen sa më përfaqësuese të shembullit për shqyrtim në çështje të caktuara të auditimit;

h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit.

Auditimi ynë ka përfshirë përputhshmërinë e aktivitetit të GJL, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve, procedurat për qarkullim e dokumentacionit, prokurimet duke filluar nga buxheti i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat, etj.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit Përputhshmërisë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.06.2020, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale të në arritjen e këtyre

konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, rezultateve të akt konstatimeve, dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar mbi Projektin e Auditimit (dërguar me observacionin me nr. 554/5, datë 19.01.2023) u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi.

II. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Gjykata e Lartë organizohet dhe funksion në bazë të parimit të hierarkisë së sistemit gjyqësor, llogaridhënies, ligjshmërisë, efektivitetit, paanshmërisë, transparencës, aksesit në drejtësi si dhe bashkëpunimit me Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke respektuar, në të njëjtën kohë, pavarësinë dhe paanësinë e gjyqtarëve të saj. GJL është gjykatë me e lartë e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Organizimi dhe funksionimi i saj mbështet në ligjin 98/2016 "Për organizimin pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë". GJL është njësi shpenzuese me buxhet në vetë.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

2.1 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit.

Në zbatim të pikës 1, të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- 1) *Programet Buxhetore Afatmesëm (PBA) 2020-2022, PBA-në 2021-2023, PBA-në 2022-2024 dhe PBA-në 2023-2025;*
- 2) *Projektbuxheti për vitin 2020, 2021 dhe vitin 2022, si dhe shkresat e ndryshimit të buxhetit gjatë vitit ushtrimor;*
- 3) *Raportet e monitorimit të 4, 8 dhe 12-mujore të realizimit të buxhetit;*
- 4) *Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore.*

a) Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Në Gjykatën e Lartë vendimmarrjet mbi procedurat e miratimit të PBA, projektbuxhetit dhe monitorimit mbi zbatimin e buxhetit janë kryer nga ana e Grupit të Menaxhimit Strategjik ngritur në përputhje me Pikën 8/b, Nenit 8 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për me menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar. Për planifikimin e PBA dhe projekt buxhetit të vitit 2020 Grupi i Menaxhimit Strategjik është ngritur sipas urdhrin të Kryetarit të Gjykatës së Lartë Z. Xh. Z me nr. 89, datë 28.03.2019 "Mbi hartimin e PBA 2020-2022". Grupi i Menaxhimit Strategjik është përbërë nga 10 anëtarë dhe me Kryetar Nëpunësin autorizues të komanduar. Sipas urdhrin të mësipërm sektorët janë ngarkuar me detyrën e studimit të kërkesave për shpenzime personeli, mallra dhe shërbime, investime, të cilat kanë ndjekur detyrimin për tu paraqitur tek Sektori i Personelit dhe Shërbimeve, në vijim Sektorit të Financës dhe pastaj Grupit të Menaxhimit Strategjik brenda datës 03.04.2019. Me shkresën nr. 1817, datë 21.06.2019 kancelari në detyrë ka dërguar në drejtim të KLGJ kërkesat buxhetore për PBA 2020-2022.

Për hartimin e kërkesave buxhetore afatmesme 2021-2023 me urdhrin nr. 9,179 prot, me datë 20.01.2021 të Zëvendës Kryetarit të GJL Z. S. S është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik pranë Gjykatës së Lartë i përbërë nga 5 anëtarë ndër të cilët 1 Gjyqtar, 1 Drejtor Kabineti, nëpunësin autorizues në detyrë dhe sekretare Nëpunësin zbatues me kryetar Zv/ Kryetarin e Gjykatës. Sipas këtij urdhri GSM ka patur për detyrë hartimin e PBA 2021-2023, miratimin e anëtarëve të EMP, rishikimin e Deklaratës së Politikës së Programeve etj. Në vijim të këtij urdhri u konstatua dhe urdhri i Zv/ Kryetarit të GJL Z. S. S "Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe detyrat e njësisive për menaxhimin financiar dhe kontrollin në Gjykatën e Lartë" me nr. 9/1, 179/1 prot, datë

20.01.2021 “Për ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Programit” i përbërë nga 8 anëtarë dhe me Kryetar Nëpunësin e autorizuar në detyrë. Urdhrat e mësipërm janë hartuar në zbatim të Vendimit nr. 652, datë 29.12.2020 të KLGJ “Për detajimin e fondeve buxhetore në sistemin gjyqësor për vitin 2021”.

Me Urdhrin e Zv/ Kryetarit të GJL Z. S.S me nr. 78, 1245 prot, datë 23.03.2022 “Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe detyrat e njësive për menaxhimin financiar dhe kontrollin në GJL” është ngritur GMS me Kryetar Zv/ Kryetarin e GJL, dhe 5 anëtarë ndër të cilët nëpunësi autorizuar dhe nëpunësi zbatues në detyrë. Objektivi i ngritjes së GMS ka qenë planifikimi buxhetor 2023-2025. Në vijim me urdhrin nr. 77, 1244 prot, datë 23.03.2022 (protokolluar në vijim dhe jo përpara urdhrin të mësipërm) “Për ngritjen e Ekipit të menaxhimit të programit” është ngritur EMP e kryesuar nga nëpunësi autorizues në detyrë dhe 4 anëtarë të caktuar më përparësi në përgatitjes së kërkesave buxhetore, për detajim e politikës së programit, produkteve dhe kostove përkatëse të tyre.

Në institucionin e Gjykatës së Lartë caktimi i drejtuesit të EMP-së është bërë në përputhje me përcaktimet e pikës 2.5.1/a të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, ku përcaktohet se: “1. Në varësi të organizimit të njësisë së qeverisjes qendrore drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të programit buxhetor është: a) Në njësitet e qeverisjes qendrore dhe njësitet shpenzuese të nivelit të dytë që zbatojnë një program buxhetor të vetëm, drejtuesi i programit si rregull është respektivisht nëpunësi autorizues i njësisë publike”.

Nëpunësi zbatues ka përgatitur dokumentin përfundimtar të buxhetit konform Pikës 2/a dhe 3/a, Nenit 12 të Ligjit nr. nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për me menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar. Ky dokument është miratuar nga Nëpunësi autorizues dhe është dërguar KLGJ konform pikës 4/d, Nenit 9, të Ligjit nr. nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për me menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe pikës j, Kreu IV i Rregullores së Brendshme të Gjykatës së Lartë miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 643, datë 23.12.2020 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë”.

Nga auditimi i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi u konstatua se, është hartuar deklarata e politikës së programit, produktet e programit si dhe aktivitetet e programit, ku çdo program ka të përcaktuar produktet e programeve buxhetore.

Konstatim:

Gjatë auditimit u konstatua se ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik përgjatë vitit 2019 nuk është kryesuar nga Kryetari i Gjykatës në cilësinë e Titullarit të GJL, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për me menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, Neni 27 “Takime periodike ndërmjet menaxherëve të njësisë publike”, Pika 2. “Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendëstitullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë”.

Në vijim kryesimi i Grupit të Menaxhimit Strategjik për planifikimin buxhetor 2021-2023 dhe 2022-2024 është bërë nga titullari i GJL konform dispozitës ligjore të mësipërme.

Nga grupi i auditimit u bënë objekt auditimi përgatitja e PBA-ve të periudhës 2020-2022; 2021-2023 dhe 2022-2024 krahas analizës së përlllogaritjes dhe detajimit të fondeve buxhetit sipas viteve, transferimeve, rialokimeve dhe monitorimit të buxhetit gjatë viteve ushtrimore të analizuara.

Financimi i Gjykatës së Lartë kryhet si më poshtë:

- Për shpenzimet për paga, sigurime, mallra dhe shërbime (llog. 600, llog. 601, llog. 602 ,606 dhe 230-231) nga ana e Buxhetit të shtetit;

Buxheti i miratuar për Gjykata e Lartë paraqitet vetëm në një program buxhetor:

- Programi: Buxheti gjyqësor, pjesë e programit me të njëjtin emër të Këshillit të lartë të Gjyqësorit, i cili përfshin buxhetin gjyqësor të gjykatave të tre niveleve. Programi buxhetor në të cilin përfshihen kërkesat buxhetore të Gjykatës së lartë i përkon programit me nr 03310 “Buxheti gjyqësor”. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron kompetencat sipas përcaktimeve të Nenit 61 “Mbledhja plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Pika 2/d dhe 2/dh të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” d) drejton dhe kujdeset për veprimtarinë në administratën e gjykatave; dh) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe atë të gjykatave.

Planifikimi buxhetor i vitit 2020-2022

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Gjykata e lartë dërgon në Këshillin e Lartë të Gjyqësorit kërkesat për “Projekt Buxhetin për vitin 2020-2022”, mbështetur në formatin udhëzues për kryerjen e parashikimit të shpenzimeve nga ana e GJL.

Me shkresën nr. 1817 prot., datë 21.06.2019, Gjykata e Lartë dërgon në Këshillin e Lartë të Gjyqësorit “Programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022” (faza e parë), mungon miratimi nga kryetari i GJL, por shkresa përkatëse është dërguar në KLGJ nga nëpunësi autorizues në detyrë. Planifikimi i fondeve sipas PBA 2020-2022 të hartuar nga Gjykata e Lartë, krahasuar me realizimin faktik të buxhetit të vitit paraardhës (viti 2019), paraqitet në mënyrë të përmbledhur sipas **Aneksit 1.1** “PBA 2020-2022”, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Realizimi i buxhetit për shpenzime personeli është kryer në përputhje me vendet e punës jovakante.

- **Parashikimi i PBA-së 2020-2021 për artikullin buxhetor 600 dhe 601 është mbështetur në:**

Numrin e planifikuar të punonjësve në organikën e përbërë prej 131 punonjësish dhe nuk janë bërë kërkesapër punonjës me kontratë.

- **Parashikimi i PBA-së 2020-2021 për artikullin buxhetor 602 është mbështetur në:**

Shpenzimet e udhëtimit në shumën 2,100 mijë lekë, materiale dhe shërbime zyre në shumën 1,520 mijë lekë, shërbime të tjera si energji elektrike, ujë, telefon, shërbim postar, shërbim printimi në shumën totale prej 9,600 mijë lekë, shpenzime transporti në shumën 10,910 mijë lekë në të cilën përfshihet blerje karburanti në shumën 6,400 mijë lekë; shpenzime mirëmbajtje të zakonshme në shumën 1,430 mijë lekë, shpenzim mirëmbajtje të pajisjeve elektronike në shumën 200 mijë lekë, dhe shpenzime të tjera operative në shumën 2,750 mijë lekë ku përfshihen shpenzimet për pritje përcjellje në shumën 800 mijë lekë, shpenzime avokatie në shumën 819 mijë lekë, shpenzime tatim taksa dhe kuotizacioni, etj.

Parashikimi i PBA-së 2020-2022 për artikullin buxhetor 231, investime të brendshme në krahasim me buxhetin plan të vitit 2019 është paraqitur sipas **Aneksit 1.2** “Parashikimi i PBA-së 2020-2022 për artikullin buxhetor 231”, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Planifikimi buxhetor i vitit 2021-2023.

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, janë përgatitur kërkesat për “Projekt Buxhetin për vitin 2020-2022”, mbështetur në udhëzimin nr. 28, datë 10.07.2020 “Për

përgatitjen e Programeve Buxhetore Afatmesme 2021-2023”, por dërgimi në kushtet e pandemisë nga Covid- 2019 janë dërguar elektronikisht në drejtim të KLGJ-së.

Planifikimi i fondeve sipas PBA 2021-2023, krahasuar me realizimin faktik të buxhetit të vitit paraardhës (viti 2020), paraqitet sipas *Aneksit 1.3 “PBA 2021-2023”*, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- **Parashikimi i PBA-së 2021-2023 për artikullin buxhetor 600 dhe 601 është mbështetur në:**

Parashikiminsipas strukturës organike në fuqi të përbërë nga 131 punonjës.

- **Parashikimi i PBA-së 2021-2023 për artikullin buxhetor 602 është mbështetur në:**

Shpenzimet e udhëtimit në shumën 2,000 mijë lekë, materiale dhe shërbime zyre në shumën 1,620 mijë lekë, shërbime të tjera si energji elektrike, ujë, telefon, shërbim postar, shërbim printimi në shumën totale prej 10,650 mijë lekë, shpenzime transporti në shumën 10,910 mijë lekë në të cilën përfshihet blerje karburanti në shumën 6,120 mijë lekë dhe pjesë këmbimi në shumën 3,500 mijë lekë; shpenzime mirëmbajtje të zakonshme në shumën 1,450 mijë lekë shpenzim mirëmbajtje të pajisjeve elektronike në shumën 200 mijë lekë, dhe shpenzime të tjera operative në shumën 2,650 mijë lekë ku përfshihen shpenzimet për pritje përcjellje në shumën 800 mijë lekë, shpenzime avokatie në shumën 1,000 mijë lekë, shpenzime tatim taksa dhe kuotizacioni.

Institucioni për planifikimin e këtyre shpenzimeve është mbështetur kryesisht mbi realizimin e tyre në vitin 2020.

- **Parashikimi i PBA-së 2021-2023 për artikullin buxhetor 231:**

Parashikimi i PBA-së 2021-2023 për artikullin buxhetor 231, investime të brendshme në krahasim me buxhetin plan të vitit 2020 është paraqitur sipas *Aneksit 1.4 “Parashikimi i PBA-së 2021-2023 për artikullin buxhetor 231, investime të brendshme”*, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Planifikimi i kërkesave për investime për vitin 2021 në shumën totale 24,930 mijë lekë është ndarë sipas zërave si:

- Rikonstrukcion në shumën 18,644 mijë lekë, sipas preventivit bashkëlidhur në të përfshihen sistemi i aksesimit me kartë, dyshemeja teknologjike, paneli elektrik, sistem kondicionimi inverter, kafazi i Faradeit, sistem ndriçimi, izolim i hapësirës së dhomës, lyerje, etj;
- Blerje pajisje elektronike në shumën totale 4,055 mijë lekë, ndër të cilat përfshihet blerje serveri, kompjutera desktop, etj;
- Blerje pajisje mobiljesh e të tjera në shumën 1,870 mijë lekë;

Planifikimi i kërkesave për investime për vitin 2022 në shumën totale 6,210 mijë lekë është ndarë sipas zërave si:

- Blerje pajisje elektronike në shumën totale 2,072 mijë lekë, ndër të cilat përfshihet blerje sistem konference, kompjutera desktop, etj;
- Blerje pajisje mobiljesh e të tjera në shumën 610 mijë lekë;
- Blerje e 1 automjeti në shumën 3,500 mijë lekë;

Planifikimi i kërkesave për investime për vitin 2023 në shumën totale 4,836 mijë lekë është ndarë sipas zërave si:

- Blerje pajisje elektronike në shumën totale 550 mijë lekë, ndër të cilat përfshihet UPS dhe kompjutera desktop.
- Blerje pajisje mobiljesh e të tjera në shumën 770 mijë lekë
- Blerje e 1 automjeti në shumën 3,500 mijë lekë;

Planifikimi buxhetor i vitit 2022-2024

Planifikimi i kërkesave buxhetore për vitin 2022-2024 është bërë për realizimin e objektivit të

programit “Buxheti gjyqësor” i cituar si: *“përmirësimi i ofrimit të shërbimeve përmes novacionit dhe forcimit të strukturave dhe sistemeve të teknologjisë që garantojnë koherencën, efikasitetin dhe efektshmërinë institucionale”*.

Kërkesat buxhetore të PBA për vitin 2022-2024 të fazës strategjike janë dërguar KLGJ me shkresën nr. 1107, datë 02.04.2021 “Mbi dërgimin e kërkesave buxhetore për vitin 2022-2024”.

Planifikimi i kërkesave buxhetore afatmesme të PBA 2022-2024 kundrejt realizimit buxhetor të vitit 2021 paraqiten sipas **Aneksit 1.5 “PBA 2022-2024”**, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- **Parashikimi i PBA-së 2022-2024 për artikullin buxhetor 600 në shumën 250,848 mijë lekë dhe 601 në shumën 28,790 mijë lekë.**

Në programin buxhetor, Gjykata e Lartë ka programuar kërkesa buxhetore për shpenzime për paga për numrin e punonjësve sipas strukturës organike ekzistuese të përbërë në total prej 137 punonjësish gjyqësorë dhe administratë gjyqësore (ndryshuar me në vitin 2021) duke u rritur nga 131 në 137 punonjës; kërkesën për shtim në organikë me 8 punonjës të administratës gjyqësore si dhe 2 punonjës me kontratë (për tu miratuar me VKM për punonjës arkivë pranë Drejtorisë së Arkivës Qendrore Shtetërore. Baza ligjore e programimit është Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, i ndryshuar, Neni 12, 14, 168, 169; VKM nr. 187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e Ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të Ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, e ndryshuar; VKM nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”.

Efekti financiar për shtesat e vitit 2022 ishte llogaritur 8,610 mijë lekë shpenzime paga dhe 1,346 mijë lekë shpenzime për kontributet e sigurimeve.

- **Parashikimi i PBA-së 2022-2024 për artikullin buxhetor 602:**

Kërkesat buxhetore për artikullin buxhetor 602 janë programuar në shumën 78,016 mijë lekë nga të cilat shpenzimet e parashikuara nga buxheti i shtetit janë në vlerën 77,956 mijë lekë dhe nga të ardhurat 60 mijë lekë. Vlera e kërkuar rezulton të jetë 52,016 mijë lekë më e lartë se buxheti i miratuar për vitin 2021. Nga auditimi i shtojcës 1/A; Pasqyrat shtesë për buxhetin vjetor konstatohet se zëri kryesor që ka ndikuar në planifikimin shtesë në artikullin 602 për vitin 2022 është “shërbimi dixhitalizimit të arkivës” në shumën 41,333 mijë lekë. Sipas relacionit shoqërues të kërkesave buxhetore 2022-2024 konstatohet se nënartikulli 602.2 “Shërbime nga të tretë” është planifikuar kërkesa për shërbim të dixhitalizimit të arkivës në shumën 41,333 mijë lekë, parashikim i bërë nga sektori IT dhe është një shërbim i pa kërkuar më parë nga gjykata. Me të planifikohen të dixhitalizohen 1,000,000 fletë me kosto 0.5 – 2 euro për fletë, në varësi të madhësisë së faqes. Kostoja totale e shërbimit konsiston në 248,000 mijë lekë, duke u menduar të kryhet për shpërndarjen e kostos për 5-6 vjet, me kosto vjetore 41,333 mijë lekë. Në shërbimet me të tretë, përfshihen gjithashtu furnizimi me energji elektrike për të gjitha ambientet, furnizimi me ujë, telefonia fikse, telefonia celulare, shërbimi postar, shërbim printimi, si dhe shpenzime për udhëtime jashtë shtetit ku institucioni për planifikimin e këtyre shpenzimeve është mbështetur mbi realizimin e tyre në vitin 2021.

Krahas nënartikullit të mësipërm konstatohet rritje në nënartikullin 602.7 “Shpenzime për detyrime kompensime” në vlerën 2,335 mijë lekë. Në të janë planifikuar detyrimet e gjykatës për ekzekutime të vendimeve gjyqësore nga të cilat një vendim i formës së prerë në shumën 1,258

mijë lekë si dëshmëpërblim dhe planifikim për 2 çështje të tjera të cilat gjatë vitit 2021 kanë qenë në proces në gjykatën e apelit dhe priten të përfundojnë brenda vitit 2021 në detyrimin total 1,077 mijë lekë.

• **Parashikimi i PBA-së 2022-2024 për artikullin buxhetor 231:**

Parashikimi i PBA-së 2022-2024 për artikullin buxhetor 231, investime të brendshme sipas projekteve, paraqitet sipas **Aneksit 1.6** “PBA-së 2022-2024 për artikullin buxhetor 231, investime të brendshme”, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Kërkesat për investime për vitin 2022 janë programuar në rritje kundrejt buxhetit të vitit 2021 kryesisht si rezultat i projekteve të planifikuara për tu realizuar përgjatë vitit 2022 si:

- Rikonstrukcion të ambienteve të gjykatës reflektuar me programim të kërkesave buxhetore në nënartikullin 231.2118 “Rikonstrukcione të tjera ndërtimore” në shumën 20,350 mijë lekë;
- Blerje pajisjesh elektronike si 20 kompjutera, 34 laptop dhe 1 server reflektuar në nënartikullin 231.8600 “Pajisje kompjuterike” në shumën 12,440 mijë lekë;
- Blerje automjeteve reflektuar në nënartikullin 231.5120 “Automjete” në shumën 16,000 mijë lekë për blerjen e 10 automjeteve të reja;
- Rikonstrukcion i rrjetit kompjuterik Lan reflektuar në nënartikullin 231.2118 “Rikonstrukcione të tjera ndërtimore” në shumën 4,000 mijë lekë;
- Blerje pajisje/ mobilje zyresh reflektuar në nënartikullin 231.8100 “Orendi zyre” në shumën 3,420 mijë lekë, etj.

Gjatë auditimit të PBA 2022-2024 konstatohet se kërkesat për investime për vitin 2024 janë planifikuar në shumën 118,772 mijë lekë, e cila paraqitet ndjeshëm më e rritur kundrejt viteve 2022 dhe 2023 (konkretisht rritur përkatësisht në masën 79% dhe 212%). Sipas planifikimit të kërkesave për investime të ndarë sipas zërave për vitin 2024 konstatohet planifikimi i sistemit të kondicionimit qendror në shumën 108,000 mijë lekë.

b. Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Viti 2020

Detajimi i limitit mujor të fondeve të Gjykatës së Lartë është bërë mbështetur në ligjin nr. 88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, UMF nr. 2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, si dhe në mbështetje të Vendimit të KLGJ me nr. 323, datë 27.12.2019.

Buxheti i vitit 2020 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2020-2022 faza strategjike, paraqitet sipas **Aneksit 1.7** “Buxheti i vitit 2020 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2020-2022 faza strategjike”, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për vitin 2020, sipas PBA 2020-2021 është planifikuar shuma prej 309,945 mijë lekë, dhe deri në fund të vitit 2020 pas rishikimit të buxhetit janë alokuar 134,656 mijë lekë nga Gjykata e Lartë, pra 175,289 mijë lekë më pak se plani në PBA.

Sipas PBA 2020-2022 për shpenzimet operative është parashikuar për GJL, një buxhet prej 296,817 mijë lekë, nga të cilat 238,214 mijë lekë shpenzime për paga, 25,463 mijë lekë shpenzime për sigurime, dhe 33,140 mijë lekë për mallra e shërbime. Krahasuar me buxhetin e alokuar për institucionin pas rishikimeve të kryera përgjatë vitit, deri në fund të vitit paraqitet në shumën prej 129,426 mijë lekë, pra 167,391 mijë lekë më pak se kërkesat e institucionit në PBA.

Për shpenzimet kapitale për investime, në PBA 2020-2022 është parashikuar një buxhet prej 13,128 mijë lekë, dhe janë alokuar deri në fund të vitit 2020, 5,230 mijë lekë, pra 7,898 mijë lekë më pak.

Ndryshime në buxhet

Në vijim paraqiten ndryshimet që ka pësuar buxheti i institucionit të Gjykatës së Lartë gjatë vitit 2020:

Në lekë

Artikulli	Shuma	Komente
600 "Paga dhe shpërblime"	180,000,000	Buxheti fillim vitit
	-30,000,000	Me Aktin Normativ nr. 15, datë 15.04.2020
	-48,000,000	Me Aktin Normativ nr. 28/2020 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë dhe Vendim të KLGJ nr. 251, datë 09.07.2020
	+12,200,000	VKM nr. 890, datë 21.10.2020 dhe shkresa e KLGJ nr. 5897/3 datë 18.12.2020
	-17,000,000	Shkresa e MFE nr. 23412/12, datë 21.12.2020 "Mbi detajimin e ndryshimeve sipas Aktit normativ nr. 34, datë 16.12.2020"
	97,200,000	Buxheti i rishikuar për vitin 2020

Artikulli	Shuma	Komente
601 "Sig. Shoqërore & shëndetësore"	15,000,000	Buxheti fillim vitit
	-4,300,000	Shkresa e MFE nr. 23412/12, datë 21.12.2020 "Mbi detajimin e ndryshimeve sipas Aktit normativ nr. 34, datë 16.12.2020"
	10,700,000	Buxheti i rishikuar për vitin 2020

Artikulli	Shuma	Komente
602 "Mallra e shërbime"	24,000,000	Buxheti fillim vitit
	-5,000,000	Me Aktin Normativ nr. 15, datë 15.04.2020
	+323,000	VKM nr. 251, datë 09.07.2020 dhe shkresa e KLGJ nr. 3879/1, datë 11.08.2020
	+1,800,000	VKM nr. 890, datë 21.10.2020 dhe shkresa e KLGJ nr. 5897/3 datë 18.12.2020
	21,123,000	Buxheti i rishikuar për vitin 2020

Burimi: Gjykata e Lartë, përpunuar nga grupi auditimit

Viti 2021

Detajimi i limitit mujor të fondeve të institucionit Gjykata e Lartë është bërë mbështetur në ligjin nr. 137, datë 16.11.2020 "Për buxhetin e vitit 2021", UMF nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, si dhe në mbështetje të Vendimit të KLGJ nr. 652, datë 29.12.2020 "Për detajimin e fondeve buxhetore në Sistemin Gjyqësor për vitin buxhetor 2021".

Buxheti i vitit 2021 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2021-2023 faza strategjike, paraqitet sipas **Aneksit 1.8** "Buxheti i vitit 2021 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2021-2023 faza strategjike", pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Shpenzimet për të ardhurat jashtë limitit si në PBA 2021-2023, planin fillestar buxhetor dhe planin e rishikuar rezultojnë në shumën 50 mijë lekë.

Për vitin 2021, janë planifikuar në PBA 2021-2023, gjithsej 328,481 mijë lekë, dhe deri në fund të vitit 2021 pas rishikimit të buxhetit janë alokuar 225,313 mijë lekë për institucionin e Gjykatës së Lartë, *pra 103,168 mijë lekë më pak se plani në PBA.*

Sipas PBA 2021-2023 faza strategjike **për shpenzimet operative** është parashikuar një buxhet prej 303,551 mijë lekë, nga të cilat 248,304 mijë lekë shpenzime për paga, 25,847 mijë lekë shpenzime për sigurime, dhe 29,400 mijë lekë për mallra e shërbime. Krahasuar me buxhetin e alokuar për institucionin pas rishikimeve të kryera përgjatë vitit, deri në fund të vitit paraqitet në shumën prej 193,763 mijë lekë, pra 109,788 mijë lekë më pak se kërkesat e institucionit në PBA.

Për shpenzimet kapitale për investime, në PBA 2021-2023 faza strategjike është parashikuar një buxhet prej 24,930 mijë lekë dhe janë alokuar deri në fund të vitit 2021, 31,550 mijë lekë, *pra 6,620 mijë lekë më shumë.* Konstatohet se shpenzimet kapitale prej PBA 2021-2023 dhe deri në

miratimin e buxhetit fillestar 2021 ka pësuar rritje pasi me Vendimin e KLGJ-së nr. 294, datë 06.07.2021, “Mbi rishpërndarjen e fondeve për shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale (Investime), në programin buxhetor “Buxheti Gjyqësor” dhe miratuar me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 12333/1 prot., datë 13.07.2021, shpenzimet kapitale dhe konkretisht Projekti “Blerje automjete” u shtua në vlerën 9,000 mijë lekë, për plotësimin e nevojave të GJL me 4 automjete.

Ndryshime në buxhet

Në vijim paraqiten ndryshimet që ka pësuar buxhetit i Gjykatës së Lartë gjatë vitit 2021:

Në lekë

Artikulli	Shuma	Komente
600 “Paga dhe shpërblime”	180,000,000	Buxheti në fillim vitit, dërguar elektronikisht në GJL, bazuar në Vendimin e KLGJ nr. 652, datë 29.12.2020 “Për detajimin e fondeve buxhetore në Sistemin Gjyqësor për vitin buxhetor 2021”.
	-28,000,000	Vendim i KLGJ nr. 326, datë 22.07.2021 “Për transferimin e fondeve nga shpenzime personeli në shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”, dërguar me shkresën nr. 3511/2 të KLGJ, datë 23.07.2021 “Kërkesë për transferim fondi” miratuar nga MFE me shkresën nr. 13250, datë 30.07.2021.
	-10,000,000	Akt normativ nr. 34, datë 03.12.2021 dhe shkresa e KLGJ nr. 5583/2, datë 09.12.2021
	142,000,000	Buxheti i rishikuar për vitin 2021

Artikulli	Shuma	Komente
602 “Mallra e shërbime”	26,000,000	Buxheti në fillim vitit, dërguar elektronikisht në GJL, bazuar në Vendimin e KLGJ nr. 652, datë 29.12.2020 “Për detajimin e fondeve buxhetore në Sistemin Gjyqësor për vitin buxhetor 2021”.
	-144,000	Prill 2021
	25,856,000	Buxheti i rishikuar për vitin 2021

Artikulli	Shuma	Komente
231 Investim i brendshëm	32,760,000	Buxheti në fillim vitit, dërguar elektronikisht në GJL, bazuar në Vendimin e KLGJ nr. 652, datë 29.12.2020 “Për detajimin e fondeve buxhetore në Sistemin Gjyqësor për vitin buxhetor 2021”.
	-1,210,000	Akti normativ nr. 34, datë 03.12.2021 dhe shkresa e KLGJ nr. 5800 datë 22.12.2021
	31,550,000	Buxheti me 31.12.2021

Burimi: Gjykata e Lartë, përpunuar nga grupi auditimit

Viti 2022

Detajimi i limitit mujor të fondeve të institucionit Gjykata e Lartë është bërë mbështetur në ligjin nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar”, si dhe në mbështetje të Vendimit të KLGJ nr. 596, datë 23.12.2021 “Për detajimin e fondeve buxhetore në sistemin gjyqësor për vitin 2022” dërguar me shkresën nr. 118, datë 12.01.2022.

Buxheti i vitit 2022 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2022-2024 faza strategjike, paraqitet sipas **Aneksit 1.9** “Buxheti i vitit 2022 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2022-2024 Faza strategjike”, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për vitin 2022, sipas PBA 2022-2024 fazës strategjike janë planifikuar gjithsej 423,838 mijë lekë, sipas fazës teknike janë planifikuar gjithsej 321,450 mijë lekë dhe deri në fund të muajit gusht të vitit 2022 pas rishikimit të buxhetit janë alokuar 292,450 mijë lekë për institucionin e Gjykatës së Lartë, pra 131,388 mijë lekë më pak se faza strategjike në PBA dhe 29,000 mijë lekë më pak se faza teknike.

Sipas PBA 2022-2024 faza strategjike konstatohet se:

Për shpenzimet operative për GJL është parashikuar një buxhet prej 357,654 mijë lekë, nga të cilat 250,848 mijë lekë shpenzime për paga, 28,790 mijë lekë shpenzime për sigurime, dhe 78,016 mijë

lekë për mallra e shërbime. Krahasuar me buxhetin e alokuar për institucionin pas rishikimeve të kryera përgjatë vitit, deri më 30.08.2022 paraqitet në shumën prej 253,400 mijë lekë, pra 104,254 mijë lekë më pak se kërkesat e institucionit në PBA faza strategjike;

Për shpenzimet kapitale për investime, në PBA 2022-2024 është parashikuar një buxhet prej 66,184 mijë lekë dhe janë alokuar deri më 30.08.2022, 39,050 mijë lekë, ose 27,134 mijë lekë më pak se kërkesat e institucionit në PBA faza strategjike.

Ndryshime në buxhet

Në vijim paraqiten ndryshimet që ka pësuar buxhetit i Gjykatës së Lartë gjatë vitit 2022:

Në mijë lekë

Artikulli	Shuma	Komente
600 "Paga dhe shpërblime"	200,000	Buxheti në fillim vitit shkresa e KLGJ me nr. 118, datë 12.01.2022 prot. në GJL me nr. 142, datë 14.01.2021.
	-14,800	Shkresa e MFE nr. 13028/1, datë 14.07.2022
	185,200	Buxheti i rishikuar për vitin 2022

Artikulli	Shuma	Komente
602 "Mallra e shërbime"	18,400	Buxheti në fillim vitit shkresa e KLGJ me nr. 118, datë 12.01.2022 prot. në GJL me nr. 142, datë 14.01.2021.
	+38,400	Shkresa e MFE nr. 13028/1, datë 14.07.2022, shkresa e MFE nr. 2128/2, datë 15.02.2022 prot. KLGJ me nr. 998, datë 17.02.2022.
	-10,000	Shkresa e MFE nr. 4934/115, prot 2044, datë 06.04.2022 "Mbi zbatimin e Aktit normativ nr. 3, datë 12.03.2022".
	43,200	Buxheti i rishikuar për vitin 2022

Artikulli	Shuma	Komente
231 Investim i brendshëm	68,050	Buxheti në fillim vitit shkresa e KLGJ me nr. 118, datë 12.01.2022 prot. në GJL me nr. 142, datë 14.01.2021.
	-29,000	Me shkresën e MFE nr. 4457/1, datë 07.04.2022 "Transferim fondi për shpenzime kapitale" prot. KLGJ me nr. 2122, datë 08.04.2022, pakësim në shumën 19,000 mijë lekë "Rikonstruksion", pakësim në shumën 10,000 mijë lekë "Studime dhe projekte" dhe rialokim në shumën 1,700 mijë lekë "Programe software".
	39,050	Buxheti me 31.12.2022

Burimi: Gjykata e Lartë, përpunuar nga grupi auditimit

Në artikullin 231, sipas buxhetit të fillim vitit 2022 për GJL, është planifikuar projekti M290068 "Ndërtim i ri dhe rikonstruksion i plotë/ i pjesshëm", i cili është transferuar në artikullin 230 në projektin M290066 "Studime dhe Projekte", me kërkesë të KLGJ me shkresë nr. 736, datë 04.02.2022 dhe miratim të MFE me shkresën 2130/1, datë 02.03.2022. Në vijim fondi i mësipërm ka kaluar nga GJL në KLGJ duke ruajtur projektin, brenda programit buxhetor "Buxheti gjyqësor" me kërkesë të KLGJ me shkresë nr. 1371, datë 04.03.2022 dhe miratim nga MFE me shkresë nr. 4457/1, datë 07.04.2022.

Rialokimi i fondit prej 1,700 mijë lekë në produktin "Programe software" ka ardhur si kërkesë e GJL duke patur fonde të papërdorura në projektin 21AC401. Për këtë KLGJ ka bërë kërkesën me shkresën nr. 2850, datë 18.05.2022 për të cilën është marrë miratimi nga MFE me shkresën nr. 9123/1, datë 22.06.2022.

c. Realizimi i planit të buxhetit.

Viti 2020

Gjykata e lartë përgjatë vitit 2020 ka kryer funksionimin e saj në kushtet e pandemisë Covid- 2019, për të cilën Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 127 datë 10 mars 2020, "Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë", pika 1, ka vendosur "Pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit, të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, për shkak të situatës së krijuar nga infeksioni i

përhapur Covid-2019”. Gjithashtu dalja e Udhëzimit të Ministrisë së Financave, nr. 14 datë 24.03.2020, "Për procedurat e menaxhimit dhe monitorimit të zbatimit të buxhetit në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore" dhe njoftimit të A.P.P nr. 237, datë 31/03/2020, për pezullimin e shpalljes së procedurave të reja të prokurimit publik, si dhe atyre që ishin në proces për shkak të gjendjes nga COVID-19, kanë kushtëzuar funksionimin e plotë të aktivitetit të gjykatës, pasi gjatë periudhës mars-qershor gjykatat kanë kryer vetëm shpenzimet për plotësimin e nevojave të tyre më emergjente.

Raportet e monitorimit të buxhetit janë dërguar në KLGJ sipas afateve të parashikuara ligjore. Raporti i monitorimit për periudhën Janar - Dhjetor 2020 i është dërguar KLGJ me shkresën nr. 53, datë 08.01.2021.

Realizimi i buxhetit të Gjykatës së Lartë për vitin 2020 krahasuar me alokimin fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar, paraqitet sipas Aneksit **1.10** “*Realizimi i buxhetit të vitit 2020*”, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- *Realizimi i shpenzimeve për paga* është realizuar në masën 95% kundrejt planit të rishikuar dhe 51% kundrejt planit fillestar. *Realizimi i shpenzimeve për kontribute të sigurimeve shoqërore* është realizuar në masën 100% kundrejt planit të rishikuar dhe 71% kundrejt planit fillestar. Këto zëra shpenzimesh janë realizuar për një numër faktik prej 71 punonjës, nga 131 që ka miratuar ligji vjetor i buxhetit dhe 2 punonjës me kontratë të përkohshme të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave për vitin 2020. Mos realizimi 100% i këtij zëri shpenzimesh vjen, për shkak të vendeve vakante ku nga krahasimi i strukturës organizative dhe organikës në fakt në dhjetor 2020 konstatohet se nga 131 punonjës në strukturë, 60 janë pozicione vakante. Shtesa e fondit të akorduar për shpërblimin e anëtarëve të KED dhe stafit mbështetës, për shkak të pandemisë dhe mungesës së anëtarëve ky fond nuk u përdor i plotë.

- *Realizimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime* është realizuar në masën 71% kundrejt planit të rishikuar dhe 63% kundrejt planit fillestar. Në mosrealizimin e këtij zëri kanë ndikuar situata e pandemisë Covid-19, ku konstatohet ulje të udhëtimeve të planifikuara jashtë shtetit. Mungesa e organikës me gjyqtarë dhe punonjës të administratës ka sjellë efekt në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara për blerje karburanti, shërbime printimi, siguracione makinash, etj. Shpenzimet operative për KED kanë qenë gjithashtu të ulta. Përgjatë vitit 2020 janë realizuar shpenzime për kancelari në shumën 246 mijë, materiale pastrimi dhe dezinfektimi në shumën 361 mijë lekë, abonime dhe njoftime në shumën 104 mijë lekë, karburant në shumën 1,613 mijë lekë, mirëmbajtje godinë në shumën 918 mijë lekë, shpenzime kuotizacioni në shumën 252 mijë lekë, tatim taksa në shumën 315 mijë lekë, udhëtime jashtë vendit në shumën 504 mijë lekë si dhe shërbime të tjera si energji elektrike, ujë, telefon, postë, shpenzime interneti, siguracione makinash, dieta administrative, etj.

- *Realizimi i shpenzimeve për investime* sipas Aneksit nr. 2 “Raporti i shpenzimeve buxhetore sipas artikujve buxhetorë” është realizuar në masën 92%. Projektet e investimeve të financuara nga buxheti i shtetit për vitin 2020 dhe të realizuara paraqiten sipas **Aneksit 1.11** “*Realizimi i shpenzimeve për investime*”, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga krahasimi i të dhënave midis relacionit bashkëlidhur raportit të monitorimit të periudhës Janar – Dhjetor 2020 konstatohet se ka një mospërputhje shifrore prej 297 mijë lekësh raportuar më tepër për realizimin e projekteve të artikullit 231. Kështu sipas pasqyrës Aneksi nr. 4 “Projektet e investimeve me financim të brendshëm” realizimi progresiv vjetor rezulton në shumën 4,829 mijë lekë, ndërsa sipas relacionit dhe kontratave të lidhura për projektet e investimit raportohet në shumën 4,532 mijë lekë. Kështu në relacionin e raportit të monitorimit, përgjatë analizës së përdorimit të fondit në dispozicion për shpenzimet kapitale, konstatohet se:

- Për projektin “Blerje mobilje- pajisje” planifikuar në shumën 1,420 mijë lekë është realizuar blerje kondicionerë në shumën 431 mijë lekë dhe blerje mobilje në shumën 752 mijë lekë, ose në

total 1,183 mijë lekë;

- Për projektin “Blerje pajisje elektronike” planifikuar në shumën 2,060 mijë lekë është realizuar likuidimi në shumën 1,693 mijë lekë;

- Për projektin “Blerje pajisje sigurie” planifikuar në shumën 1,750 mijë lekë është realizuar likuidimi në shumën 1,272 mijë lekë për blerje skaner bagazhesh dhe pajisje të tjera sigurie në shumën 384 mijë lekë, ose në total 1,656 mijë lekë.

Plotësimi i Aneksive nr. 2 “Raporti i shpenzimeve buxhetore sipas artikujve buxhetorë” dhe Aneksit nr. 4 “Projektet e investimeve me financim të brendshëm” ka përputhje shifrore, duke bërë që mosrealizimi i fondit për shpenzime kapitale mos të jetë 8%, por 13% kundrejt planit vjetor.

Realizimi i buxhetit të vitit 2021

Raporti përmbledhës i monitorimit për vitin 2021 i është dërguar KLGJ me shkresën nr. 347, datë 28.01.2022 “Raportet e monitorimit për periudhën Janar – Dhjetor 2021”.

Realizimi i buxhetit të Gjykatës së Lartë për vitin 2021 krahasuar me alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar paraqitet sipas **Aneksit 1.12** “Realizimi i buxhetit të vitit 2021”, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mosrealizimi i programit “Buxheti gjyqësor” për Gjykatën e Lartë kundrejt planit vjetor të rishikuar të vitit 2021 rezulton në shumën 36,032 mijë lekë ose 16% kundrejt planit buxhetor të rishikuar të vitit 2021.

- Realizimi i shpenzimeve për paga është realizuar në masën 123,595 mijë lekë ose 87%, me një mosrealizim në shumën 18,405 mijë lekë. Realizimi i shpenzimeve për kontribute të sigurimeve shoqërore është realizuar në masën 15,014 mijë lekë ose 60%, me një mosrealizim në shumën 9,986 mijë lekë. Këto zëra shpenzimesh janë realizuar për një numër faktik prej 96 punonjës e deputetë, nga 137 që ka miratuar ligji vjetor i buxhetit dhe 2 punonjës me kontratë të përkohshme të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave për vitin 2021.

Sipas krahasimit të strukturës organizative dhe organikës në fakt në dhjetor 2022 konstatohet se nga 137 punonjës në strukturë, 41 janë pozicione vakante, dhe mosrealizimi i këtyre zërave shpenzimesh vjen për shkak të vendeve vakante në GJL.

- Realizimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime është realizuar në masën 21,672 mijë lekë ose 84%, me një mosrealizim në shumën 4,184 mijë lekë.

Tabela nr.1: Realizimi i llogarisë “602”

Në lekë

Shpenzime 602	Plan	Fakt	Realizimi %
Materiale dhe shërbime zyre	2,347,000	1,775,740	76%
Shërbime	9,325,167	8,031,271	86%
Shpenzime transporti	8,290,000	7,745,458	93%
Shpenzime udhëtimi	1,376,864	423,631	31%
Shpenzime mirëmbajtje	2,770,000	2,350,772	85%
Shpenzime të tjera	1,746,969	1,345,204	77%
Total	25,856,000	21,672,076	84%

Burimi: Gjykata e Lartë, përpunuar nga grupi i auditimit

- Realizimi i shpenzimeve për “Transferata” është realizuar në masën 97%, të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet për transferim në individ.

- Realizimi i shpenzimeve për investime është realizuar në masën 28,173 mijë lekë ose 89%, më një mosrealizim në shumën 3,377 mijë lekë. Projektet e investimeve të financuara nga buxheti i shtetit viti 2021 dhe të realizuara paraqiten si mëposhtë:

Tabela nr.2: Realizimi i shpenzimeve për investime

Në lekë

Emërtimi i projektit	Plani vjetor	Plani rishikuar	Realizimi faktik	Përqindja e realizimit kundrejt planit vjetor
Rikonstrukcion	18,650,000	17,580,000	17,580,000	94%
Pajisje mobilje	2,220,000	2,220,000	1,736,780	78%
Pajisje elektronike	2,890,000	2,890,000	0	Procedurë e parealizuar pasi ka patur ankesa nga operatorët në fazën e shpalljes së dokumenteve të tenderit për herën e dytë.
Blerje makina	9,000,000	8,860,000	8,856,000	98%
Totali	32,760,000	31,550,000	28,172,780	86%

Burimi: Gjykata e Lartë, përpunuar nga grupi i auditimit

Projekti “Pajisje elektronike” nuk u realizua përgjatë vitit 2021 duke sjellë mosrealizim të fondit të planifikuar buxhetor për të në vlerën 2,890 mijë lekë. Kjo ka ardhur si pasojë e ankimimit në K.P.P të një Operatori Ekonomik. Në vijim procedura është pezulluar dhe më pas zhbllokuar nga KPP me shkresë nr. 4937 prot. në datë 28.12.2021. Në këtë datë nga GJL ka qenë i pamundur përfundimi dhe realizimi i procedurës në fjalë.

Realizimi i 8 - mujorit të buxhetit të vitit 2022

Sipas krahasimit të strukturës organizative dhe organikës në fakt në tetor 2022 konstatohet se nga 145 punonjës në strukturë, 35 janë pozicione vakante.

Raporti përmbledhës i monitorimit për periudhën Janar – Gusht 2022 i është dërguar KLGJ me shkresën nr. 4656, datë 19.09.2022 “Raportet e monitorimit për periudhën Janar – Gusht 2022”.

Realizimi i buxhetit të Gjykatës së Lartë për periudhën Janar – Gusht 2022 krahasuar me alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar paraqitet sipas **Aneksit 1.13** “Realizimi i buxhetit për periudhën Janar – Gusht 2022”, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mosrealizimi i Programit “Buxheti gjyqësor” për Gjykatën e Lartë kundrejt planit vjetor të rishikuar për periudhën Janar – Gusht 2022 rezulton në shumën 83,956 mijë lekë ose 36% kundrejt planit buxhetor të rishikuar për këtë periudhë. Peshën kryesore në këtë mosrealizim e përbëjnë shpenzimet korrente në shumën 52,339 mijë lekë dhe konkretisht artikulli 600 “Paga” në shumën 34,796 mijë lekë. Shpenzimet kapitale konstatohen të kenë një mosrealizim në shumën 31,567 mijë lekë.

- Realizimi i shpenzimeve për “Paga” është realizuar në masën 110,404 mijë lekë ose 76%, me një mosrealizim në shumën 34,796 mijë lekë. Realizimi i shpenzimeve për kontribute të sigurimeve shoqërore është realizuar në masën 13,321 mijë lekë ose 74%, me një mosrealizim në shumën 4,779 mijë lekë. Këto zëra shpenzimesh janë realizuar për një numër faktik prej 110 punonjës, nga 145 që ka miratuar ligji vjetor i buxhetit. Sipas krahasimit të strukturës organizative dhe organikës në fakt në gusht 2022 konstatohet se nga 145 punonjës në strukturë, 35 janë pozicione vakante, dhe mos realizimi i këtyre zërave shpenzimesh vjen për shkak të vendeve vakante në GJL.

- Realizimi i shpenzimeve për “Mallra dhe shërbime” është realizuar në masën 21,518 mijë lekë ose 63%, me një mosrealizim në shumën 12,682 mijë lekë.

Realizimi i llogarisë “602” konstatohet të jetë realizuar për shpenzime për: materiale dhe shërbime zyre në shumën 1,131 mijë lekë, shërbime printimi në shumën 1,230 mijë lekë, shërbim postar në shumën 1,071 mijë lekë, blerje karburanti në shumën 1,979 mijë lekë, udhëtime jashtë vendit në shumën 1,627 mijë lekë, pjesë këmbimi në shumën 1,434 mijë lekë, kuotizacioni në shumën 439 mijë lekë, pritje në shumën 202 mijë lekë, etj.

- Realizimi i shpenzimeve për “Transferta” është realizuar në shumën 495 mijë lekë, të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet për ndihma ekonomike, kompensim për shpenzimeve për celular, shpërbllim page për punonjës, etj.

- Realizimi i shpenzimeve për investime është realizuar në masën 6,483 mijë lekë kundrejt 39,050

mijë lekë të planit të rishikuar. Projektet e investimeve të financuara nga buxheti i shtetit viti 2022 dhe të realizuara deri më 30.08.2022 paraqiten si mëposhtë:

Tabela nr.3: Realizimi i shpenzimeve për investime

Në mijë lekë

Emërtimi i projektit	Plani vjetor	Plani rishikuar	Realizimi faktik
Rikonstruksion	25,000	25,000	6,483
Projekt	29,000	-	-
Pajisje mobilje	5,550	5,550	-
Pajisje elektronike	8,500	6,500	-
Pajisje software	-	1,700	-
Totali	68,050	39,050	6,483

Burimi: Gjykata e Lartë, përpunuar nga grupi i auditimit

Auditimi i të ardhurave:

Përveç fondeve buxhetore Gjykata e lartë në zbatim të VKM nr. 432, datë 08.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave detyësore që krijojnë institucionet buxhetore”, si dhe Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë të Drejtësisë nr. 33, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore”, krijon të ardhura të tjera të cilat i derdh në buxhetin e shtetit.

Për vitin 2020:

Për vitin 2020 janë arkëtuar 280,760 lekë, nga të cilat:

- ✓ Të ardhurat nga taksat e akteve të pullës në shumën 22,040 lekë, e cila përkon me 1 % të arkëtimit total nga taksat e pullës;
- ✓ Të ardhurat nga qeratë në shumën 29,700 lekë;
- ✓ Të ardhura nga depozita në ruajtje në shumën 198,360 lekë;
- ✓ Të ardhura nga fotokopje në shumën 30,660 lekë.

Referuar aktit të rakordimit me thesarin, rezulton se gjatë vitit 2020, të ardhurat progresive të krijuara janë të rakorduara me thesarin dhe kapin vlerën 280,760 lekë, nga kjo shumë pjesa e institucionit për rritje të autorizuar është 198,360 lekë dhe shuma e derdhur në buxhetin e shtetit është 82,400 lekë.

Për vitin 2021:

Për vitin 2021 janë arkëtuar 780,050 lekë, nga të cilat:

- ✓ Të ardhurat nga taksat e akteve të pullës në shumën 44,400 lekë, e cila përkon me 1 % të arkëtimit total nga taksat e pullës,
- ✓ Të ardhurat nga qeratë në shumën 31,050 lekë;
- ✓ Të ardhura nga gjoba gjyqësore në shumën 305,000 lekë;
- ✓ Të ardhura nga pullat në shumën 399,600 lekë e cila i përket 90% të të ardhurave nga pullat.

Në zbatim të Udhëzimit të Përbashkët nr. 33, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore”, e Ministrisë të Drejtësisë, pika 12, ku citohet që “...për shërbimin e kryer, institucionet përkatëse të gjykatës, Ministrisë së Drejtësisë dhe prokurorisë përfitojnë 10% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që kanë arkëtuar”.

Referuar aktit të rakordimit me thesarin, rezulton se gjatë vitit 2021, të ardhurat jotatimore progresive të krijuara janë të rakorduara me thesarin dhe kapin vlerën 780,050 lekë, nga kjo shumë pjesa e institucionit për rritje të autorizuar është 399,600 lekë dhe shuma e derdhur në buxhetin e shtetit është 380,450 lekë.

Për vitin 2022:

Për vitin 2022 janë arkëtuar 463,353 lekë, nga të cilat:

- ✓ Të ardhurat nga taksat e akteve të pullës në shumën 40,600 lekë, e cila përkon me 1 % të arkëtimit total nga taksat e pullës;

- ✓ Të ardhurat nga qerata në shumën 31,720 lekë;
- ✓ Të ardhura të tjera sekondare (përfshirë posta) 22,000 lekë;
- ✓ Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve në shumën 3,633 lekë;
- ✓ Të ardhura nga pullat në shumën 365,400 lekë.

Referuar aktit të rakordimit me thesarin, rezulton se deri në muajin tetor 2022, të ardhurat progresive të krijuara janë të rakorduara me thesarin dhe kapin vlerën 463,353 lekë, nga kjo shumë pjesa e institucionit për rritje të autorizuar është 365,400 lekë dhe shuma e derdhur në buxhetin e shtetit është 57,353 lekë, mbeten për tu paguar 40,600 lekë.

Konkluzion:

Nga auditimi rezultoi se nga Gjykata e Lartë, çdo vit janë përgatitur raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit. Monitorimet dhe raportimet për ekzekutimin e buxhetit janë të rakorduara në bazë mujore dhe vjetore me degën e thesarit. Raportet e monitorimit janë të shoqëruara me relacione shpjeguese mbi arritjet e objektivave të politikës së programit të synuara dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor. Veprime në përputhje me pikën 42 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore".

2.2 Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.

Në zbatim të pikës nr. 2 të programit të auditimit u shqyrtuar dokumentacioni si mëposhtëm:

- 1) Struktura organizative;
- 2) Vendimet për emërimet, largimet dhe zbatimin strukturave organizative
- 3) Dokumentacioni i dosjeve individuale të punonjësve të institucionit;
- 4) Vendimet gjyqësore për marrëdhëniet e punës;
- 5) Listëpagesat mujore dhe librat e pagave.

Për auditimin e marrëdhënieve të punës dhe pagave grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore:

- Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë
- Ligji 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar
- Ligji 98/2016, datë 06.10.2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", të nenit 50, 84-88.
- Rregullorja e Brendshme e Gjykatës së Lartë miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 643, datë 23.12.2020 "Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë".
- Vendimit nr. 1, datë 21.1.2021 të Këshillit të Gjykatës "Për miratimin e strukturës, organikës përshkrimin e punës dhe klasifikimit të vendeve të punës të punonjësve të Gjykatës së Lartë".
- Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 338, datë 24.09.2020, "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykate".
- VKM nr. 545, date 11.08.2011 "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civil/ nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabinetëve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, Gjykatën e Lartë, disa institucione të pavarura, institucione në varësi të Kryeministrit, institucione në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e Prefektit" të ndryshuar.
- VKM 929, datë 27.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar

- **Struktura organizative**

Për periudhën objekt auditimi gjykata ka funksionuar bazuar në strukturën organizative të miratuar

nga Kryetari i Gjykatës së Lartë me Urdhrin nr. 265, date 20.11.2014 "*Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të vendeve të punës të personelit të Gjykatës së Lartë*", ndryshuar. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 643, datë 23.12.2020 "*Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësiive të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë*", Këshilli i Gjykatës së Lartë me Vendimin nr. 1, date 21.01.2021, dhe "*Për miratimin e strukturës, Organikës, përshkrimin e punës dhe klasifikimit të vendeve të punës të punonjësve të Gjykatës së Lartë*", ka miratuar strukturën organike me 131 punonjës.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 84, datë 11.03.2021, ka miratuar shtesë në organike me 6 (gjashtë) punonjës përkatësisht: me 6 sekretare gjyqësore, ku numri i punonjësve në organike është rritur në 137 punonjës, miratuar nga Këshilli Gjykatës së Lartë me vendimin nr 46, datë 1.4.2021 "*Për miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Këshillit të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 21.1.2021*".

Për vitin 2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 72, datë 23.02.2022 "*Për detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2022*", ka miratuar shtesë në organike me tetë punonjës përkatësisht; 3 punonjës me pozicion jurist; 4 punonjës me pozicion Sekretar Gjyqësore dhe 1 punonjës me pozicion sanitar. Numri i punonjësve në organike është rritur në 145 punonjës. Miratuar nga Këshilli Gjykatës së Lartë me Vendimin nr 4, datë 02.03.2022 "*Për miratimin e strukturës, organikës, përshkrimin e punës dhe klasifikimit të vendeve vakante të punës të punonjësve të Gjykatës së Lartë*".

Nga krahasimi numrit të punonjësve sipas strukturës të miratuar me numrin e punonjësve në fakt, në fund të muajit shtator 2022 (fundi periudhës të audituar), rezulton se struktura fakt është 114, e paplotësuar me një numër prej 31 punonjësish.

Gjykata e Lartë, drejtohet nga Zëvendëskryetari që nga data 27.07.2019, pas shkarkimit të Kryetarit të Gjykatës nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

Vendet vakante me 30.09.2022 janë: 3 vakancat në trupën gjyqësore; 1 këshilltarë ligjore në kabinet; 1 kancelarit që nga marsi i vitit 2019; 10 këshilltarë ligjorë; 2 nëpunës civil gjyqësorë; 3 specialistë në Qendrën e dokumentacionit; 8 shofer për gjyqtarët; 2 punonjës sigurie.

GJL ka funksionuar në bazë të Rregullores së Brendshme miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 643, datë 23.12.2020. Gjatë viteve 2021-2022 struktura e GJL ka pësuar ndryshime, të cilat këto ndryshime pritet të reflektohen në rregulloren e re e cila është në proces.

- **Pagat dhe shpërblimet**

Nga auditimi i listëpagesave rezultoi se përgatitja e tyre është mbështetur në listë prezencat mujore, të plotësuar nga çdo drejtori apo sektor. Listë prezencat mujore për përgatitjen e borderove për punonjësit e institucionit janë bërë në mënyrë të përmbledhur, me numrin e ditëve të punës në muaj të paraqitur nga çdo drejtori apo sektor dhe mbi bazën e verifikimit të prezencës çdo ditë nga punonjësi i Burimeve Njerëzore.

Nga auditimi i të dhënave në listëpagesat, duke i kryqëzuar me përcaktimet e emërtimeve në strukturë, për periudhën objekt auditimi, rezulton se është respektuar struktura organizative e miratuar.

Nga auditimi mbi zbatimin e udhëzimit nr. 4, datë 13.12.2016, "*Për Formën. Elementet dhe plotësimin e Borderosë së Pagave*", të Ministrisë së Financave, ndryshuar me udhëzimin e përbashkët të përbashkët të MFE dhe DAP nr. 1, datë 21.5.2021 "*formën, elementët dhe plotësimin e listëpagesës mujore të pagave...*" rezulton se, hartimi i tyre për periudhën tetor 2021-2022 është kryer sipas formatit standard të miratuar.

Pagat e punonjësve janë vendosur sipas funksionit dhe kategorisë në përputhje me ligjin Nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", me Ligjin nr. 96/2016 "*Për Statusin Gjyqtareve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Ligjin nr. 98/2016 "*Për organizimin e Pushtetit gjyqësor*".

në Republikën e Shqipërisë", VKM-në nr. 187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civile/nëpunësve,...disa institucioneve të pavarura..." i ndryshuar, VKM nr. 717, datë 23.06.2009, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar me VKM-në nr. 202, datë 15.03.2017.

- Nga auditimi i pagave sipas klasave dhe vendit të punës, për administratën mbështetëse rezultoi se ishte në përputhje me kategorinë e pagave sipas përcaktimit ligjor të VKM-së nr. 187, datë 08.03.2017.

Nga auditimi në lidhje me përputhjen e pagës sipas emërtesës së pozicionit sipas strukturës së miratuar me kategorinë e pagës për funksion rezultoi se:

Kancelarit (i ngarkuar në detyrë) nga data 19.3.2019 e në vijim, është paguar me kategorinë e pagës I-a, i cili ka vazhduar deri me datën 19.11.2020. Personi i ngarkuar në detyrë ka pasur emërimin specialist në sektorin e Marrëdhënieve me Median. Publikun e Biblioteka, që i përket kategorisë III-b, sipas VKM-së nr. 187, datë 8.3.2017, ndryshimi i kategorisë së pagës është konstatuar dhe shkelje nga auditimi i brendshëm i KLGJ-së, ku është rekomanduar:

“Nga Gjykata e Lartë të kryhet llogaritja e shumës së pagës të përfituar më shumë se sa është parashikuar në ligj, për Kancelarin (i ngarkuar në detyrë A.G) për periudhën 19.3.2019 deri në 19.11.2020, si dhe të nxirret akti administrativ për kthimin e shumës. ”

Me urdhrin nr. 30 datë 19.11.2020 të Këshillit të Gjykatës së Lartë është urdhëruar “z. A.G të trajtohet me pagën e specialistit, sipas kategorisë III-b duke filluar nga data 20.11.2020”.

Sa më sipër z. A.G ka ngritur kërkesë padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me objekt: *Detyrimin e palës së paditur ti paguajë paditësit pagën për pozicionin e punës që ushtronte përkohësisht si Kancelar i Gjykatës së Lartë nga data 20.11.2020 deri në përfundim të ushtrimit të këtij funksioni.*

Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë ka dalë me Vendimin nr. 1421, datë 05.02.2022, ku ka vendosur: *“Detyrimin e palës së paditur GJL që ti paguajë paditësit pagën e pozicionit të punës që ushtronte përkohësisht si Kancelar në GJL nga data 20.11.2020 deri me datën 23.03.2022”*

Gjykata e Lartë ka bërë kërkesë ankimore pranë Gjykatës Administrative të Apelit me nr. 2392, datë 26.05.2022.

Referuar Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Juridiksioni” neni 36, ku citohet se *“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata”*, grupi auditimit nuk e ka trajtuar si konstatim dhe si gjetje këtë problematikë.

- Nga auditimi i kryer në lidhje me llogaritjen dhe pagesën e shtesës së pagës për vjetërsi për trupën gjyqësore dhe vjetërsisë në punë të punonjësve administrativ, rezultoi se:

- Ndryshimet për efekt të rritjes së vjetërsisë në punë janë pasqyruar nga punonjësi burimeve njerëzore në fillim të çdo viti si dhe në rastet e rekrutimeve është përcjellë me shkresë zyrtare për pagesë në sektorin e financës, për tu reflektuar në shtesën për pagesë në listëpagesa.
- Nga krahasimi i viteve të punës në librezë me përlllogaritjet e kryera për shtesë page për efekt të vjetërsisë në punë referuar listëpagesave nuk kishte diferenca.

- Nga auditimi i listëpagesave rezultoi se pagesat e realizuara në lidhje me vlerën e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar ishte llogaritur dhe paguar në përputhje me VKM-në nr. 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar.

Titulli i Gjetjes:	Shtesë page për natyrë të veçantë pune.
Situata:	Nga auditimi i listëpagesave u konstatua se: Për pagesën shtese page për natyrë të veçantë janë trajtuar me “shtesë page për natyrë të veçantë pune” specialistët e IT-së, në vlerë 7,500 lekë në muaj, sipas miratimit të marrë nga Departamenti i Administratës Publike me shkresën nr 3467/1, datë 8.6.2021. Në shkresën e dërguar nga DAP për

	<p>shtesë page “për natyre të veçantë pune” specialistëve të IT-së nuk ka asnjë arsytim se pse kjo shtesë page është kategorizuar në vlerë 7,500 lekë në muaj dhe jo në vlerën 15, 000 lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave të TIK, të cilët punojnë me bazat e të dhënave shtetërore.</p> <p>Gjykata e Lartë operon dhe administron “Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, ICMIS”.</p> <p>“Sistemin e Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, ICMIS” shfaqë/pasqyron ecurinë e çështjeve gjyqësore që prej regjistrimit deri në mbylljen e tyre me vendimmarrje, veprime të cilat replikohen/përditësohet çdo ditë në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë sipas legjislacionit në fuqi, përfshire akte, udhëzime, rregullore. Referuar nenit 3 të ligjit nr. 10 325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” ku citon se a) “Baza e të dhënave shtetërore” kuptohet grumbullimi i organizuar i informacionit, i ruajtur në formë elektronike, ku përpunimi dhe përditësimi i tij kryhen nëpërmjet një sistemi kompjuterik, si pjesë e plotësimit të detyrimeve ligjore të institucionit administrues, si dhe nenit 2 të këtij ligji pika 2 ku citon se “Bazat e të dhënave shtetërore, që krijohen për të plotësuar vetëm kërkesat për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të institucionit publik, nuk i nënshtrohen këtij ligji”. Sa më sipër nga analiza dhe raportimi i të dhënave që bën ky sistem kemi të bëjmë me “Baza e të dhënave shtetërore”, të cilat nuk përfshihet në kategorinë e të dhënave të përcaktuar në pikën 2 të nenit 2, pasi këto të dhëna përditësohen për publikun në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 10 325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” neni 3; VKM-ja nr. 187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civil/ nëpunësve,”, i ndryshuar.
Shkaku:	Mos analizim nëse ky sistem kategorizohet në sistemet që kanë të bëjnë me “Baza e të dhënave shtetërore”.
Rëndësia:	E ulët
Rekomandimi:	Nga Gjykata e Lartë të ribëhet kërkesë pranë Departamentit të Administratës Publike në lidhje me kategorizimin e trajtimit për “shtesë page për natyre të veçantë pune” për specialistët e IT-së, shoqëruar me një analizë të hollësishme në lidhje me përmbajtjen e sistemit dhe klasifikimin e tij si “Baza e të dhënave shtetërore”.

- Nga krahasimi i numrit të ditëve të pasqyruara në listëprezencë me numrin e ditëve në listëpagesë nuk rezultuan diferenca.
- Nga auditimi mbi përputhjen dhe saktësinë e pagave të paguara në bankë sipas punonjësve me pagën neto në listëpagesë, rezulton se: paga neto e pasqyruar në listëpagesë është e njëjtë me pagën neto të pasqyruar në llogarinë personale sipas formatit të listëpagesës së bankës.
- Në lidhje me llogaritjen e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimi mbi pagat dhe të ardhurat personale është zbatuar ligji nr. 7703, datë 11.05,1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 8438, datë 28.12,1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të cilat janë derdhur në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë sipas afateve të përcaktuara ligjore. Llogaritjet janë kryer për çdo punonjës, janë ndaluar nga paga sigurimet shoqërore e Shëndetësore duke respektuar kufirin minimal e maksimal, tatimi mbi pagën.
- Nga auditimi rezulton se: fondi i veçantë për periudhën objekt auditimi është përdorur në raste të daljeve në pension pleqërie, fatkeqësish dhe ndihmë ekonomike.

- **Procedurat e rekrutimit dhe largimit nga puna:**

**Procedura e rekrutimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë*

Nga auditimi rezulton se procedura janë bërë në përputhje me përcaktimet ligjore bazuar në nenin 54, 55, 56, 57, 58, 60, 62 të Ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë". Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 622, datë 10.12.2020 "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor". Udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021 "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurimit të hapur".

Me zgjedhje u audituar dosjet:

- Në lidhje me rregullshmërinë e pranimit në shërbimin civil, konkretisht:

Dosja që i përket specialistes së financës emëruar me urdhrin nr. 56, datë 07.03.2022, dosja e specialistit të IT, emëruar me urdhrin nr. 189, datë 10.06.2022.

- Në lidhje me rregullshmërinë e procedurës së kryer për lëvizje paralele; dosja që i përket 5 sekretare gjyqësore emëruar përkatësisht me urdhrin nr. 57 datë 27.03.2022; urdhrin nr. 153 & 154, datë 20.05.2022 dhe urdhrin nr. 226&227 datë 15.07.2022.

Në lidhje me rregullshmërinë e rekrutimit të punonjësve të tjerë, të cilat janë bërë në përputhje me Kodin e Punës.

**Procedura e punësimit me kontratë pune të përkohshme* është realizuar sipas nenit 18 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Rekrutimi i punonjësve me kontratë realizohet si më poshtë:

a. Sipas kërkesave që bëhen nga Gjykata e Lartë gjatë planifikimit të PBA-së drejtuar KLGJ.

b. Nëpërmjet pozicioneve me kontratë të përkohshme që ju miratohet me VKM-të përkatësisht: Me VKM-në nr. 1151, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021" për dy punonjës dhe me VKM-në nr. 35, datë 19.01.2022 "Për detajimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2022" për 4 punonjës.

**Largimet*

Për periudhën 2020-2022 nga auditimi u konstatua se ndërprerja e marrëdhënieve të punës kanë ndodhur si rrjedhojë e dorëheqjeve dhe daljeve në pension.

- **Dosjet e personelit**

Nga auditimi rezulton se është krijuar regjistri themeltar i punonjësve administrativ, në përputhje me nenin 36 "Regjistri", të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës Shqipërisë". i ndryshuar.

Regjistri themeltar i punonjësve është plotësuar në të gjitha referencat e tij, është sekretuar dhe vulosur me vulën e institucionit në të gjitha faqet, gjendja e regjistrit themeltar është e mirë.

Në zbatim të ligjit Nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", neni 63 "Dosja dhe Regjistri Qendror i Personelit", dhe të VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", nga Gjykata e Lartë është krijuar regjistri elektronik i personelit, ku ka filluar hedhja e të dhënave profesionale, si dhe të dhëna të tjera në lidhje me marrëdhënien e punës për punonjësit.

Nga auditimi për administrimin dhe plotësimin e dosjeve personale të punonjësve me zgjedhje nuk janë konstatuar parregullsi dhe mangësi në dokumentacionin e dosjes. Dosjet ishin të plotësuar sipas VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit" lidhja 1 "Të dhënat dhe dokumentacioni i dosjes së personelit".

- **Vlerësimi financiar të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, me qëllim mbrojtjen e interesave ekonomike shtetërore dhe ruajtjen e pavarësisë së gjyqësorit.**

Një ndër efektet e rëndësishme që solli zbatimi reformës në drejtësi është mënyra e zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë (GJL), sipas një procedure hollësisht të përcaktuar dhe përmbushjes së kriterëve profesionale, objektivisht të matshme. Kombinimi i aspekteve procedurale me kriteret profesionale synon të garantojë zgjedhjen e magistratëve më cilësorë, nga radhët e sistemit ose të juristëve të spikatur profesionalisht, si pjesë e organit më të lartë gjyqësor në vend.

Të tri fashat e emërimeve kanë të njëjtin qëllim, plotësimin e GJL me gjyqtare, por rezulton se gjyqtarët e kësaj Gjykate nuk kanë të njëjtin trajtim financiar. Ata përfitojnë paga të diferencuara nga njëri tjetri, pavarësisht se kanë të njëjtin status kushtetues, kryejnë të njëjtën detyrë, me të njëjtën përgjegjësi dhe i nënshtrohen të njëjtave rregulla procedurale, materiale apo disiplinore. Kjo situatë e trajtimit të ndryshëm financiar për tre kategori të gjyqtarëve në GJL ka ndikuar drejtpërdrejtë edhe në trajtimin me një pagë më të ulët të Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit të GJL, në raport me pagën e një gjyqtari të GJL.

Konkretisht, në bazë të ligjit, gjyqtarët e Gjykatave të Posaçme, për shkak të vështirësisë dhe natyrës së punës, kanë një trajtim të diferencuar financiar nga pjesa tjetër e gjyqtarëve të GJL. Ky trajtimi diferencuar vlen dhe për aspekte të tjera. Nga ana tjetër, gjyqtarët e GJL që vijnë nga radhët e magistratëve përfitojnë shtesën për vjetërsi dhe shtesa të tjera, ndërsa gjyqtarët e GJL, të cilët vijnë nga radhët e juristëve të spikatur, **nuk i përfitojnë.**

➤ **Koncepti i pagës së gjyqtarit**

Koncepti i njohur nga legjislacioni ynë për pagën kundrejt një pune të caktuar nënkupton "pagën bazë, si dhe shtesat me karakter të përhershëm." Mbi këtë koncept është orientuar edhe nenit 11 i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH" që përcakton se paga e magistratit, duhet të jetë në përputhje me dinjitetin e detyrës së magistratit dhe të përshtatshme për të garantuar pavarësinë dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e jashtme në ushtrimin e funksioneve të tyre. Më tej, në pikën 2 janë dhënë kriteret e caktimit të pagës, ku përfshihet: "(i) shkalla e gjykatës ku magistrati ushtron funksionin, (ii) vjetërsia në ushtrimin e funksionit, (iii) fusha e veçantë e kompetencës lëndore në të cilën magistrati ushtron funksionin, (iv) pozicioni drejtues Të gjitha këto "shtesa me karakter të përhershëm" janë pjesë e pagës së gjyqtarit. Ndërsa në pikën 3 të nenit 11 ligjvënësi ka parashikuar përfitimet e tjera financiare, të cilat nuk janë pjesë e pagës, por jepen për një kohë dhe arsye të caktuara si (i) kompensimi për transferimin e përkohshëm ose skemën e delegimit, (ii) shpërblim për aftësi, (iii) pension suplementar, (iv) çdo përfitim tjetër, bazuar në kushtet e veçanta të punës ose gjendjen personale dhe familjare të gjyqtarit.

Pra, elementët e parashikuara në pikën 1 dhe 2 të nenit 11 duhet të gjejnë pasqyrim dhe në përlllogaritjen e pagës së magistratit, gjë në fakt konkretizohet më tej në nenin 12 pika 5 të këtij ligji.

Kështu paga mujore bruto e magistratit përbëhet a) paga referuese bazë b) shtesa për pagën në grup c) shtesa për vjetërsi ç) shtesa për pozicionin drejtues, d) shtesë për vështirësi pune, sipas parashikimeve të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", formulë e cila është e përhapur dhe në vendet e bashkimit evropian përjashtuar **shtesën për vështirësi, e cila është e diferencuar dhe nuk haset në asnjë nga praktikat evropiane.** Në të gjithë legjislacionet e vendeve të Bashkimit Evropian, vihet re se përlllogaritja e pagës së gjyqtarëve, vjetërsia në detyrë parashikohet si pjesë e pagës, pavarësisht pozicionit të punës deri në një maksimum ligjor të parashikuar, i cili varion nga 20-35 vjet.

➤ **Standardet ndërkombëtare të pranuar**

Në kuadrin normativ ndërkombëtar, në lidhje me garancitë e pavarësisë së gjyqtarit është edhe trajtimi financiar. Në Kartën Evropiane mbi statutin e gjyqtarëve, në pikën 6,2 theksohet se,

"Shpërblimi mund të ndryshojë në varësi të kohëzgjatjes së shërbimit, natyrës së detyrave që u caktohen gjyqtarëve për të përmbushur cilësinë profesionale dhe rëndësinë e detyrave që u ngarkohen atyre, të vlerësuara në kushte transparente".

Në Rekomandimin CM/Rec (2010)12 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi gjyqtarët theksohet se, "Shpërblimi i gjyqtarëve duhet të jetë proporcional me profesionin dhe përgjegjësitë e tyre dhe të jetë i mjaftueshëm për t'i mbrojtur ata nga nxitjet që synojnë të ndikojnë në vendimet e tyre".

Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropiane, në Opinionin nr. 1 të tij shprehet: "KKGJE konsideroi se ishte përgjithësisht e rëndësishme (dhe veçanërisht në lidhje me demokracitë e reja) që të bëheshin dispozita të veçanta ligjore që garantojnë pagat gjyqësore kundër zvogëlimit dhe për të siguruar të paktën de facto parashikimin e rritjes së pagave në përputhje me koston e jetesës".

Karta Universale e Gjyqtarit (miratuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Gjyqtarëve), në nenin 8, përcakton: "Gjyqtari duhet të marrë shpërblim të mjaftueshëm për të siguruar pavarësinë e vërtetë ekonomike dhe, përmes kësaj, dinjitetin, paanësinë dhe pavarësinë e tij. Shpërblimi nuk duhet të varet nga rezultatet e punës së gjyqtarit, ose nga performanca e tij/saj dhe nuk duhet të reduktohet gjatë shërbimit të tij gjyqësor".

Ndërsa në Deklaratën e Brijunit për Parimet e Pavarësisë së Gjyqësorit, nga Konferenca e Kryetarëve të Gjykatave të Larta të Evropës Qendrore dhe Lindore, në pikën 27, theksohet: "Të ardhurat dhe kushtet e punës të gjyqtarëve nuk duhet të ndryshohen në dëm të gjyqtarëve gjatë afatit të detyrës së tyre, përveç në rast të një emergjence ekonomike apo buxhetore".

Nga analiza gjykatave simotra në Evropë lidhur me statusin e gjyqtarëve tregojnë qartë mbi papajtueshmërinë që situata aktuale e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë ka me to.

➤ *Situata ligjore dhe faktike e pagës së gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë*

Në GJL janë të emëruar tre grupe gjyqtarësh nga radhët e juristëve të spikatur, nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatave të Posaçme (shkalla e parë dhe apeli), si dhe nga radhët e gjykatave të apelit të juridiksionit të zakonshëm. Kjo ndërthurje e përvojës ka nxjerrë në pah një dallim tepër thelbësor (jo aq të pritur), që ka të bëjë ngushtësisht me ushtrimin dinjitoz të funksionit të gjyqtarit. Ky dallim lidhet drejtpërdrejt **me shpërblimin financiar të tyre (pagën)**, e cila është e ndryshme, megjithëse kryejnë të njëjtën detyrë, kanë të njëjtën përgjegjësi dhe përballojnë të njëjtën ngarkesë pune.

Gjyqtarët që kanë ardhur nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar përfitojnë, respektivisht, pagën e grupit G3, së bashku me shtesën për vjetërsi, si dhe një shtesë për vështirësi pune, sipas parashikimeve të ligjit, **në masën 80 për qind** të pagës bruto fillestare. Ky detyrim që buron nga standardet e gjithëpranuar ndërkombëtarisht dhe që mishërohet edhe në nenin 138 të Kushtetutës, por jo në ligjin 96/2016 "Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" është arsyeja që gjyqtarët e zgjedhur në GJL nga gjykatat e posaçme të përfitojnë (në respekt të paprekshmërisë) pagën përkatëse, së bashku dhe me përfitimet e tjera financiare në të njëjtën masë që i përfitonin në kohën kur ushtronin detyrën e gjyqtarit pranë atyre gjykatave.

Pikërisht, respektimi i standardit kushtetues të paprekshmërisë së pagës për gjyqtarët e zgjedhur, **kundrejt parashikimit jo korrekt të nenit 12 të ligjit 96/2016 "Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë"**, ka sjellë një situatë pabarazie të pagës midis gjyqtarëve të GJL. Gjithashtu, për shkak të këtij parashikimi ligjor që nuk llogarit vjetërsinë mbi 15 vite punë për gjyqtarët e GJL që vijnë nga radhët e juristëve të spikatur, në ndryshim nga ata që zgjidhen nga radhët e magjistratëve, **rezulton të jetë thelluar edhe më tej diferenca në pagë mes gjyqtarëve të GJL**. Nga analiza e pagave, rezulton se diferenca e pagës ndërmjet gjyqtarëve të GJL është tepër e ndjeshme. Kjo situatë e trajtimit të ndryshëm financiar për tre kategori të gjyqtarëve në GJL ka

ndikim të drejtpërdrejtë edhe në trajtimin me një pagë më të ulët të Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit të GJL, në raport me pagën e një gjyqtari të GJL.

Kategoria	Llogaritja e pagës	Shtesë për vështirësi	shtesa për vjetërsi	Paga Totale
Kryetar	Paga e grupit +paga e funksionit+vjetërsi fillestare+shtesa për funksion 10%	0	15	303,044
	Paga e grupit +paga e funksionit+vjetërsi fillestare+shtesa për funksion 10%	0	25	326,664
Zv/Kryetar	Paga e grupit +paga e funksionit+vjetërsi fillestare+shtesa për funksion 5%	0	15	290,880
	Paga e grupit +paga e funksionit+vjetërsi fillestare+shtesa për funksion 5%	0	25	314,500
Gjyqtarët e zgjedhur nga radhët e gjykatave të posaçme	Paga e grupit +paga e funksionit+vjetërsi progresive+vështirësi pune	145,972	25	448,308
Gjyqtarët e zgjedhur nga radhët e magjistratëve	Paga e grupit +paga e funksionit+vjetërsi progresive	0	25	302,336
Gjyqtarët e zgjedhur nga radhët e juristëve të spikatur	Paga e grupit +paga e funksionit+vjetërsi fillestare	0	15	278,716

Të gjitha çështjet që gjykojnë nga gjykatat e posaçme shqyrtohen në shkallë të fundit nga GJL, e cila në përbërje të saj ka edhe gjyqtarë që nuk i përkasin kategorisë së gjyqtarëve që vijnë nga gjykatat e posaçme. Pra, gjyqtarët që vijnë nga radhët e magjistratëve të sistemit, ashtu edhe ata që vijnë nga radhët e juristëve të spikatur, të cilët givkojnë çështjet e gjykatave të posaçme rezultojnë të kenë një trajtim të pabarabartë në pagë, pavarësisht se në nivelin hierarkik të gjyqësorit janë më lartë.

Gjithashtu, në nenin 13/1 të ligjit 96/2016, i ndryshuar me ligjin 50/2021, citohet se “ në rastet kur gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit të juridiksionit të zakonshëm delegohet për çështje të veçanta në gjykatën e posaçme *përfiton shtesë të reduktuar për vështirësi pune, por jo me shume se gjysma e shtesës sipas shkronjës "d" të pikës 5 të nenit 12 të këtij ligji*”, shtesë e cila rezultojnë në masën 40 për qind të pagës bruto fillestare.

Sa më sipër gjyqtarë e GJL, në zbatim të nenit 31 të ligjit 98/2016 pika 1 ku citohet se “Gjykata e Lartë organizohet në Kolegjin Civil, Kolegjin Penal dhe Kolegjin Administrativ ” dhe pika 3 “Kolegji Penal shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar për çështje penale”. Bëhen pjesë e Kolegjit Penal, gjykojnë çështje të tilla, si dhe kanë të njëjtën vështirësi pune, nuk janë përfshirë në këtë rregullim ligjor, duke mos përfutur pagë të njëjtë dhe shtesë për vështirësi, sipas përcaktimit të këtij neni.

Mospërfshirja e tyre në hierarkinë e sistemit gjyqësor, pasi gjyqtarët e nivelit më të ulët marrin shtesë vështirësie, ndërkohë që gjyqtarët e Gjykatës më të Lartë në vend, të cilët rishikojnë vendimet e tyre, nuk e përfitojnë një gjë të tillë.

Gjithashtu sa është trajtuar dhe më sipër nga krahasimi me vendet e tjera evropiane në lidhje me vjetërsinë në punë është e paargumentuar, që një gjyqtar i GJL që zgjidhet nga radhët e juristëve të spikatur (një e pesta e gjyqtarëve të GJL), që sipas ligjit, pavarësisht viteve më të shumta në profesion, gjyqtarit të GJL nuk i llogaritet si ***vjetërsi me shume se 15 vite*** punë dhe përfitojnë pagë të njëjlojtë me atë të gjyqtarit të shkallës së parë.

Një zgjidhje e tillë, jo vetëm që nuk është motivuese për gjyqtarin, por është edhe në kundërshtim me konceptin e hierarkisë gjyqësore, pasi gjyqtari më i lartë që kontrollon vendimet e gjyqtarit më të ulët paguhet më pak se ky i fundit.

Titulli i Gjetjes:	Vlerësimi financiar të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë
Situata:	<p>Nga auditimi i pagave të gjyqtarëve u konstatua se, pavarësisht se kanë të njëjtin status kushtetues, kryejnë të njëjtën detyrë, me të njëjtën përgjegjësi dhe i nënshtrohen të njëjtave rregulla procedurale, materiale apo disiplinore, pagat e tyre janë të ndryshme:</p> <p>Konkretisht:</p> <p>Në GJL janë të emëruar tre grupe gjyqtarësh, nga radhët e juristëve të spikatur, nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatave të Posaçme (shkalla e parë dhe apeli), si dhe nga radhët e gjykatave të apelit të juridiksionit të zakonshëm.</p> <p>- Gjyqtarët që kanë ardhur nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar përfitojnë, respektivisht, pagën e grupit G3, së bashku me shtesën për vjetërsi, si dhe një shtesë për vështirësi pune, sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në masën 80 për qind të pagës bruto fillestare.</p> <p>Ky detyrim që buron nga standardet e gjithëpranuar ndërkombëtarisht dhe që mishërohet edhe në nenin 138 të Kushtetutës, por jo në ligjin 96/2016 "Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" është arsyeja që gjyqtarët e zgjedhur në GJL nga gjykatat e posaçme të përfitojnë pagën përkatëse, së bashku dhe me përfitimet e tjera financiare në të njëjtën masë që i përfitonin në kohën kur ushtronin detyrën e gjyqtarit pranë atyre gjykatave, në respektimin e standardit kushtetues të paprekshmërisë së pagës për gjyqtarët e zgjedhur.</p> <p>- Gjyqtarët që kanë ardhur nga radhët e juristëve të spikatur, sipas parashikimit pikës 4, të nenit 12 të ligjit 96/2016 "Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë", vjetërsia nuk ju llogaritet më shumë se mbi 15 vite punë, në ndryshim nga ata që zgjidhen nga radhët e magistratëve. Formulë e cila është e diferencuar dhe nuk haset në asnjë nga praktikat evropiane. Në të gjithë legjislacionet e vendeve të Bashkimit Evropian, vihet re se përlllogaritja e pagës së gjyqtarëve, vjetërsia në detyrë parashikohet si pjesë e pagës, pavarësisht pozicionit të punës deri në një maksimum ligjor të parashikuar, i cili varion nga 20-35 vjet.</p> <p>Ndryshimi ligjor ka ndikuar drejtpërdrejtë edhe në trajtimin me një pagë më të ulët të Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit të GJL, në raport me pagën e një gjyqtari të GJL, duke mbajtur parasysh që të dy këta drejtues zgjidhen nga radhët e gjyqtarëve të kësaj Gjykate, të cilët mund t'i përkasin kategorive që përfitojnë më pak se kolegët e tyre në të njëjtën gjykatë.</p> <p>Sa më sipër rezulton se diferenca e pagës ndërmjet gjyqtarëve të GJL është e konsiderueshme dhe është në papajtueshmëri me kuadrin normativ ndërkombëtar, ku trajtimi financiar është pjesë e garancitë e pavarësisë së gjyqtarit.</p> <p>Në ndryshimet ligjore të ligjit 96/2016 "Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë" me ligjin nr. 50/2021 të germës d pika 5 të nenit 12 "shtesë për vështirësi pune, në masën 80 për qind të pagës bruto fillestare, për magistratët që ushtrojnë funksionin pranë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, Gjykatës së</p>

	<p><i>Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”,</i> vihet re mospërfshirja e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, në lidhje me shtesën për trajtimin financiar të tyre, çka sjell cënim të konceptit të hierarkisë gjyqësore, pasi gjyqtari më i lartë që kontrollon vendimet e gjyqarit më të ulët paguhet më pak se ky i fundit.</p> <p>Të gjitha çështjet që gjykohen nga gjykatat e posaçme shqyrtohen në shkallë të fundit nga GJL, e cila në përbërje të saj ka edhe gjyqtarë që nuk i përkasin kategorisë së gjyqtarëve që vijnë nga gjykatat e posaçme. Pra, gjyqtarët që vijnë nga radhët e magistratëve të sistemit, ashtu edhe ata që vijnë nga radhët e juristëve të spikatur, mund të gjykojnë çështjet e gjykatave të posaçme, duke pasur një pagë më të ulët, në papajtueshmëri me nivelin hierarkik të gjyqësorit.</p> <p>Gjithashtu, në nenin 13/1 të ligjit 96/2016, i ndryshuar me ligjin 50/2021, citohet se “ në rastet kur gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit të juridiksionit të zakonshëm delegohet për çështje të veçanta në gjykatën e posaçme <i>përfiton shtesë të reduktuar për vështirësi pune, por jo me shume se gjysma e shtesës sipas shkronjës "d" të pikës 5 të nenit 12 të këtij ligji</i>”, shtesë e cila rezulton në masën 40 për qind të pagës bruto fillestare.</p> <p><i>Sa më sipër gjyqtarë e GJL, në zbatim të nenit 31 të ligjit 98/2016 pika 1 ku citohet se “Gjykata e Lartë organizohet në Kolegjin Civil, Kolegjin Penal dhe Kolegjin Administrativ ” dhe pika 3 “Kolegji Penal shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar për çështje penale. ” bëhen pjesë e Kolegjit Penal, gjykojnë çështje të tilla, si dhe kanë të njëjtën vështirësi pune, nuk janë përfshirë në këtë rregullim ligjor, duke mos përfituar pagë të njëjtë dhe shtesë për vështirësi, sipas përcaktimit të këtij neni.</i></p>
Kriteri:	<p>Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 138; Ligji 96/2016 “Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar , neni 12, nenin 13/1; Ligji 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësorë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 31; Karta Evropiane mbi statutin e gjyqtarëve, pika 6,2; Rekomandimi i CM/Rec (2010)12 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi gjyqtarët; Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropiane, në Opinionin nr. 1; Karta Universale e Gjyqarit (miratuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Gjyqtarëve), në nenin 8; Deklarata e Brijunit për Parimet e Pavarësisë së Gjyqësorit, nga Konferenca e Kryetarëve të Gjykatave të Larta të Evropës Qendrore dhe Lindore, pika 27.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Cënimi i konceptit të hierarkisë gjyqësore, pasi gjyqtari më i lartë që kontrollon vendimet e gjyqarit më të ulët paguhet më pak se ky i fundit.</p>
Shkaku:	<p>Ndryshimet ligjore të ligjit 96/2016 “Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë” me ligjin nr. 50/2021 të germës d pika 5 të nenit 12 , ku nuk janë përfshirë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë.</p>
Rëndësia:	<p>E lartë</p>

Rekomandimi:	Në vijimësi të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 35, datë 22.11.2022, botuar në Fletoren Zyrtare me datë 09.01.2023, Gjykata e Lartë në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësorë të marrin masa për hartimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore mbi trajtimin financiar, sa më të drejtë dhe në masë sa më të përafërt të anëtareve të GJL, pavarësisht se nga cila gjykatë apo karrierë profesionale vijnë, me qëllim rekrutimin e gjyqtarëve më të mirë të vendit, në terma kohorë afatgjatë, duke garantuar ruajtjen e pavarësisë dhe misionit që ka Gjykata e Lartë, si gjykatë karriere.
---------------------	--

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e dërguar me nr. 554/4 datë 15.12.2022, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 181 prot., datë 13.01.2023, protokolluar në KLSH me nr. 554/5 prot., datë 19.01.2023, ku janë shprehur si më poshtë: Pretendimi i subjektit:

Gjithashtu, dëshirojmë t'ju shprehim dhe një shqetësim që kemi ne si institucion lidhur pagën e kancelarit të Gjykatës, i cili nuk është trajtuar në projekt-Raport, dhe në këtë aspekt do të vlerësojmë mendimin tuaj të specializuar në këtë drejtim.

Detyra e kancelarit të gjykatës është një detyrë shumë e rëndësishme për faktin se sipas ligjit kancelari është strukturë drejtuese në gjykatë, i ngarkuar me përgjegjësinë e administrimit dhe menaxhimit gjyqësor, si dhe është njëkohësisht edhe anëtar i këshillit të gjykatës. Në kushtet e pamundësive objektive të plotësimit të vendit vakant të Kancelarit sipas kuadrit të ri ligjor, procesi i cilito të kërkonte shumë kohë si dhe për shkak të natyrës së punës së kancelarit të gjykatës i cili është një pozicion i domosdoshëm për mbarëvajtjen e punës së administratës gjyqësorë, është ngarkuar që të ushtroje përkohësisht këtë detyrë një nëpunës civil gjyqësor. Aktualisht ky nëpunës civil gjyqësor i ngarkuar të kryejë detyrën e kancelarit të Gjykatës së Lartë, vazhdon të trajtohet me pagën e specialistit, ndonëse, për shkak të pozicionit dhe detyrave që ka pozicioni i kancelarit, ai ushtron përgjegjësi dhe detyra me një volum pune shumë më të madh nga nëpunësit e tjerë (theksojmë se dhe në disa gjykata të tjera është e njëjta situatë, ku detyra e kancelarit i është ngarkuar një nëpunësi civil gjyqësor, por që nuk paguhet me pagën e kancelarit). Për arsyet e sipërpërmendura, për t'i dhënë një zgjidhje definitive dhe ligjore kësaj situatë, ju drejtohem ju për të na shprehur opinionin tuaj.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit nuk mund të shprehet në lidhje me këtë pikë për vete faktin se për të njëjtën çështje Gjykata e Lartë është në proces gjyqësorë nga paditësi z. A.G i cili ka mbajtur këtë pozicion, ku Referuar Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Juridiksioni” neni 36, ku citohet se “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata”, grupi i auditimit nuk e trajton dhe jep rekomandim për këtë çështje.

2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrjet, fletëdaljet, faturat tatimore dhe urdhërshpenzimet;
- Transaksionet e llogarive bankare/ ditarët e bankës dhe transaksionet nëpërmjet arkës
- Paga për shërbime të mallra/ shërbime, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme.

Auditimi u ushtua me zgjedhje. Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar).

“Kampioni i auditimit” dhe ISSAI 1530 “Shënime praktike mbi ISA 530”. “ISA 530 zbatohet kur audituesi ka vendosur të përdorë kampionimin e auditimit në kryerjen e procedurave të auditimit. Ai merret me përdorimin nga audituesi të kampionimit statistikor dhe jo statistikor gjatë hartimit dhe përzgjedhjes së kampionit të auditimit, kryerjen e testeve të kontroleve dhe testet e detajeve, dhe vlerësimin e rezultateve nga ky kampion, cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen”. Përkufizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: “Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampionët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur”.

Nga auditimi me zgjedhje mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër-shpenzim, etj.) të realizuara nga Sektori i financës dhe buxhetit së Gjykatës së Lartë, rezultoi se veprimet janë kryer konform Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligjit 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësisive që varen prej tyre”, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001, Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

a. Ligjshmëria dhe saktësia e kryerjes së veprimeve nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë:

Veprimet e arkës në valutë në institucion dokumentohen nëpërmjet mandat-arkëtimeve dhe mandat-pagesave të cilat nënshkruhen nga arkëtari, nga financieri dhe marrësi i paradhënies. Regjistrimet e veprimeve të arkës janë kryer në llogari kontabile të arkës, nga Sektori i financës dhe buxhetit dhe në librin e arkës nga ana e punonjësit të caktuar me përgjegjësinë e lëvizjes së vlerave monetare. Dokumentet e arkës janë shqyrtuar, kontrolluar dhe nënshkruar nga personat e autorizuar: mandatarkëtimet nënshkruhen rregullisht nga personi përgjegjës për vlerat monetare dhe nga Nëpunësi Zbatues; mandatpagesat nënshkruhen nga nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij, nga zyrtari që ka nënshkruar mandatpagesën (marrësi) dhe nga personi përgjegjës për lëvizjen e vlerave monetare. Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të arkës në valutë rezultoi se, institucion respekton përcaktimet e Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar dhe sa më sipër është mbajtur libër arke, ku janë regjistruar rregullisht mandat arkëtimet e pagesat dhe janë bërë mbylljet e tij rregullisht çdo muaj, në zbatim të parashikimeve të paragrafit nr. 67 dhe 68 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, që ka përcaktuar se:

67. Për veprimet e arkës mbahen llogari kontabile të arkës nga sektori i financës dhe libër arke nga punonjësi i caktuar me përgjegjësinë e lëvizjes së vlerave monetare.

68. Dokumentet e arkës shqyrtohen, kontrollohen dhe nënshkruhen nga personat e poshtë shënuar:
a. mandatarkëtimi nënshkruhet nga personi përgjegjës për vlerat monetare, nga punonjësi që kryen derdhjen dhe nga nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij;

b. mandatpagesa nënshkruhet nga nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij, nga marrësi i parave dhe nga personi përgjegjës për lëvizjen e vlerave monetare.

c. Nëpunësi Autorizues ose i deleguari i tij, nënshkruan mandatpagesën kur nuk ka një dokument tjetër urdhëruar të nënshkruar prej tij.

Nga auditimi, rezultoi se:

- Regjistrimet kontabile në ditarin e arkës janë bërë në mënyrë të rregullt, të kuadruara dhe duke u bazuar në dokumentacionin justifikues përkatës.

- Nëpërmjet arkës në valutë janë kryer kryesisht pagesa për shërbime udhëtimi e dieta jashtë vendit. Në të gjitha rastet e audituara, paradhënia ka rezultuar të jetë sistemuar nga Sektori i Financës, menjëherë pas paraqitjes së dokumenteve justifikuese, për shpenzimet e kryera, nga ana e nëpunësit udhëtues, e shoqëruar kjo sipas rastit me “Mandat pagesën” ose “Mandatin e arkëtimin”.

Nga testimet e kryera nuk rezultoi të jetë akorduar paradhënie e dytë, pa shlyer paradhënien e parë. Transaksionet financiare, në formën e paradhënies, për udhëtime e dieta, rezultojnë të kryera në zbatim të VKM nr. 870 datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, si dhe Udhëzimi nr. 22, datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, date 14.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

- Arka është inventarizuar periodikisht çdo muaj duke mos rezultuar me diferenca. Në fund të vitit arka është mbyllur me gjendje zero.

U shqyrtua libri i arkës në valutë, ku u testuan transaksionet e kryera të regjistruara në librin e arkës, dhe konstatohet se për rastet e tërheqjes së valutës është lëshuar autorizimi për tërheqje valute, nënshkruar rregullisht nga Kancelari i Gjykatës së Lartë. Akordimi i paradhënies për shërbim është mbështetur në urdhrin e lëshuar nga Nëpunësi Autorizues. Praktikrat për likuidimet e kryera për shërbimet jashtë vendit janë hartuar nga personat udhëtues së bashku me dokumentacionin vërtetues përkatës, veprime këto të bazuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013, “Mbi zbatimin e Vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pika 5, që përcakton se:

Ne përfundim të shërbimit, punonjësi dorëzon te firmosur pranë zyrës së financës së njësisë, Urdhër-Shërbimin duke i bashkëngjitur atij autorizimin e titullarit të institucionit qendror, ose te deleguarit të tij, dhe te gjithë dokumentet përkatëse që vërtetojnë shpenzimet e kryera për realizimin e shërbimit jashtë vendit.

Ne përputhje me përcaktimet e pikave 8 dhe 9 të vendimit të sipërcituar, punonjësit që dërgohen jashtë vendit dhe kanë kryer shpenzime transporti dhe akomodimi, paguhen nga buxheti vetëm kundrejt dokumenteve përkatëse, sikurse janë biletat e transportit dhe faturat e hotelit. Në kuptim të këtij udhëzimi, në rastet kur udhëtimi kryhet me avion, si bilete transporti njihet edhe boarding pass-i. Në çdo rast, shpenzimet telefonike dhe shpenzimet e transportit urban nuk mbulohen nga buxheti i shtetit.

Nga ana e grupit të auditimit konstatohet se nga strukturat e shërbimit të financës së gjykatës janë kryer rakordimet dhe **kontrollat periodike të arkës në lekë për pullat dhe valutë kryesisht për shërbime jashtë vendi**. U testuan me zgjedhje kontrollat e kryera nga ana e specialistëve të Sektori i financës dhe buxhetit, mbi kontrollin fizik të gjendjes së arkës në valutë, ku nuk kanë rezultuar diferenca.

Sa më sipër, është vepruar në zbatim të parashikimeve të paragrafit nr. 80, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, që ka përcaktuar se:

Përcaktimi i gjendjes së vlerave monetare në arkë dhe letrave me vlerë bëhet nga nëpunësi zbatues me anë të inventarizimit fizik minimalisht një herë në muaj.

b. Auditimi i transaksioneve të kryera me bankën.

Urdhër-shpenzimet e përzgjedhura u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si dokumente autorizues, dokumente vërtetues, dokumente të kontabilitetit, etj, si dhe në përcaktimin e “gjurmëve të auditimit” referuar UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.

Auditimi u ushtrua me zgjedhje konkretisht, u audituan shpenzimet me anë të bankës të kaluara nëpërmjet Degës së Thesarit Tiranë të kryera për llogari të institucionit të Gjykatës së Lartë.

Për vitin 2020, muajt Shkurt, Qershor, Gusht, Shtator, Tetor dhe Dhjetor.

Për vitin 2021, muajt Maj, Korrik, Tetor dhe Dhjetor.

Për vitin 2022, muajt Prill, Gusht dhe Shtator.

Nga auditimi me zgjedhje i *urdhër-shpenzimeve*, u konstatua se:

Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit, si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Veprimet ekonomike që kryhen nga njësia, si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrime ruajtje, pasqyrohen në dokumentet përkatëse menjëherë pasi kryhet veprimi.

Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet mallra/ shërbime, procesverbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve) dhe, në çdo rast është respektuar sistemi i dy nënshkrimeve, të nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë, si dhe kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

Urdhër-shpenzimet janë të kontabilizuara në ditarin e bankës dhe ekstrakti i bankës rakordon me situacionet mujore të rakorduara me degën e thesarit.

Faturat janë paguar në respektim të afateve, duke mos tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pika 184 “*Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik*”, si dhe Ligji nr.48/2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*”, neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit”.

Konstatim: Nga auditimi i Urdhër Shpenzimeve dhe raporteve të Planifikimit dhe monitorimit të buxhetit konstatohet se në cilësinë e Nëpunësit Zbatues nënshkruan përgjegjësi i sektorit të financës. Nëpunësit Zbatues ka marrë një konfirmim të përkohshëm në këtë pozicion nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë me datën 19.06.2020, pas një kërkesë nga GJL, për shkak të daljes në pension të NZ të asaj kohe. Në atë moment nuk ka pasur Drejtor drejtorie në strukturë, e cila është ndryshuar në Dhjetor 2020. Nga intervistat e zhvilluara me NA dhe NZ të GJL, rezulton se nga ana e institucionit po ndërmerren veprimet e nevojshme në funksion të rishikimit të strukturës organike të institucionit, me qëllim harmonizimin e saj me përmasat dhe misionin e institucionit, vendosjen e një hierarkie të përshtatshme dhe të linjave të komunikimit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, duke mbajtur në konsideratë dhe rekomandimet e lënë nga auditimi i brendshëm i KLGJ-së.

c. Saktësia dhe rregullat e veprimeve të kryera nëpërmjet magazinës:

Mbështetur në dokumentacionin e magazinës si fletë hyrjet dhe fletë daljet, kartelat limit, librin e magazinës dhe ditarin analitik të lëvizjes së vlerave materiale, u konstatua se lëvizja e mallrave, materialeve e inventarëve nëpërmes magazinës janë shoqëruar me dokumente justifikuese sipas normave dhe procedurave standarde për ruajtjen, dokumentimin, qarkullimin dhe nxjerrjen jashtë qarkullimit të aktiveve në njësitë publike referuar nenit 6, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar dhe udhëzimin e Ministrisë të Financës nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*”, i ndryshuar. Gjithashtu, daljet nga magazina janë kryer me urdhër dorëzimi, ku pajisjet e mallrat e inventarit u janë dhënë punonjësve me kartela personale.

Hyrja e mallrave në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletë-hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletë-hyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*”, i

ndryshuar, ndërsa fletë daljet ishin të shoqëruara me dokumente mbështetëse si urdhra dorëzimi, procesverbale etj.

Kontabilizimet e fletë-daljeve dhe fletë-hyrjeve, si për aktivet e qëndrueshme dhe për aktivet qarkulluese, janë bërë në mbështetje të planit unik kontabël dhe në mënyrë kronologjike e sistematike në ditarët e magazinës. Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga administratori i vlerave materiale, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste e sektorit të financës. Fletë-hyrja e plotësuar nga magazina për hyrjen e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësi, ka të bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bërë daljen e mallit; shkresën e njësisë për transferimin e aktiveve.

- Për hyrjet e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësite e sektorit publik fletë-hyrja e plotësuar nga magazina kishte të bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bërë dalje mallin; Shkresën e njësisë për transferimin e aktiveve; Autorizimin për tërheqje malli të firmosur nga nëpunësi zbatues dhe Nëpunësi Autorizues.

Veprime këto në zbatim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 55, ku është përcaktuar që:

“Për hyrjet e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësitë e sektorit publik fletë-hyrja e plotësuar nga magazina duhet të ketë bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fletë-daljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bërë dalje mallin; Shkresën e Njësisë për transferimin e aktiveve; Autorizimin për tërheqje malli të firmosur nga nëpunësi zbatues dhe Nëpunësi Autorizues”.

2.4 Auditimi i llogarive vjetore.

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë

1. Formati 1: Pasqyra e pozicionit financiar;
2. Formati 2: Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
3. Formati 3: Pasqyra e flukseve monetare;
4. Formati 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto;
5. Formati 5: Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.
6. Formati 6: Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
7. Formati 7: Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto (si dhe regjistri i aktiveve).
8. Formati 8: Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave

a. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për

menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.

Rezultoni se, veprimet kontabël janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga Gjykata e Lartë, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit.

PF është shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore. Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat e llogaridhënies vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

- për vitin 2020 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën me shkresën nr. 818, datë 11.03.2021 “Mbi depozitimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor 2020”.

- për vitin 2021 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 1385, datë 30.03.2022 “Mbi depozitimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor 2021” duke respektuar afatet ligjore.

Sa sipër ka gjetur zbatim paragrafi 117, i Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, që përcakton se;

“Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë, dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikave të rrethit”.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

b. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Auditimi i llogarive performancës financiare

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konfirmo rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike.

Totali i ardhurave të funksionimit në “Pasqyrën e Përformancës” është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2).

Për vitin 2021 paraqiten si më poshtë vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 164.8 milionë lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 164.8 milionë lekë

iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 0 lekë

Totali ii + iii = 0 lekë

Titulli i Gjetjes:	Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”.
Situata:	Nga auditimi i zërave të shpenzimeve rezultoni se në Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës” nuk është pasqyruar dhe reflektuar ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën prej (1,186,359) lekë, veprime në kundërshtim me

	Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika “Llogaria 63 ”Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 63 ”Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Nga veprimet kontabël të bëra nga institucioni dhe të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare ndryshimi i gjendjes nuk është pasqyruara drejtë, duke mos dhënë efektin e ndryshimit në fondet neto të institucionit dhe rakordimin e pasqyrës së Formatit nr. 1 me Formatin nr. 2, veprim i cili nuk ndikon në rezultat. Vlerë prej 1,186,359 lekë duhet të ishte pasqyruar si rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor në kolonën nr. 132, të Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës”.
Kriteri:	Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika “Llogaria 63”.
Ndikimi/Efekti:	Mospasqyrimi i saktë i llogarisë 63 në pasqyrën e performancës financiare jep një pamje jo të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit, por pa ndikim material në rezultatin e institucionit.
Shkaku:	Mospasqyrimi i drejtë i llogarisë 63 <i>Ndryshimi i gjendjes së inventarit</i> ”.
Rëndësia:	E ulët
Rekomandimi:	Sektori i Financës të marrë masat në vijimësi për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim sa më të drejtë të pasqyrave financiare, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Analiza e posteve kryesore të pasqyrës së “Pozicionit Financiar”.

Nga auditimi dhe verifikimi i llogarive të pasqyrës rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Sipas pasqyrës së pozicionit financiar vjetore rezulton se:

- “Aktivet afatgjata” zënë 85% të vlerës totale të aktivit, ndërsa “Aktivet Afatshkurtra” zënë 15% të totalit.

Aktivet qarkulluese

Aktivet Afatshkurtra përbëhet nga shuma e nën rubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra, të pasqyruara në ***Aneksin 2.1 “Aktivet qarkulluese”***, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”: Sipas UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, Pika 49:

Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitorë të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.

Pasqyrimi në vlerën në vlerën 888,000 lekë përfaqëson gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466).

Pika 50 e udhëzimit. Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordimin me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëlidhet llogarisë vjetore. Në akt rakordim tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grandit që trashëgohet). Në llogaritë vjetore të vitit 2021 ka një akt rakordim me thesarin për “Kreditorët për mjete në ruajtje”, llogari e cila në pozicionin financiar të datës 31.12.2021 reflekton me rritje prej vitit 2020 në vlerën 879,000 lekë.

Klasa 3 “Gjendja e inventarit”, në fund të vitit 2021, rezulton në vlerën 4,957,178 lekë. Në krahasim me vitin 2020 është rritur në vlerën 1,186,359 lekë, ku peshën më të madhe e zë rritja e zërit “Materiale”. Diferenca 1,186,359 lekë, duhet të përputhje me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës”, vlerë e cila nuk është pasqyruar (analizuar sa më sipër).

Pasqyrimi në pozicionin financiar i të drejtave dhe detyrimeve.

*** Llogari të arkëtueshme:**

- Llogaritë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në vlerën 71,491 lekë, përbëhet nga detyrimi i krijuar në maj të vitit 2013 të pagës së marrë nga një punonjës i larguar nga puna. Krijimi i detyrimit ka ardhur si rrjedhojë e urdhrin të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, në të cilën shkëputja e marrëdhënieve financiare ishte përcaktuar me fuqi prapavepruese.

- Llogaritë 409 “Parapagime” në vlerën 20,309 lekë, përbëhet nga detyrimi i krijuar para vitit 2009, si rrjedhojë e një pagesë më tepër ndaj “Shërbimit telegrafik”.

Titulli i Gjetjes:	Llogari të arkëtueshme
Situata:	<p>- Llogaritë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në vlerën 71,491 lekë, përbëhet nga detyrimi i krijuar në maj të vitit 2013 të pagës së marrë nga një punonjës i larguar nga puna. Krijimi i detyrimit ka ardhur si rrjedhojë e urdhrin të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, në të cilën shkëputja e marrëdhënieve financiare ishte përcaktuar me fuqi prapavepruese. Nga ana Institucionit për këtë vlerë nuk është proceduar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e tij, si rrjedhojë ky detyrim është i paarkëtueshëm, pasi ka humbur fuqinë ligjore, bazuar në nenin 203 pika 1 Kodi i Punës “Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet”, si dhe neni 115 Kodit Civil “Parashkruhen brenda afateve prej dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë”.</p> <p>- Llogaritë 409 “Parapagime” në vlerën 20,309 lekë, përbëhet nga detyrimi i krijuar para vitit 2009, si rrjedhojë e një pagesë më tepër ndaj “Shërbimit telegrafik”. Në lidhje me detyrimin bazuar në Kodin Civil, neni 114 “Afatet e parashkrimit” ku citon se “Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë” dhe neni 121 “Për kthimin e shumës së parave ose të sendit që është fituar ose kursyer pa shkak, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për fitimin ose kursimin pa shkak që ka realizuar personi përkatës” ky detyrim është i parashkruar dhe i parkëtueshëm.</p>

Kriteri:	Kodi i Punës, nenin 203 pika 1 “Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet” si dhe Kodit Civil neni 115, 114 dhe 121.
Ndikimi/Efekti:	Detyrime të cilat nuk kanë shpresë arkëtim, pasi ka humbur fuqia ligjore për ti kërkuar.
Shkaku:	Mos marrja e hapave ligjor me kohë për të parandaluar parashkrimin tyre sipas përcaktimeve në Kodin civil dhe Kodin e punës.
Rëndësia:	E ulët
Rekomandimi:	Sektori i Financës të marrë masat për sistemimin e këtyre vlerave, të cilat janë të parashkruara dhe të parkëtueshëm, me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të Institucionit.

* **Situata e Detyrimeve të Prapambetura:**

- Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” përfaqëson detyrimeve të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve, të cilat ndahen natyrës së tyre: “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore”; “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për investime”... etj , ku si kundërparti kanë llogarinë, 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Titulli i Gjetjes:	Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.
Situata:	Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre ne kontabilitet rezultoi se shumica e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer. Si rrjedhojë ky detyrim nuk është njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por është njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42. Urdhër shpenzimin nr. 192 datë 28.07.2021 është bërë ekzekutimi pjesor në shumën prej 213,870 lekë i vendimit gjyqësorë të formës së prerë së Gjykatës së Apelit me nr. 31, datë 04.02.2021. Sektori i financës, pjesën e palikuiduar në shumën prej 1,044,269 të këtij vendimi nuk e ka paraqitur si detyrim të papaguar për vitin 2021, veprim në mospërputhje me Udhëzimin nr. 37, datë 6.10.2020 "Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura." Sa më sipër llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” duhet të ishte reflektuar në shumën prej 1,044,269 lekë në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021, por pa ndikim në rezultatin financiar.
Kriteri:	Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.
Ndikimi/Efekti:	Mos njohja e detyrimeve në momentin e konstatimit të tyre, po në momentin që likuidohen.
Shkaku:	Mospasqyrimi i drejte i llogarive ne pasqyrën e “Pozicionit financiar”.
Rëndësia:	E mesme

Rekomandimi:	Sektori i Financës të marrë masa në vijimësi, që menjëherë pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit të plotë të titullit ekzekutiv, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.
---------------------	---

- Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” paraqitet në vlerën 14,484,220 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka GJL ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2021, përkatësisht për pagat, për tatim taksa, për sigurime shoqërore dhe sigurime shëndetësore, sigrimet suplementare, si dhe vlera e faturave të shpenzimeve të konstatuara në dhjetor, të cilat paguhen në janar 2022. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e pasivit 401,421, 431, 435, 436 dhe 437.

Aktivitet afatgjatë

Në formatin nr. 1 “Aktivitet e Afatgjatë” në vlerën neto prej 114.5 milionë lekë, janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë, “Aktivitet Afatgjatë jo materiale” në vlerën neto 0 lekë dhe “Aktivitet Afatgjatë materiale” në vlerën neto 114.5 milion lekë, të pasqyruara në **Aneksin 2.2** “Aktivitet afatgjatë”, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Llogaria 212 “Ndërtim e konstruksione”, paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto prej 70,625,705 lekë, përbërë nga vlera e godinës së GJL. Gjatë vitit 2021 ka pësuar rritje në vlerën bruto prej 17,580,000 lekë si rezultat i “Rikonstruksionit të dhomës së serverit”.

Titulli i Gjetjes:	Llogaria 212 “Ndërtim e konstruksione”
Situata:	Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatua se: Me Urdhër shpenzimin nr. 406, datë 31.12.2021 është bërë pagesa e kontratës së mbikëqyrjes së punimeve të objektit të “Rikonstruksionit të dhomës së serverit” në shumën prej 372,000 lekë, si dhe është realizuar dhe procedura “Mbikëqyrje punimesh për objektin Rikonstruksioni i dhomës së serverit” në shumën prej 27,000 pa TVSh, të cilat janë planifikuar në llogarinë 6022099 “Shpenzime të tjera”. Sa më sipër këto vlera të raportuar si shpenzime korrente, duhet të ishin planifikuar në zërin e investime kapitale dhe të kontabilizoheshin si rritje e vlerës së aktivitet, referuar Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” pika 1 ku citohet se ..” Mbikëqyrja e punimeve bëhet për çdo projekt dhe ka për qëllim kontrollin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh dhe anën ekonomike të tij” dhe pika 2 “ Vlera e kërkuar nga subjekti konkurrues për mbikëqyrjen, duhet të përfshihet në tarifën e përcaktuara në përputhje me VKM 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë së qeverisjes së përgjithshme” Klasa 2 “Aktivitet Afatgjatë”.
Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar kreu III, neni 7; Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” pika 1 dhe pika 2; Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë së qeverisjes së përgjithshme” Klasa 2 “Aktivitet Afatgjatë” .

Ndikimi/Efekti:	Nënvlerësim i llogarisë 212.
Shkaku:	Planifikimi i gabuar i këtyre shumave në llogarinë 6022099 “Shpenzime të tjera” dhe jo në zërin 231 “Investime”.
Rëndësia:	E ulët
Rekomandimi:	Sektori i Financës të marrë masa për sistemimin kontabël të llogarisë 212 “Ndërtim e konstruksione”, duke e debituar këtë llogari me shumën prej 399,000 lekë.

- Llogaria 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje”, paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto prej 9,262,141 lekë, e cila krahasuar me vitin 2020 ka pësuar ndryshime në vlerën absolute 268,950 lekë dhe në vlerën neto 1,362,653 lekë, si rezultat i blerjeve të realizuara gjatë vitit në shumën prej 933,980 lekë dhe nxjerrjes jashtë përdorimi të shumës 1,202,930 lekë, bazuar në relacionin e komisionit të ngritur me Urdhrin nr. 171, datë 08.09.2020 “Ngritjen e komisionit të vlerësimit dhe të nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve materiale afatgjata”, miratuar nga KLGJ me shkresën nr. 5718/11, datë 11.01.2021, në përgjigje të shkresës së GJL nr. 2698 datë 05.11.2020.

- Llogaria 215 “Mjete Transporti” paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto prej 17,543,083 lekë dhe përfaqëson vlerën automjeteve në dispozicion të GJL, e cila krahasuar me vitin 2020 ka pësuar ndryshime në vlerën absolute 9,902,000 lekë dhe në vlerën neto 12,448,470 lekë, si rezultat i:

- Blerjeve të realizuara gjatë vitit në shumën prej 8,856,000 lekë.

Kalimit kapital pa pagesë:

- Në vlerën prej 4,896,000 lekë të dy automjeteve të reja tip “Ford Fokus” prodhim i vitit 2021, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në Gjykatën e Lartë, bazuar në Urdhrin e KLGJ-së me nr. 503, datë 25.10.2021 prot. me nr. 4898/1, datë 25.10.2021 “Mbi Transferimin e automjeteve të reja dhe atyre në përdorim në sistemin gjyqësor” të dhe Urdhërit të përbashkët me nr. 3756 datë 29.10.2021.

- Në vlerën 3,850,000 lekë të një automjeti nga Gjykata e Lartë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, bazuar në Urdhrin e përbashkët me nr. 3941, datë 10.11.2021 “Për kalim kapitali të automjetit tip “Mercedez Benz”.

Titulli i Gjetjes:	Llogaria 215 “Mjete Transporti”
Situata:	Nga auditimi analitik i llogarisë u konstatua se: Me Urdhrin e NA nr. 91, datë 28.04.2021 është ngritur komisioni “Për vlerësimit dhe nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve materiale afatgjata”. Ky komision është ngritur për vlerësimin e gjendjes së dy automjeteve të tipit Volsvagen. Në procesverbalin e datës 26.05.2021 mbajtur nga komisioni është evidentuar se nga kontrolli fizik i tyre dhe nga kontrolli teknik këto makina nuk janë në gjendje teknike për qarkullim dhe janë jashtë funksionit. Gjithashtu komisioni është shprehur se vlera e riparimit të tyre është shumë më e lartë se sa vlera e këtyre automjeti bazuar në referencat e marra nga drejtoria e doganave dërguar me shkresën nr. 3674/1 datë 05.05.2021. Nga KLGJ është miratuar nxjerrja e tyre jashtë përdorimi me shkresën nr. 3023/1, datë 28.10.2021, në përgjigje të shkresës së GJL nr. 2158 datë 26.06.2021 “Kërkesë për miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimi të makinave”. Nga auditimi u konstatua se, GJL në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021 këto vlera i ka reflektuar si aktive në përdorim (gjendje pune). Veprime jo në përputhje me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin

	<i>e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i> ” Paragrafi 103-109, por pa ndikim në rezultatin financiar pasi vlera neto e tyre është zero. Sa më sipër, nga sektori i financës duhet të ishte bërë veprimi kontabël duke kredituar vlerën bruto prej 8,423,600 lekë në llogarinë 215 “ <i>Mjete transporti</i> ” dhe vlerën bruto prej 319,800 lekë në llogarinë 214 “ <i>Instalime Teknike makineri, pajisje</i> ” (për kasetofonin dhe kondicionerin e makinës) dhe duke debituar përkatësisht llogarinë 219” Amortizim akumuluar” dhe llogarinë 24 “ <i>Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara</i> ” deri në momentin e asgjësimit apo transferimit të tyre në një subjekt tjetër.
Kriteri:	Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “ <i>Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme</i> ”; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “ <i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i> ” Paragrafi 103-109.
Ndikimi/Efekti:	Nga GJL këto vlera janë lënë tek zërat e aktiveve gjendje pune, duke ndikuar në mos pasqyrimin e drejtë të fondit neto të institucionit si dhe vlerën bruto/neto të aktiveve gjendje.
Shkaku:	Mos klasifikimi i aktiveve të dëmtuar të nxjerra jashtë përdorimi në llogarinë 24 “ <i>Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara</i> ”.
Rëndësia:	E ulët
Rekomandimi:	Sektori i Financës të marri masa në vijimësi, që menjëherë me marrjen e miratimit të nxjerrjes së aktiveve jashtë përdorimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësorë të bëjë veprimet kontabël, duke kredituar llogarinë e aktiveve të vlerësuar për jashtë përdorimi dhe debituar përkatësisht llogarinë 219 “ <i>Amortizimi i akumuluar i aktiveve afatgjata</i> ” dhe llogarinë 24 “ <i>Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara</i> ”.

- Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto prej 17,057,686 lekë. Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit në vlerën absolute 2,631,216 lekë dhe në vlerën neto 1,504,852 lekë, si rezultat i:
 - Blerjeve të realizuara gjatë vitit në shumën prej 802,800 lekë.
 - Kalimit kapital pa pagesë:
 - a) Në vlerën prej 1,644,717 lekë të pajisjeve elektronike të dhuruara nga USAID.
 - b) Në vlerën prej 243,995 lekë të pajisjeve elektronike të dhuruara nga EURALIUS.
 - c) Në vlerën 137,378 lekë të pajisjeve elektronike, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në Gjykatën e Lartë, bazuar në Urdhrin e KLGJ-së me nr. 291, datë 06.07.2021 dhe vlerën 156,000 lekë të një pajisje routimi tipi 2 nga KLGJ-ja.
 - Nxjerrjes jashtë përdorimi të shumës 353,674 lekë bazuar në relacionin e komisionit të ngritur me Urdhrin nr. 171, datë 08.09.2020 “*Ngritjen e komisionit të vlerësimit dhe të nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve materiale afatgjata*”, miratuar nga KLGJ me shkresën nr. 5718/11, datë 11.01.2021, në përgjigje të shkresës së GJL nr. 2698 datë 05.11.2020.

Titulli i Gjetjes:	Aktive të vlerësuar dhe miratuara për nxjerrje jashtë përdorimi
Situata:	Nga auditimi analitik i llogarive 214 dhe 218 u konstatua se: Me Urdhrin e NA nr. 171, datë 08.09.2020 është ngritur komisioni “ <i>Për vlerësimit dhe nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve materiale afatgjata</i> ”. Në relacionin e mbajtur nga komisioni është evidentuar lista e aktiveve jashtë përdorimi për llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 353,674 lekë dhe vlera e amortizimit të akumuluar në vlerën 250,062 leke për këtë llogari dhe për llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla

	<p>pune” në vlerën 1,202,930 lekë dhe vlera e amortizimit të akumuluar në vlerën 954,444 lekë. Nga KLGJ është miratuar nxjerrja e tyre jashtë përdorimi me shkresën nr. 5718/11, datë 11.01.2021, në përgjigje të shkresës së GJL nr. 2698 datë 05.11.2020 “<i>Kërkesë për miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimi të Aktiveve afatgjata</i>”. Nga auditimi u konstatua se, GJL në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2020 këto vlera i ka reflektuar si aktive në përdorim (gjendje pune). Vlera e tyre si jashtë përdorimi është reflektuar në pasqyrat e vitit 2021, ku vlera neto e aktiveve është e ndryshme nga ajo që është rehatuar nga komisioni dhe miratua nga KLGJ. Veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “<i>Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme</i>”, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “<i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i>” Paragrafi 103-109. Aktivët kalojnë në llogarinë 24 “<i>Aktive afatgjata të dëmtuara</i>”, pasi ato janë vlerësuar për jashtë përdorimi dhe deri në momentin e asgjësimit apo te tjetërsimit të tyre mbahen nga institucioni duke bërë daljen nga Inventari i institucionit dhe mbajtjen e tyre në magazinë me një flete hyrje rikupero. Për vitin 2020, në formatin nr. 7/a “<i>Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme</i>” (me koston historike) duhet të ishin reflektuar këto aktive si nxjerrje jashtë përdorimi, duke debituar llogarinë 24 “<i>Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara</i>” në vlerën 352,098 lekë. por pa ndikim në rezultatin financiar të vitit 2021.</p>
Kriteri:	<p>Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “<i>Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme</i>”;</p> <p>Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “<i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i>” Paragrafi 103-109.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Nga GJL këto vlera janë lënë tek zërat e aktiveve gjendje pune, duke ndikuar në mos pasqyrimin e drejtë të fondit neto të institucionit si dhe vlerën bruto/neto të aktiveve gjendje.</p>
Shkaku:	<p>Mos klasifikimi i aktiveve të dëmtuar të nxjerrja jashtë përdorimi në llogarinë 24 “<i>Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara</i>”.</p>
Rëndësia:	<p>E mesme</p>
Rekomandimi:	<p>Sektori i Financës të marri masa në vijimësi, që menjëherë me marrjen e miratimit të nxjerrjes së aktiveve jashtë përdorimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësorë të bëjë veprimet kontabël, duke kredituar llogarinë e aktiveve të vlerësuar për jashtë përdorimi dhe debituar përkatësisht llogarinë 219 “<i>Amortizimi i akumuluar i aktiveve afatgjata</i>” dhe llogarinë 24 “<i>Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara</i>”.</p>

Pasivet Afatshkurtra

Nga llogaritë e pasivit për vitin 2021, konstatohet se pasivi përbëhet 100% nga pasive afatshkurtra në vlerën 15,464 mijë lekë, të pasqyruara në **Aneksin 2.3 “Pasivet Afatshkurtra”**, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Llogaria 401-408” Furnitorë e llogari te lidhura me to” në vlerën prej 576,632 lekë përfaqëson vlerën e faturave të shpenzimeve të konstatuara në dhjetor, të cilat paguhen në janar 2022.
- Llogaria 42 “Personeli dhe llogari të lidhur me to“ në vlerën 9,516,162 lekë, përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2021, që paguhen në janar të vitit 2022.

- Llogaria 431 “Personeli dhe llogari të lidhur me to” në vlerën 1,547,105 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2021, të cilat paguhen në Janar të vitit 2022.
- Llogaria 435 & 436 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore“ përfaqëson kontributin e sigurimit shoqëror në shumën prej 1,516,607 lekë dhe e sigurimit shëndetësor në shumën 1,037,762 lekë të muajit Dhjetor 2021, të cilat paguhen në muajin Janar 2022.
- Llogaria 437 “Organizma të tjerë shtetërore” përfaqëson kontributin e sigurimit suplementare prej 289,952 lekë të muajit Dhjetor 2021, të cilat paguhen në muajin Janar 2022.
- Llogaria 4341 “Te tjera operacione me shtetin (kreditor)” në shumën prej 91,800 lekë përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa-arkëtuara nga vitet e mëparshme. Kjo llogari përbëhet nga saldo debitorë të llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” për vlerën 71,491 lekë dhe të llogarisë 409 “Parapagime” në vlerën 20,309 lekë.
- Llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” në shumën prej 888,000 lekë përfaqëson 5% e garancisë së mbajtur të “Rikonstruksionit të dhomës së serverit”.

Konkluzion:

Për vitet objekt auditimi, hyrjet e aktiveve që kanë qarkulluar pa pagesë në GJL, si dhe çdo lëvizje e aktiveve kishte të bashkëlidhur fletë-hyrjen, fletë-daljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bërë daljen e mallit, shkresën e Njësisë për transferimin e aktiveve; Autorizimin për tërheqje malli të firmosur nga nëpunësi zbatues dhe Nëpunësi Autorizues, proces-verbali i marrjes në dorëzim të mallit, si dhe Ak-konfirmimet e marrjes së mallrave.

Nga auditimi i dokumenteve të aktiveve bërë hyrje në GJL nga dhurimet rezulton se kontabilizimi i tyre është mbështetur në dokumentacioni shoqërues si: Marrëveshje/akti i dhurimit ose letrën zyrtare të njësisë donatore; Faturën që identifikon mallrat dhe vlerën e tyre; Dokumentet zhdoganimit dhe Certifikatën e origjinës; Procesverbali i marrjes në dorëzim të konfirmuar nga sektori i shërbimeve. Veprime në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 55 dhe 57.

Fondi i konsoliduar

Nga auditimi i “Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto” dhe rakordimi me pasqyrimin e vlerave në pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën D rezultoi se kemi pasqyrim të drejtë të vlerave në pasqyrë, të pasqyruara në **Aneksin 2.4 “Fondi i konsoliduar”**, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

c) Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Nga auditimi u konstatua se Gjykata e Lartë ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...” dhe neni 31, citohet “...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës...”.

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2020-2021. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se, për periudhën objekt auditimi, çdo vit janë realizuar proceset e inventarizimit parashikuar në Paragrafi nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar që sanksionin se:

“Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”.

Regjistrimi i aktiveve është kryer konform Kreut III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitet e Sektorit Publik".

Hyrja e aktiveve për çdo rast është dokumentuar me fletë hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konform pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitet e Sektorit Publik". Dalja e aktiveve për çdo rast është realizuar konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitet e Sektorit Publik".

Më konkretisht:

a) Inventarizimi fizik

Procesi i inventarizimit të aktiveve, për vitin 2020 dhe 2021 është kryer nga komisioni i ngritur sipas urdhrimit të Kancelarit të GJL në rolin e NA "Për krijimin e komisionit të inventarizimit fizik të aktiveve" përkatësisht me nr. 8, datë 18.01.2021 dhe nr. 4931, datë 29.12.2021, e përbërë nga tre anëtarë sipas përcaktimit të pikës 82 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011.

Para fillimit të inventarit nga komisioni i inventarizimit është mbajtur procesverbal, ku është fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, sipas përcaktimit të paragrafit 82 të UMFE nr. 30/2011, i ndryshuar.

Komisioni është bazuar në të dhënat e regjistrimit kontabël për kryerjen e inventarizimit të pasurisë. Për sa më sipër është vepruar në bazë të përcaktimeve të paragrafit nr. 26, të Udhëzimit të MFE me nr. 30/2011.

Në dosje janë depozituar kartelat/ fletët e inventarit të çdo punonjësi, të nënshkruara rregullisht nga komisioni i inventarizimit dhe persona materialisht përgjegjës.

Nga komisioni i inventarizimit në fund të procesit ka përgatitur raportin mbi inventarizimin për gjendjen e aktiveve në përdorimi, si dhe për vlerat materiale, (për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike), ku së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit është dorëzuar tek nëpunësi autorizues për veprime të mëtejshme, veprime në përputhje me paragrafin 85/c të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar. Në relacion komisioni është shprehur se nuk ka diferenca midis gjendjes kontabël dhe asaj fizike.

b) Vlerësimi i aktiveve

Me Urdhër të Kancelarit të Gjykatës, çdo vit mbas procesit të inventarizimit ka ngritur pas realizimit të procesit të inventarizimit ka ngritur "Komisionin për vlerësimin fizik të aktiveve".

- Me Urdhër të NA nr. 171, datë 08.09.2020 është ngritur komisioni "Për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve materiale afatgjata", për aktivet e identifikuar në relacionin e inventarizimit të vitit 2019 . Në relacionin e mbajtur nga komisioni me datën 29.10.2020 është evidentuar lista e aktiveve jashtë përdorimi për llogarinë 218 "Inventar ekonomik" në vlerën 353,674 lekë dhe vlera e amortizimit të akumuluar në vlerën 250,062 leke për këtë llogari dhe për llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" në vlerën 1,202,930 lekë dhe vlera e amortizimit të akumuluar në vlerën 954,444 lekë. Në relacionin e vlerësimit është relatuar procedura e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës, veprime në përputhje me paragrafin 106 të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

Nga KLGJ është miratuar nxjerrja e tyre jashtë përdorimi me shkresën nr. 5718/11, datë 11.01.2021, në përgjigje të shkresës së GJL nr. 2698 datë 05.11.2020 "Kërkesë për miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimi të Aktiveve afatgjata".

Komisioni i vlerësimit për aktivet e institucionit në fund të procesit të vlerësimit, ka mbajtur procesverbale në vete për secilin aktiv të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorimi, ku janë përcaktuar shkaqet e daljes jashtë përdorimi të këtyre aktiveve, vlera e mbetur e tyre pas amortizimit të akumuluar, si dhe kriterin mbi bazën e të cilit është bërë vlerësimi i aktiveve, veprime në përputhje me paragrafin 102-105 të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

- Me Urdhrin e NA nr. 91, datë 28.04.2021 është ngritur komisioni “Për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve materiale afatgjata”. Ky komision është ngritur për vlerësimin e gjendjes së dy automjeteve të tipit Volsvagen. Në procesverbalin e datës 26.05.2021 mbajtur nga komisioni është evidentuar se nga kontrolli fizik i tyre dhe nga kontrolli teknik këto makina nuk janë në gjendje teknike për qarkullim dhe janë jashtë funksionit. Gjithashtu komisioni është shprehur se vlera e riparimit të tyre është shumë më e lartë se sa vlera e këtyre automjeti bazuar në referencat e marra nga drejtoria e doganave dërguar me shkresën nr. 3674/1 datë 05.05.2021. Nga KLGJ është miratuar nxjerrja e tyre jashtë përdorimi me shkresën nr. 3023/1, datë 28.10.2021, në përgjigje të shkresës së GJL nr. 2158 datë 26.06.2021 “Kërkesë për miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimi të makinave”.

c) *Nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve*

Me Urdhrin e NA nr. 100, datë 19.04.2021 është ngritur komisioni “Për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve materiale afatgjata” e përbërë nga 5 anëtarë, e cila ka përbërje tjetër nga komisioni i vlerësimit të aktiveve, sipas përcaktimit të parashikuar paragrafit 97, të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

Nxjerrja jashtë përdorimi të aktiveve 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 353,674 lekë dhe aktiveve 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 1,202,930 lekë është bërë sipas përcaktimit të parashikuar në paragrafin 109, Kreu IV të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

- Aktivet si karrige, poltrone, tapet me vlerë 326,173 lekë janë asgjësuar me depozitimin e tyre pranë vend depozitimit të mbetjeve të Sharrës Tiranë. Procesi i asgjësimit është dokumentuar në proces verbalit nr. I datë 13.4.2021 të komisionit të shoqëruar me pamje fotografike dhe dokumentacionin e depozitimit.

- Aktivet si kondicionerë, rafte metalike me vlerë 1,230,430 lekë janë propozuar shitja e tyre me ankand si skrap. Nga auditimi i procedurave të ankandit të llojit “Procedurë e hapur” me vlerë 3,633 lekë, rezultoi se janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin Publik” dhe VKM-së nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik” nga përllogaritja e vlerës, ngritjen e komisioneve, zhvillimi i procedurës, kontrata e shitjes deri në arkivim. Nga shitja e aktiveve subjektit fitues “C.M.” shpk, janë përfituar të ardhura në shumën 3,633 lekë, të cilat janë kaluar për llogari buxhetit të shtetit.

- Për dy automjetet sipas miratimit për nxjerrjen nga përdorimi i është kërkuar me shkresën nr. 3942, datë 10.11.2021 Drejtorisë Rajonale të Rezervave të Shtetit, Tiranë transferimi pranë kësaj drejtorie. Transferimi i tyre është realizuar me datën 09.05.2022 shoqëruar me procesverbalin “Mbi marrjen në dorëzim të mjeteve jashtë përdorimi” mbajtur midis përfaqësuesve të GJL (bazuar në urdhrin nr. 120, datë 28.04.2022) dhe përfaqësuesit nga DRRMSH.

Transferimi i tyre është realizuar sipas përcaktimeve të parashikuara në Ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për Rezervat e Shtetit”, VKM-në nr 1128, datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, Udhëzimin e KM nr. 1, datë 18.02.2013 “Për mënyrën e marrjes në dorëzim të mallrave nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit”

2.5 Prokurimet e fondeve publike

Grupi i auditimit, për të realizuar qëllimin dhe objektin e auditimit të përputhshmërisë në lidhje me prokurimet e fondeve publike, u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore të:

- Ligjit nr. 9646 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;
- Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- VKM-së nr. 918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”;
- VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, si dhe çdo akti juridike që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit.

Auditimi i procedurave të prokurimit të kryera nga Gjykata e Lartë, në cilësinë e AK u ushtrua bazuar në aktet ligjore/ nënligjore të prokurimit publik, si dhe në aktet ligjore/ nënligjore që kanë lidhje me objektet e prokurimit.

Në zbatim të kësaj pike, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin, si më poshtë:

- Vlerësimin e hartimit të nevojave për mallra, punë dhe shërbime nga subjekti i audituar;
- Argumentimin dhe përllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, sipas nevojave konkrete për mallra dhe shërbime;
- Realizimin e procedurave të prokurimit, që nga momenti i nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, deri në lidhjen e kontratës;
- Lidhjen dhe zbatimin e kontratave, deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.

1. Regjistri i parashikimeve

- Autoriteti Kontraktor ka krijuar në SPE regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar, në Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021 “Për hartimin e parashikimit të regjistrin të parashikimit të procedurave të prokurimit dhe regjistrin të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit publik”, por nuk janë dërguar në organin qendror blerës, sipas afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij udhëzimi, dhe nenit 3 “Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
- Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP <https://www.app.gov.al>.

2. Regjistri i realizimeve

Në lidhje me regjistrin e realizimit u konstatua se është paraqitur me formën dhe mënyrën që është parashikuar, kreut II të Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021 dhe nenit 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Nga AK nuk janë dorëzuar në organet qendrore brenda afatit, që vënë në dispozicion fondet, një informacion të hollësishëm për procedurat e prokurimit të realizuara çdo katër muaj, por jo më vonë se datat 10 maj, 10 shtator dhe 10 janar të çdo viti, sipas përcaktimeve ligjore në pikën 2, të neni 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 dhe në pikën 3, kreut II të Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021.

- Nga AK nuk janë pasqyruar në regjistrin e realizimit të gjitha kategoritë e mallrave e shërbimeve vlera e të cilave nuk e kalon shumën 100,000 lekë, pavarësisht se këto procedura nuk i nënshtrohen rregullave të prokurimit publik, veprime në mospërputhje me pikën 2, kreut II të Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021. Për periudhën 2020-2021, nga analiza e shpenzimeve në ditarin e bankës, grupi i auditimit konstaton se këto vlera të realizuar, ishin të pa pasqyruara në regjistrin e prokurimeve,

Për vitin 2022, në regjistrin e realizimit kategoritë e mallrave e shërbimeve vlera e të cilave nuk e kalon shumë 100,000 lekë ishin të pasqyruara.

3. Auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të lartë.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Gjykata e Lartë:

1. Për vitin 2020 janë kryer 5 procedura prokurimi, “Kërkesë për Propozim”, me vlerë ekonomike 8,714,462 lekë pa TVSH.

2. Për vitin 2021 janë kryer 5 procedura prokurimi, me vlerë totale 28,556,452 lekë pa TVSH.

Ndër të cilat:

- Procedurë Prokurimi “Kërkesë për Propozim”, në total 2 procedura, me vlerë ekonomike 2,906,235 lekë pa TVSH.

- Procedurë Prokurimi “E Hapur”, në total 1 procedurë, me vlerë ekonomike 14,650,000 lekë pa TVSH.

- Procedurë Prokurimi “E Hapur e thjeshtuar”, në total 2 procedurë, me vlerë ekonomike 10,994,216 lekë pa TVSH.

3. Për vitin 2022 janë kryer 6 procedura prokurimi, me vlerë totale 73,350,170 lekë pa TVSH.

Ndër të cilat:

- Procedurë Prokurimi “E Hapur”, në total 5 procedurë, me vlerë ekonomike 67,119,070 lekë pa TVSH, nga të cilat 2 marrëveshje kuadër me afat 48 muaj në vlerën 45,897,550 lekë pa TVSH.

- Procedurë Prokurimi “E Hapur e thjeshtuar”, 1 procedurë, me vlerë ekonomike 6,231,100 lekë pa TVSH, e cilat është marrëveshje kuadër me afat 48 muaj.

Nga këto procedura prokurimi, grupi i auditimit përzgjedhi për auditim 6 kontrata me vlerë totale 40,943 mijë lekë, ose 37% të fondit të përgjithshëm të prokuruar.

Viti	Vlera e kontratës së nënshkruar	Numëri i prokurimeve	Dosje të audituara/Vlera pa TVSH	Dosje të audituara në numër	Mbulimi në vlerë me auditim %
2020	8,714,462	5	3668287	2	42%
2021	28,556,452	5	7,380,000	2	26%
30.09.2022	73,350,170	6	29,895,127	2	41%
Totali	110,621,084	16	40,943,414	6	37%

Burimi: Gjykata e Lartë, përpunuar nga grupi i auditimit

-Për të gjitha procedurat e zhvilluara nga AK, dokumentet e tenderit janë dërguar për publikim dhe ngarkuar në SPE të APP, në përputhje me VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 78, pika 4.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e prokurimit të përzgjedhura nga grupi i auditimit për vitet 2020-30.09.2022 u konstatuan:

Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- Me urdhrin e Nëpunësit Autorizues (Kancelarit të Gjykatës së Lartë) për çdo procedurë është ngritur grupi i përllogaritjes së fondit limit dhe i përcaktimit të specifikimeve teknike, mbështetur në kërkesat për mallra/shërbime të përgatitura nga drejtoritë përkatëse, si dhe bazuar në fondin e planifikuar në PBA-të për këto mallra/shërbime.

- Më pas nga ana e NA të Gjykatës së Lartë ka dalë urdhri i prokurimit për realizimin e procedurës së prokurimit me fondin e përllogaritur nga grupi përllogaritjes së fondit limit, si dhe janë ngritur komisionet e njësisë së prokurimit dhe të vlerësimit të ofertave.

Sa më sipër veprime janë në përputhje me nenin 21 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar kreu IX “Rolet dhe përgjegjësitë në autoritetin/entin kontraktor”.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se, specifikimet teknike të vendosura nga grupi i hartimit kritereve kualifikuese për mallrat/shërbimet që do të prokurohen janë të argumentuara, në përputhje me nenin 36 të LLP dhe nenin 78, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, “*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit*”.
- Në lidhje me vlerësimin e ofertave rezultoi se, KVO bazuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta kualifikuese ka shpallur fitues OE ose BOE, të cilët plotësonin të gjitha kërkesat teknike, ligjore dhe ekonomike të përcaktuar në DST. Më pas nga KVO është përpiluar raporti përmbledhës, i cili është miratuar nga titullari i AK.
- Mbas lidhjes së kontratave midis OE dhe AK, Nëpunësit Autorizues (Kancelari i GJL) për çdo kontratë, sipas natyrës së mallrave, punëve apo shërbimeve ka ngritur “*Grupin e punës për ndjekjen e kontratës*” veprime në përputhje me pika 42-50 “*Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara*” të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.
- Nga grupi i punës mbas vlerësimit të produkteve të sjella nga OE ose shërbimit të realizuar prej tyre është mbajtur raporti përmbledhës për realizimin e kontratës, duke u shprehur në lidhje me përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike të përcaktuara në kontratë.

4. Auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, të kryera nga Gjykata e Lartë rezultoi se:

- Është përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbime, kur vlera e përlllogaritur e fondit limit ka qenë ndërmjet kufijve nga 100,000 (njëqind mijë) lekë deri në 1,000,000 (një milion) lekë në vit, sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 41, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”.
 - AK në fillim të çdo vitit kalendarik ka ngritur “*Komisionin e prokurimeve me vlerë të vogël*” të përbërë prej 3 (tre) anëtarësh.
 - Përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit nga AK është bërë përlllogaritja e fondit limit të procedurës blerje e vogël nga “*Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit*”, i cili është mbështetur në kërkesat për nevoja mallra/shërbime etj.
- Nga auditimi i disa procedurave u konstatua se në procesverbalin e mbajtur nga komisioni i blerjeve të vogla sa i takon përlllogaritjes së fondit limit, problematika kryesore e evidentuar është mungesa e dokumentimit të kësaj përlllogaritje. Edhe pse në rastin e përlllogaritjes së fondit në bazë të testimit të tregut, autoritetet kontraktore nuk kanë detyrimin të administrojnë ofertat e marra siç përcaktohet në pikën 7, të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021, por ata duhet që, nëpërmjet procesverbali, të pasqyrojnë treguesit e çmimeve të përdorura në këtë përlllogaritje. Në çdo rast, në mbështetje të nenit 34, të LPP dhe nenit 76 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, AK duhet të argumentojë dhe të dokumentojë mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit dhe çmimet që kanë marrë në konsideratë, në këtë përlllogaritje.
- Urdhri i prokurimit është shoqëruar me ftesën për ofertë, që iu është drejtuar operatorëve ekonomikë, në të cilën janë përcaktuar të gjitha të dhënat e nevojshme që lidhen me objektin e prokurimit dhe janë publikuar në sistemin e prokurimit elektronik, veprime në përputhje me pikën 4 të nenit nr. 56, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021 “*Mbi përdorimin e procedurës*

me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

- Nga auditimi i disa procedurave u konstatua se komisioni i blerjeve të vogla nuk ka dokumentuar procesverbalet e kalimit nga një OE në një OE të renditur të dytin e kështu me radhë në momentin kur një OE tërhiqen nga procedura.

- Për të gjithë procedurat e blerjeve të vogla të auditura u konstatua mungesa e inventarizimit, e për pasojë e arkivimit, veprime jo në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe nenit 21 “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” dhe me pikën 3 të nenit 16 të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe manualit të MFK miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, ku mungesa e gjurmëve të auditimit nuk i jep mundësinë audituesit të përcaktojë radhën e ngjarjeve, që ndodhin brenda çdo procesi (çdo procedure prokurimi).

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e dërguar me nr. 554/4 datë 15.12.2022, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 181 prot., datë 13.01.2023, protokolluar në KLSH me nr. 554/5 prot., datë 19.01.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me Rekomandimin 6. 1 (propozimi për të paraqitur në Këshillin e Gjykatës së Lartë për të shtuar në organike pozicionin e një specialisti prokurimi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Financiare dhe Shërbimeve), Këshilli i Gjykatës së Lartë mori në shqyrtim propozimin e mësipërm, dhe mbasi diskutimeve, konkludoi se nuk është e nevojshme të bëhet një shtesë në organiken e Gjykatës së Lartë një specialisti prokurimi, për shkak se disa procedura prokurimi, të cilat zhvilloheshin me pare nga Gjykata e Lartë, tashme do të zhvillohen në mënyrë të përqendruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, dhe në këto kushte, Gjykata e Lartë ka burime njerëzore të mjaftueshme për të ndjekur dhe përfunduar procedurat e tjera të prokurimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Observimi juaj merret në konsideratë duke e reflektuar në Raportin Përfundimtar të auditimit.

Titulli i Gjetjes:	Mangësitë e konstatuara tek prokurimet publike
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none">- Në lidhje me <i>regjistrin e parashikimit</i>, nga AK nuk janë dërguar në organin qendror blerës, sipas afatit të përcaktuar në pikën 3, të Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021 “Për hartimin e parashikimit të regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit publik”, dhe nenit 3 “Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.- Në lidhje me <i>regjistrin e realizimit</i>, nga AK:<ul style="list-style-type: none">• nuk janë dorëzuar në organet qendrore brenda afatit, që vënë në dispozicion fondet, një informacion të hollësishëm për procedurat e prokurimit të realizuara çdo katër muaj, por jo më vonë se datat 10 maj, 10 shtator dhe 10 janar të çdo viti, sipas përcaktimeve ligjore në pikën 2, të neni 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 dhe në pikën 3, kreut II të Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021.• nuk janë pasqyruar në regjistrin e realizimit të gjitha kategoritë e mallrave e shërbimeve vlera e të cilave nuk e kalon shumën 100,000 lekë, pavarësisht se këto procedura nuk i nënshtrohen rregullave të prokurimit publik, veprime në mospërputhje me pikën 2, kreut II të Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021. Për periudhën 2020-2021, nga analiza e shpenzimeve në ditarin e bankës, grupi i auditimit konstaton se këto vlera të realizuar, ishin të pa pasqyruara në regjistrin e prokurimeve, Për periudhën deri me datën 30.09.2022, në regjistrin e realizimit kategoritë e mallrave e shërbimeve vlera e të cilave nuk e kalon shumën 100,000 lekë ishin të pasqyruara.

	<p>Në lidhje me procedurat e <i>prokurimit me vlerë të vogël</i> u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komisioni i blerjeve të vogla në disa procedurave nuk ka dokumentuar procesverbalet e kalimit nga një OE në një OE të renditur të dytin e kështu me radhë në momentin kur një OE tërhiqen nga procedura, veprime jo në përputhje me nenit 56, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “<i>Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</i>”, i ndryshuar, pika 6 ku citohet se “<i>Kur ofertuesi i renditur në vend të parë tërhiqet nga oferta e tij ose nuk plotëson kërkesat e autoritetit/entit kontraktor, ky i fundit përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me radhë, deri në ofertuesin e renditur në vend të dhjetë. Këto veprime duhet të dokumentohen nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël</i>”. - Për të gjithë procedurat e blerjeve të vogla të audituara nuk ishin të inventarizuara e për pasojë të arkivuara në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “<i>Për arkivat</i>”, si dhe nenit 21 “<i>Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë</i>” dhe me pikën 3 të nenit 16 të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “<i>Për menaxhimin financiar dhe kontrollin</i>” i ndryshuar, dhe manualit të MFK miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, ku mungesa e gjurmëve të auditimit, e cila informon mbi: <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimin e qartë të ecurisë së operacionit; • Gjurmimin e operacionit prej fillimit në fund; • Të gjithë dokumentet që janë marrë ose janë gjeneruar gjatë procesit; etj nuk i jep mundësinë audituesit të përcaktojë radhën e ngjarjeve, që ndodhin brenda çdo procesi (çdo procedure prokurimi).
Kriteri:	<p>Udhëzimi nr. 4, datë 18.06.2021 “<i>Për hartimin e parashikimit të regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit publik</i>”, pika 3;</p> <p>VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “<i>Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</i>”, i ndryshuar neni 3 dhe neni 4;</p> <p>- Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “<i>Për arkivat</i>”, si dhe nenit 21 “<i>Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë</i>”;</p> <p>Ligji nr. 10 296, datë 8.7.2010 “<i>Për menaxhimin financiar dhe kontrollin</i>” i ndryshuar, neni 16 pika 3.</p>
Ndikimi/Efekti:	Mungesë gjurmë auditimi, për të verifikuar zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore.
Shkaku:	Mungesa e një pozicioni/specialisti në strukturë GJL, që të merret me prokurimet publike, që nga faza e planifikimit e deri tek zbatimi/përfundimi i kontratës.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	- Gjykata e lartë të marrë masat në vijimësi, që në çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël, të realizojë inventarizimin e dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, duke bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik fitues, sipas kriterëve të përcaktuara në ftesën për ofertë, me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit.

2.6 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në zbatim të këtij drejtimi të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 76/2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Vendim nr. 643, datë 23.12.2020, “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të kategorive të punonjësve të gjykatës së lartë”;
- Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin;
- Aktet nënligjore (Vendime/ Urdhra) të dala në funksion të MFK, trajtuar në material.

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Gjykatën e Lartë (në vijim GJL) u realizua bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Manualin për MFK-në, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij.

Në kuptimin e ligjit të sipërcituar, menaxhimi financiar dhe kontrolli përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin, keqpërdorimin dhe vjedhjen e pasurisë.

Referuar Manualit të MFK, në nenin 19, kreu III “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit” citohet se:

“Titullarët e njësive të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.”

1. MJEDISI I KONTROLLIT

Grupi i parë i komponentëve të kontrollit të brendshëm përshkruan kushtet bazë të nevojshme për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm kontrolli (brendshëm) në një njësi të caktuar. Mjedisi i kontrollit i jep tonin njësisë, duke influencuar vetëdijen kontrolluese të njerëzve të saj. Ai përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë duke siguruar disiplinën dhe strukturën. Mjedisi i kontrollit përbëhet nga dy aspekte: strukturat formale dhe aspektet e sjelljes individuale; dhe të dy duhet të ndërveprojnë. Menaxhimi ka rolin kyç në miratimin dhe mbështetjen e mjedisit të kontrollit. Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë; filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës; mënyrën sesi menaxhimi cakton përgjegjësi dhe të drejta dhe organizon dhe zhvillon stafin, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep bordi i menaxherëve.

GJL është gjykatë me e lartë e pushtetit gjyqësorë në Republikën e Shqipërisë. Organizimi dhe funksionimi i saj mbështet në ligjin 98/2016 “Për organizimin pushtetit gjyqësorë në Republikën e Shqipërisë”.

• **Struktura organizative**

Për periudhën objekt auditimi gjykata ka funksionuar bazuar në strukturën organizative të miratuar nga Kryetari i Gjykatës së Lartë me Urdhrin nr. 265, date 20.11.2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të vendeve të punës të personelit të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 643, datë 23.12.2020 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të kategorive të

punonjësve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Gjykatës së Lartë me Vendimin nr. 1, date 21.01.2021, dhe *"Për miratimin e strukturës, Organikës, përshkrimin e punës dhe klasifikimit të vendeve të punës të punonjësve të Gjykatës së Lartë"*, ka miratuar strukturën organike me 131 punonjës.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 84, datë 11.03.2021, ka miratuar shtesë në organike me 6 (gjashtë) punonjës përkatësisht, ku numri i punonjësve në organike është rritur në 137 punonjës. Për vitin 2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 72, datë 23.02.2022 *"Për detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2022"*, ka miratuar shtesë në organike me tetë punonjës, ku numri i punonjësve në organike është rritur në 145 punonjës.

- **Integriteti dhe vlerat etike**

Për të garantuar ruajtjen e integritetit dhe vlerave etike, GJL operon bazuar në përcaktimet ligjore të nëpunësit civil në ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 *"Për rregullat e etikës së administratës publike"* dhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 *"Për parandalimin e konfliktit të interesit"*, si dhe Kodin e Etikës, miratuar me Urdhrin nr. 171, datë 22.04.2021 *"Për miratimin e Kodit të Etikës së Gjyqësorit"*.

- **Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore**

Procedurat e rekrutimit janë të përcaktuara në Ligjin nr. 98/2016 *"Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"*, Vendimin e KLGJ nr. 622, datë 10.12.2020 *"Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor"*, si dhe në Udhëzimin e KLGJ nr. 85, datë 11.03.2021 *"Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor"*, për nëpunësit civil gjyqësor dhe pjesën tjetër të stafit.

- **Profesionalizimi i stafit**

Gjatë periudhës objekt auditimi ka pasur trajnime të vazhdueshme për stafin e nëpunësve civil gjyqësorë të GJL nga KLGJ.

- **Vlerësimi periodik i punonjësve**

Neni 65 *"Vlerësimi i veprimtarisë"* i Ligjit nr. 98/2016 *"Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"* përcakton se veprimtaria e çdo nëpunësi civil vlerësohet periodikisht të paktën çdo dy vjet, nga data e fillimit të ushtrimit të detyrës në vendin përkatës. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton me vendim rregulla të mëtejshme për treguesit e kritereve që lidhen me kriteret e vlerësimit, burimet dhe procedurën e vlerësimit.

Referuar Vendimit të KLGJ nr. 622, datë 10.12.2020 *"Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor"*, si dhe Udhëzimit të KLGJ nr. 85, datë 11.03.2021 *"Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor"*, sa i përket procedurës së lëvizjes paralele të punonjësve në shërbimin civil gjyqësor, formulari i vlerësimit periodik është një nga dokumentet e kërkuara. Në mënyrë që vlerësimi mos të bëhet pengesë për vijimin e këtyre procedurave, strukturat drejtuese të GJL kanë hartuar një formular vlerësimi, duke u mbështetur në formularin e vlerësimit profesional të nëpunësve civil, mbi të cilin është bërë dhe vlerësimi periodik i nëpunësve civil gjyqësorë.

Deri në përfundim të periudhës së auditimit, nuk rezulton që KLGJ të ketë hartuar një vendim ku të përcaktohen rregullat për treguesit e kritereve që lidhen me kriteret e vlerësimit, burimet dhe procedurën e vlerësimit të unifikuar për të gjithë strukturat gjyqësore.

2. MENAXHIMI I RISKUT

- **Vendosja e objektivave**

Objektivat specifike të GJL janë hartuar në Planin e Punës për zbatimin e buxhetit dhe përmirësimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, ku janë përcaktuar edhe indikatorët e rezultateve, njësia publike/ grupi i punës përgjegjës, afatet përkatëse dhe llojet e aktiviteteve. Struktura drejtuese e GJL ka miratuar regjistrin e riskut, ku janë përshkruar risqet, janë përcaktuar kontrollet ekzistuese dhe veprimet për të adresuar boshllëqet.

3. VEPRIMTARITË E KONTROLLIT

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve.

- **Ndarja e detyrave**

Për të minimizuar rrezikun e gabimeve, parregullsive dhe shkeljeve si dhe mos zbulimin e tyre, titullarët duhet të vendosin rregulla që e shpërndajnë tek punonjës të ndryshëm përgjegjës në zbatimin të dy, ose më shumë fazave kyçe të një operacioni, procesi, apo aktiviteti.

Ndarja e detyrave në GJK rregullohet me anë të Rregullorja e Brendshme e Gjykatës së Lartë miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 643, datë 23.12.2020 *“Për miratimin e rregullave standarde për organizimën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë”*.

Sa i përket përshkrimit të punëve për punonjës të administratës gjyqësore, jo të gjithë pozicionet aktuale në strukturë e kanë të reflektuar përshkrimin e punës në rregulloren e sipërcituar. Neni 41 *“Organizimi i administratës gjyqësore”* i Ligjit nr. 98/2016 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”* përcakton se veprimtaritë që duhet të kryhen rregullisht për secilin nga këto shërbime (referuar shërbimeve gjyqësore, administrative dhe mbështetëse) përcaktohen në përshkrimin standard të punës, të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Deri në përfundim të periudhës së auditimit, rezultoi se strukturat drejtuese të GJL kanë hartuar përshkrimet e punës duke përgatitur “proceset e punë” sipas përcaktimeve ligjore të manualit të MKF-së, por ende nuk janë reflektuar ndryshimet në rregullore, e cila është ende në proces duke u hartuar nga KLGJ, si një akt që standardizon përshkrimet e punës të punonjësve të administratës gjyqësore.

4. INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI

Komunikimi luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe kontrollin e aktiviteteve të njësisë. Punonjësit e GJL janë pjesë e rrjetit të komunikimit dhe komunikojnë nëpërmjet tij (@gjykataelarte.gov.al).

5. MONITORIMI

Komponenti i pestë i kontrollit të brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficientë me kalimin e kohës.

- **Procedura e vetëvlerësimit**

Nëpërmjet vetëvlerësimit, një përdorues i buxhetit ka nevojë për të përcaktuar nëse ka apo jo një sistem të përshtatshëm të MFK-së, me rregullat dhe procedurat që sigurojnë se operacionet janë duke u kryer rregullisht, në mënyrë etike, ekonomike, efikase dhe efektive.

Për vitet periudhë auditimit, GJL ka dërguar drejtuar KLGJ pyetësorët e vetëvlerësimit, si më

poshtë:

- Për vitin 2020, dërgohet pyetëtori i vetëvlerësimit me anë të shkresës nr. 404 prot., datë 05.02.2021;
- Për vitin 2021, dërgohet pyetëtori i vetëvlerësimit me anë të shkresës nr. 537 prot., datë 10.02.2022.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

I. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagave të gjyqtarëve u konstatua se, pavarësisht se kanë të njëjtin status kushtetues, kryejnë të njëjtën detyrë, me të njëjtën përgjegjësi dhe i nënshtrohen të njëjtave rregulla procedurale, materiale apo disiplinore, pagat e tyre janë të ndryshme. Në GJL janë të emëruar tre grupe gjyqtarësh, nga radhët e juristëve të spikatur, nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatave të Posaçme (shkalla e parë dhe apeli), si dhe nga radhët e gjykatave të apelit të juridiksionit të zakonshëm.

- Gjyqtarët që kanë ardhur nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar përfitojnë, respektivisht, pagën e grupit G3, së bashku me shtesën për vjetërsi, si dhe një shtesë për vështirësi pune, sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në masën 80 për qind të pagës bruto fillestare.

Ky detyrim që buron nga standardet e gjithëpranuara ndërkombëtarisht dhe që mishërohet edhe në nenin 138 të Kushtetutës, por jo në ligjin 96/2016 "Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" është arsyeja që gjyqtarët e zgjedhur në GJL nga gjykatat e posaçme të përfitojnë pagën përkatëse, së bashku dhe me përfitimet e tjera financiare në të njëjtën masë që i përfitonin në kohën kur ushtronin detyrën e gjyqtarit pranë atyre gjykatave, në respektimin e standardit kushtetues të paprekshmërisë së pagës për gjyqtarët e zgjedhur.

- Gjyqtarët që kanë ardhur nga radhët e juristëve të spikatur, sipas parashikimit pikës 4, të nenit 12 të ligjit 96/2016 "Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë", vjetërsia nuk ju llogaritet më shumë se mbi 15 vite punë, në ndryshim nga ata që zgjidhen nga radhët e magjistratëve. Formulë e cila është e diferencuar dhe nuk haset në asnjë nga praktikat evropiane. Në të gjithë legjislacionet e vendeve të Bashkimit Evropian, vihet re se përlllogaritja e pagës së gjyqtarëve, vjetërsia në detyrë parashikohet si pjesë e pagës, pavarësisht pozicionit të punës deri në një maksimum ligjor të parashikuar, i cili varion nga 20-35 vjet.

Ndryshimi ligjor ka ndikuar drejtpërdrejtë edhe në trajtimin me një pagë më të ulët të Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit të GJL, në raport me pagën e një gjyqtari të GJL, duke mbajtur parasysh që të dy këta drejtues zgjidhen nga radhët e gjyqtarëve të kësaj Gjykate, të cilët mund t'i përkasin kategorive që trajtohen financiarisht më pak se kolegët e tyre në të njëjtën gjykatë.

Sa më sipër rezulton se diferenca e pagës ndërmjet gjyqtarëve të GJL është e konsiderueshme dhe është në papajtueshmëri me kuadrin normativ ndërkombëtar, ku trajtimi financiar është pjesë e garancisë së pavarësisë së gjyqtarit.

Në ndryshimet ligjore të ligjit 96/2016 "Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë" me ligjin nr. 50/2021 të germës d, pika 5, të nenit 12 "shtesë për vështirësi pune, në masën 80 për qind të pagës bruto fillestare, për magjistratët që ushtrojnë funksionin pranë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Gjykatës së Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar", vihet re mospërfshirja e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, në lidhje me shtesën për trajtimin financiar të tyre, çka sjell cenim të konceptit të hierarkisë gjyqësore, pasi gjyqtari më i lartë që kontrollon vendimet e gjyqtarit më të ulët paguhet më pak se ky i fundit.

Të gjitha çështjet që gjykohen nga gjykatat e posaçme shqyrtohen në shkallë të fundit nga GJL, e cila në përbërje të saj ka edhe gjyqtarë që nuk i përkasin kategorisë së gjyqtarëve që vijnë nga gjykatat e posaçme. Pra, gjyqtarët që vijnë nga radhët e magistratëve të sistemit, ashtu edhe ata që vijnë nga radhët e juristëve të spikatur, mund të gjykojnë çështjet e gjykatave të posaçme, duke pasur një pagë më të ulët, në papajtueshmëri me nivelin hierarkik të gjyqësorit.

Gjithashtu, në nenin 13/1 të ligjit 96/2016, i ndryshuar me ligjin 50/2021, citohet se “ në rastet kur gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit të juridiksionit të zakonshëm delegohet për çështje të veçanta në gjykatën e posaçme *përfiton shtesë të reduktuar për vështirësi pune, por jo me shume se gjysma e shtesës sipas shkronjës "d" të pikës 5 të nenit 12 të këtij ligji*”, shtesë e cila rezulton në masën 40 për qind të pagës bruto fillestare.

Sa më sipër gjyqtarët e GJL, në zbatim të nenit 31 të ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” pika 1 ku citohet se “Gjykata e Lartë organizohet në Kolegjin Civil, Kolegjin Penal dhe Kolegjin Administrativ “dhe pika 3 “Kolegji Penal shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar për çështje penale” që bëhen pjesë e Kolegjit Penal, gjykojnë çështje të tilla, si dhe kanë të njëjtën vështirësi pune, nuk janë përfshirë në këtë rregullim ligjor, duke mos përfituar pagë të njëjtë dhe shtesë për vështirësi, sipas përcaktimit të këtij neni. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 27-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Në vijimësi të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 35, datë 22.11.2022, botuar në Fletoren Zyrtare me datë 09.01.2023, Gjykata e Lartë në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësorë të marrin masa për hartimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore mbi trajtimin financiar, sa më të drejtë dhe në masë sa më të përafërt të anëtareve të GJL, pavarësisht se nga cila gjykatë apo karrierë profesionale vijnë, me qëllim rekrutimin e gjyqtarëve më të mirë të vendit, në terma kohorë afatgjatë, duke garantuar ruajtjen e pavarësisë dhe misionit që ka Gjykata e Lartë, si gjykatë karriere.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërave të shpenzimeve rezulton se në Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës” nuk është pasqyruar dhe reflektuar ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën prej (1,186,359) lekë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika Llogaria 63 ”Ndryshimi i gjendjes së inventarit”.

Llogaria 63 ”Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Nga veprimet kontabël të bëra nga institucioni dhe të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare ndryshimi i gjendjes nuk është pasqyruara drejtë, duke mos dhënë efektin e ndryshimit në fondet neto të institucionit dhe rakordimin e pasqyrës së Formatit nr. 1 me Formatin nr. 2, veprimi i cili nuk ndikon në rezultat. Vlerë prej 1,186,359 lekë duhet të ishte pasqyruar si rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor në kolonën nr. 132, të Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 41-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masat në vijimësi për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim sa më të drejtë të pasqyrave financiare, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërave “Llogari të arkëtueshme” u konstatua se:

- Llogaria 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në vlerën 71,491 lekë, përbëhej nga detyrim i krijuar në maj të vitit 2013 të pagës së marrë nga një punonjës i larguar nga puna. Krijimi i detyrimit ka ardhur si rrjedhojë e urdhrin të ndërprerjes së marrëdhënies të punës, në të cilën shkëputja e marrëdhënies financiare ishte përcaktuar me fuqi prapavepruese. Nga ana e Institucionit për këtë vlerë nuk është proceduar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e tij, si rrjedhojë **ky detyrim është i paarkëtueshëm**, pasi ka humbur fuqinë ligjore, bazuar në nenin 203 pika 1 Kodi i Punës “Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet”, si dhe neni 115 Kodit Civil “Parashkruhen brenda afateve prej dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë”.

- Llogaria 409 “Parapagime” në vlerën 20,309 lekë, përbëhej nga detyrimi i krijuar para vitit 2009, si rrjedhojë e një pagesë më tepër ndaj “Shërbimit telegrafik”. Në lidhje me detyrimin bazuar në Kodin Civil, neni 114 “Afatet e parashkrimit” ku citon se “Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë” dhe neni 121 “Për kthimin e shumës së parave ose të sendit që është fituar ose kursyer pa shkak, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për fitimin ose kursimin pa shkak që ka realizuar personi përkatës” **ky detyrim është i parashkruar dhe i parkëtueshëm**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 41-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masat për sistemimin e këtyre vlerave, të cilat janë të parashkruara dhe të parkëtueshëm, me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të Institucionit.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore të lidhura me marrëdhëniet e punësimit në këtë institucion, si dhe njohjen e tyre në kontabilitet rezultoi se shumica e vendimeve gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer. Si rrjedhojë ky detyrim nuk është njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por është njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.

Me urdhrin shpenzimit nr. 192, datë 28.07.2021 është bërë ekzekutimi pjesor në shumën prej 213,870 lekë i vendimit gjyqësor të formës së prerë së Gjykatës së Apelit me nr. 31, datë 04.02.2021. Sektori i financës, pjesën e palikuiduar në shumën prej 1,044,269 të këtij vendimi nuk e ka paraqitur si detyrim të papaguar për vitin 2021, veprim në mospërputhje me Udhëzimin nr. 37, datë 6.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura”.

Paraqitje e drejte e këtyre detyrimeve duhet të ishte reflektuar në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në shumën prej 1,044,269 lekë në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021, por pa ndikim në rezultatin financiar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 41-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa në vijimësi, që pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit të plotë të titullit ekzekutiv, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatua se:

Me Urdhër shpenzimin nr. 406, datë 31.12.2021 është bërë pagesa e kontratës së mbikëqyrjes së punimeve të objektit të “*Rikonstruksionit të dhomës së serverit*” në shumën prej 372,000 lekë, si dhe është realizuar dhe procedura “*Mbikëqyrje punimesh për objektin Rikonstruksioni i dhomës së serverit*” në shumën prej 27,000 lekë pa TVSh, të cilat janë planifikuar në llogarinë 6022099 “*Shpenzime të tjera*”. Sa më sipër këto vlera të raportuar si shpenzime korrente, duhet të ishin planifikuar në zërin e investime kapitale dhe të kontabilizoheshin si rritje e vlerës së aktivit, referuar Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.2.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” pika 1 ku citohet se “*Mbikëqyrja e punimeve bëhet për çdo projekt dhe ka për qëllim kontrollin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh dhe anën ekonomike të tij*” dhe pika 2 “*Vlera e kërkuar nga subjekti konkurrues për mbikëqyrjen, duhet të përfshihet në tarifat e përcaktuara në përputhje me VKM 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë së qeverisjes së përgjithshme” Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 41-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për sistemimin kontabël të llogarisë 212 “*Ndërtime e konstruksione*”, duke e debituar këtë llogari me shumën prej 399,000 lekë.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës, për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve materiale afatgjata u konstatua se, janë reflektuar si aktive në përdorim (gjendje pune), aktivet e nxjerra jashtë përdorimi, pas miratimit të marrë nga KLGJ-ja përkatësisht me shkresat nr. 5718/11, datë 11.01.2021 dhe nr. 3023/1, datë 28.10.2021.

Konkretisht, në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2020, vlera të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi për llogarinë 218 “*Inventar ekonomik*” në vlerën 353,674 lekë, llogarinë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerën 1,202,930 lekë, dhe në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021, për llogarinë 215 “*Mjete Transporti*” në vlerën bruto 8,423,600 lekë, për llogarinë 214 “*Instalime Teknike makineri, pajisje*” në vlerën 319,800 lekë, duhet të ishin klasifikuar në llogarinë 24 “*Aktive afatgjata të dëmtuara*”.

Sa më sipër, veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” Paragrafi 103-109. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 41-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa në vijimësi, që pas miratimit të nxjerrjes së aktiveve jashtë përdorimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësorë të bëjë veprimet kontabël, duke kredituar llogarinë e aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimi dhe debituar përkatësisht llogarinë 219 “*Amortizimi i akumuluar i aktiveve afatgjata*” dhe llogarinë 24 “*Aktive te Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara*”.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i prokurimeve të fondeve publike u konstatua se:

- Regjistrat e parashikimi dhe realizimit nuk janë dërguar në organin qendror blerës, sipas afatit të përcaktuar në pikën 3, të Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021 “*Për hartimin e parashikimit të regjistratit të parashikimit të procedurave të prokurimit dhe regjistratit të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit publik*”, dhe nenit 3 “*Regjistri i*

parashikimeve të prokurimit publik” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Në regjistrat e realizimit nuk janë pasqyruar të gjitha kategoritë e mallrave e shërbimeve vlera e të cilave nuk e kalon shumën 100,000 lekë, pavarësisht se këto procedura nuk i nënshtrohen rregullave të prokurimit publik, veprime në mospërputhje me pikën 2, kreut II të Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021. Për periudhën 2020-2021, nga analiza e shpenzimeve në ditarin e bankës, grupi i auditimit konstaton se këto vlera të realizuar, ishin të pa pasqyruara në regjistrin e prokurimeve, Për periudhën deri me datën 30.09.2022, në regjistrin e realizimit kategoritë e mallrave e shërbimeve vlera e të cilave nuk e kalon shumën 100,000 lekë ishin të pasqyruara.

- Në lidhje me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, komisioni i blerjeve të vogla në disa procedurave nuk ka dokumentuar procesverbalet e kalimit nga një OE në një OE të renditur të dytin e kështu me radhë në momentin kur një OE tërhiqen nga procedura, veprime jo në përputhje me nenit 56, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 6 ku citohet se “... Kur ofertuesi i renditur në vend të parë tërhiqet nga oferta e tij ose nuk plotëson kërkesat e autoritetit/entit kontraktor, ky i fundit përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me radhë, deri në ofertuesin e renditur në vend të dhjetë. Këto veprime duhet të dokumentohen nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël”.

- Të gjithë procedurat e blerjeve të vogla të audituara nuk ishin të inventarizuara e për pasojë të arkivuara në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe nenit 21 “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” dhe me pikën 3 të nenit 16 të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe manualit të MFK miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 52-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Gjykata e lartë të marrë masat në vijimësi, që në çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël, të realizojë inventarizimin e dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, duke bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik fitues, sipas kriterëve të përcaktuara në ftesën për ofertë, me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listëpagesave u konstatua se, për pagesën shtese page për natyrë të veçantë janë trajtuar me “shtesë page për natyrë të veçantë pune” specialistët e IT-së, në vlerë 7,500 lekë në muaj, sipas miratimit të marrë nga Departamenti i Administratës Publike me shkresën nr 3467/1, datë 8.6.2021. Në shkresën e dërguar nga DAP për shtesë page “për natyrë të veçantë pune” specialistëve të IT-së nuk ka asnjë arsytim se pse kjo shtesë page është kategorizuar në vlerë 7,500 lekë në muaj dhe jo në vlerën 15, 000 lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave të TIK, të cilët punojnë me bazat e të dhënave shtetërore.

Gjykata e Lartë operon dhe administron “Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, ICMIS”. “Sistemin e Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, ICMIS” shfaqë/pasqyron ecurinë e çështjeve gjyqësore që prej regjistrimit deri në mbylljen e tyre me vendimmarrje, veprime të cilat replikohen/përditësohet **çdo ditë në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë akte, udhëzime, rregullore.** Referuar nenit 3 të ligjit nr. 10 325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” ku citon se a) “Baza e të dhënave shtetërore” kuptohet grumbullimi i organizuar i informacionit, i ruajtur në formë elektronike, ku përpunimi dhe përditësimi i tij kryhen nëpërmjet një sistemi kompjuterik, si pjesë e plotësimit të detyrimeve ligjore të institucionit administrues, si dhe nenit 2 të këtij ligji pika 2 ku citon se “Bazat e të dhënave shtetërore, që krijohen për të plotësuar vetëm kërkesat për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të institucionit publik, nuk i nënshtrohen këtij ligji”. Sa më sipër nga analiza dhe raportimi i të dhënave që bën ky sistem kemi të bëjmë me “Baza e të dhënave shtetërore”, të cilat nuk përfshihet në kategorinë e të dhënave të përcaktuara në pikën 2 të nenit 2, pasi këto të dhëna përditësohen për

publikun në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 27-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Nga Gjykata e Lartë të ribëhet kërkesë pranë Departamentit të Administratës Publike në lidhje me kategorizimin e trajtimit për “shtesë page për natyre të veçantë pune” për specialistët e IT-së, shoqëruar me një analizë të hollësishme në lidhje me përmbajtjen e sistemit dhe klasifikimin e tij si “Baza e të dhënave shtetërore”.

Në vijimësi

V. ANEKSE

Aneksi nr. 1: “Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit” nga faqja 17 deri 27 të Raportit.

Aneksi nr. 1/1: “PBA 2020-2022”.

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Fakt	Plani	Plani	Plani
		2019	2020	2021	2022
I	Shpenzime personeli	104,971	263,677	263,677	263,677
1	Paga	93,892	238,214	238,214	238,214
2	Sigurime Shoqërore	11,079	25,463	25,463	25,463
II	Mallra dhe shërbime të tjera	15,210	33,140	33,140	33,140
1	Mallra dhe shërbime të tjera	15,135	33,140	33,140	33,140
2	Transferta te Buxhetet Familjare dhe Individët	75	-	-	-
III	Shpenzime për investime	1,360	13,128	4,878	5,790
1	Shpenzime të pa trupëzuara	-	200	-	-
2	Shpenzime të trupëzuara	1,360	12,928	4,878	5,790
TOTAL		121,541	309,945	301,695	302,607

Burimi: Gjykata e Lartë, përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi nr. 1/2: “Parashikimi i PBA-së 2020-2022 për artikullin buxhetor 231”.

Në mijë lekë

Emërtimi i projektit	Buxheti Plan 2019	KËRKESAT VITI 2020	KËRKESAT VITI 2021	KËRKESAT VITI 2022
Pajisje elektronike	530	2,060	580	1,504
Pajisje- Mobilje të tjera	1,670	1,308	798	786
Rikonstruksion	1,620	2,000	-	-
Automjete	-	7,000	3,500	3,500
Pajisje sigurie	-	560	-	-
Totali shpenzimeve për investime viti PBA 2020-2022	3,820	13,128	4,878	5,790

Burimi: Gjykata e Lartë, përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi nr. 1/3: “PBA 2021-2023”.

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Fakt	Plani	Plani	Plani
		2020	2021	2022	2023
I	Shpenzime personeli	103,043	274,151	274,151	274,151
1	Paga	92,374	248,304	248,304	248,304
2	Sigurime Shoqërore	10,669	25,847	25,847	25,847
II	Mallra dhe shërbime të tjera	15,471	29,400	29,480	29,480
1	Mallra dhe shërbime të tjera	15,075	29,400	29,480	29,480
2	Transferta te Buxhetet Familjare dhe Individët	396	-	-	-
III	Shpenzime për investime	4,829	24,930	6,210	4,836
1	Shpenzime të pa trupëzuara	-	-	-	-
2	Shpenzime të trupëzuara	4,829	24,930	6,210	4,836
TOTAL		123,343	328,481	309,761	308,387

Burimi: Gjykata e Lartë, përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi nr. 1/4: “Parashikimi i PBA-së 2021-2023 për artikullin buxhetor 231, investime të brendshme”.

Në mijë lekë

<i>Emërtimi i projektit</i>	<i>Buxheti Fakt 2020</i>	<i>KËRKESAT VITI 2021</i>	<i>KËRKESAT VITI 2022</i>	<i>KËRKESAT VITI 2023</i>
Projekt	-	-	-	-
Pajisje elektronike	1,693	4,055	2,072	550
Pajisje- Mobilje të tjera	1,183	1,898	638	786
Rikonstruksion	-	18,644	-	-
Automjete	-	-	3,500	3,500
Pajisje sigurie	1,656	333	-	-
Totali shpenzimeve për investime viti PBA 2020-2022	4,532	24,930	6,210	4,836

Burimi: Gjykata e Lartë, përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi nr. 1/5: “PBA 2022-2024”.

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Fakt	Plani	Plani	Plani
		2021	2022	2023	2024
I	Shpenzime personeli	138,609	279,638	279,638	279,638
1	Paga	123,595	250,848	250,848	250,848
2	Sigurime Shoqërore	15,014	28,790	28,790	28,790
II	Mallra dhe shërbime të tjera		78,016	78,016	78,016
1	Mallra dhe shërbime të tjera	21,672	78,016	78,016	78,016
2	Transferta te Buxhetet Familjare dhe Individët	877	-	-	-
III	Shpenzime për investime	28,173	66,184	38,077	118,722
1	Shpenzime të pa trupëzuara	-	-	-	-
2	Shpenzime të trupëzuara	28,173	66,184	38,077	118,722
TOTAL		189,331	423,838	395,731	476,376

Burimi: Gjykata e Lartë , përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi nr. 1/6: “PBA-së 2022-2024 për artikullin buxhetor 231, investime të brendshme”.

Në mijë lekë

<i>Emërtimi i projektit</i>	<i>Buxheti Plan 2021</i>	<i>KËRKESAT VITI 2022</i>	<i>KËRKESAT VITI 2023</i>	<i>KËRKESAT VITI 2024</i>
Pajisje elektronike	2,890	18,243	1,238	974
Pajisje- Mobilje të tjera	2,220	7,591	6,838	117,748
Rikonstruksion	18,650	24,350	14,000	-
Automjete	-	16,000	16,000	-
Totali	23,760	66,184	38,076	118,722

Burimi: Gjykata e Lartë, përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi nr. 1/7: “Buxheti i vitit 2020 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2020-2022 faza strategjike”.

Në mijë lekë

Emërtimi	Kërkesa	Plani fillestar	Plani	Diferenca	
		PBA 2020-2022	i miratuar 2020	i rishikuar 2020	(Kërkesa-Plani i rishikuar)
Shpenzime operative (A)	Paga	238,214	180,000	97,200	(141,014)
	Sigurime	25,463	15,000	10,700	(14,763)
	Shërbime	33,140	24,000	21,123	(12,017)
	Transferta	-	-	403	403
Total (A)	296,817	219,000	129,426	(167,391)	
Shpenzime kapitale (B)	Investime	13,128	5,230	5,230	(7,898)
Total (B)	13,128	5,230	5,230	(7,898)	
TOTAL (A)+(B)	309,945	224,230	134,656	(175,289)	

Burimi: Gjykata e Lartë , përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi nr. 1/8: “Buxheti i vitit 2021 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2021-2023 faza strategjike”.

Në mijë lekë

Emërtimi	Kërkesa	Plani fillestar i	Plani	Diferenca
	PBA 2021-	miratuar 2021	i rishikuar	(Kërkesa-Plani i

		2023		2021	rishikuar)
Shpenzime operative (A)	Paga	248,304	180,000	142,000	(106,304)
	Sigurime	25,847	25,000	25,000	(847)
	Shërbime	29,400	26,000	25,856	(3,544)
	Transferta	-	-	907	907
Total (A)	303,551	231,000	193,763	(109,788)	
Shpenzime kapitale (B)	24,930	24,930	32,760	31,550	6,620
Total (B)	24,930	32,760	31,550	6,620	
TOTAL (A)+(B)	328,481	263,760	225,313	(103,168)	

Burimi: Gjykata e Lartë, përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi nr. 1/9: “Buxheti i vitit 2022 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2022-2024 Faza strategjike”.

Në mijë lekë

Emërtimi		Kërkesa	Kërkesa	Plani fillestar i miratuar 2022	Plani	Diferenca
		PBA 2022-2024, Faza I	PBA 2022-2024, Faza II		i rishikuar 2022, deri më 30.08.2022	(Kërkesa Faza II- Plani i rishikuar)
Shpenzime operative (A)	Paga	250,848	200,000	200,000	185,200	14,800
	Sigurime	28,790	25,000	25,000	25,000	-
	Shërbime	78,016	28,400	18,400	43,200	-14,800
	Transferta	-	-	-	-	-
Total (A)		357,654	253,400	243,400	253,400	-
Shpenzime kapitale (B)	Të trupëzuara	-	10,000	10,000	-	-
	Të patrupëzuara	66,184	58,050	58,050	39,050	19,000
Total (B)		66,184	68,050	68,050	39,050	29,000
TOTAL (A)+(B)		423,838	321,450	311,500	292,450	29,000

Burimi: Gjykata e Lartë, përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi nr. 1/10: “Realizimi i buxhetit të vitit 2020”.

Në mijë lekë

Programi “Buxheti gjyqësor” për GJL		Plani fillestar i miratuar 2020	Plani	Realizimi viti 2020	Realizimi kundrejt planit fillestar	Realizimi kundrejt planit të rishikuar
			i rishikuar 2020			
Shpenzime operative (A)	Paga	180,000	97,200	92,374	51%	95%
	Sigurime	15,000	10,700	10,669	71%	100%
	Shërbime	24,000	21,123	15,075	63%	71%
	Transferta	-	403	396	-	98%
Total (A)		219,000	129,426	118,513	54%	92%
Shpenzime kapitale		5,230	5,230	4,829	92%	92%
Total (b)		5,230	5,230	4,829	92%	92%
Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit		80	80	-	-	-
TOTAL (A)+(B)		224,310	134,736	123,343	55%	92%

Burimi: Gjykata e Lartë, përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi nr. 1/11: “Realizimi i shpenzimeve për investime”.

Në mijë lekë

Emërtimi i projektit	Plani vjetor	Plani vjetor i ndryshuar	Realizimi faktik	Përqindja e realizimit
Projekt	300	-	-	-
Rikonstruksion	1,000	-	-	-
Blerje pajisje elektronike	2,060	2,060	1,693	82%
Blerje mobilje pajisje	1,420	1,420	1,183	83%
Blerje pajisje sigurie	450	1,750	1,656	95%
Totali	5,230	5,230	4,532	87%

Burimi: Gjykata e Lartë, përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi nr. 1/12: “Realizimi i buxhetit të vitit 2021”.

Në mijë lekë

Programi “Buxheti gjyqësor” për GJL	Plani fillestar i	Plani	Realizimi	Realizimi %
-------------------------------------	-------------------	-------	-----------	-------------

		miratuar 2021	i rishikuar 2021		
Shpenzime operative (A)	Paga	180,000	142,000	123,595	87%
	Sigurime	25,000	25,000	15,014	60%
	Shërbime	26,000	25,856	21,672	84%
	Transferta	-	907	877	97%
Total (A)		231,000	193,763	161,158	83%
Shpenzime kapitale	Patrupëzuara	-	-	-	-
	Trupëzuara	32,760	31,550	28,173	89%
Total (B)		32,760	31,550	28,173	89%
Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit		50	50	-	-
TOTAL (A)+(B)		263,810	225,363	189,331	84%

Burimi: Gjykata e Lartë, përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi nr. 1/13: “Realizimi i buxhetit për periudhën Janar – Gusht 2022”

Në mijë lekë

Programi “Buxheti gjyqësor” për GJL		Plani fillestar i miratuar 2022	Plani i rishikuar 2022	Plani I periudhës 2022	Realizimi i periudhës	Realizimi %
Shpenzime operative (A)	Paga	200,000	185,200	145,200	110,404	76%
	Sigurime	25,000	25,000	18,100	13,321	74%
	Shërbime	18,400	43,200	34,200	21,518	63%
	Transferta	-	-	495	413	83%
Total (A)		243,400	253,400	197,995	145,656	74%
Shpenzime kapitale	Patrupëzuara	10,000	-	-	-	-
	Trupëzuara	58,050	39,050	38,050	6,483	17%
Total (B)		68,050	39,050	38,050	6,483	17%
Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit		50	50	50	-	-
TOTAL (A)+(B)		311,500	292,500	236,095	152,139	64%

Burimi: Gjykata e Lartë, përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi nr. 2: “Auditimi i llogarive vjetore” nga faqja 41 deri 52 të Raportit.

Aneksi nr. 2/1: “Aktivet qarkulluese”.

Në lekë

Nr.	Ref. Llogarive	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2020
2		I. Aktivët Afat shkurtër	20,467,198	14,810,022
3		1. Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	934,000	139,000
4	531	Mjete monetare në Arkë		
6	520	Disponibilitete në Thesar	888,000	9,000
8	532	Vlera të tjera (pulla)	46,000	130,000
11		2. Gjendje Inventari qarkullues	4,957,178	3,770,819
12	31	Materiale	4,461,512	3,314,661
13	32	Objekte inventari	495,666	456,158
21		3. Llogari të Arkëtushme	14,555,711	10,879,894
22	411	Klientë e llogari të ngjashme		
23	423-429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	71,491	71,491
24	431	Tatim e Taksa		
32	468	Debitorë të ndryshëm		
33	4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	14,484,220	10,808,403
36		4. Të tjera aktive afatshkurtra	20,309	20,309
37	409	Parapagime	20,309	20,309
41	486	Shpenzime të periudhave të ardhshme		

Burimi: GJL, përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi nr. 2/2: “Aktivet afatgjata”.

Në lekë

Nr.	Ref. Llogarive	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2020
42		II. Aktivët Afat gjata	114,488,615	90,144,879
43	20	1. Aktive Afatgjata jo materiale	0	0
47	21	2. Aktive Afatgjata materiale	114,488,615	90,144,879
48	210	Toka, Troje, Terrene		
50	212	Ndërtesa e Konstruksione	70,625,705	55,862,934
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	9,262,141	10,624,794
53	215	Mjete Transporti	17,543,083	5,094,613

54	216	Rezerva Shtetërore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	17,057,686	18,562,538
57	24	Aktive afatgjata te dëmtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
62		4. Investime	0	0

Burimi: GJL, përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi nr. 2/3: “Pasivet Afatshkurtra”.

Në lekë

Nr.	Ref. Llogarive	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2020
67		1. Llogari te Pagueshme	15,464,020	10,909,203
68	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	576,632	608,462
69	42	Detyrime ndaj personelit	9,516,162	5,862,539
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,547,105	2,436,808
75	435	Sigurime Shoqërore	1,516,607	693,724
76	436	Sigurime Shëndetësorë	1,037,762	1,013,401
77	437	Organizma te tjerë shtetërore	289,952	193,469
81	466	Kreditore për mjete ne ruajtje	888,000	9,000
82	467	Kreditore te ndryshëm	0	
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	91,800	91,800
84	49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)		

Burimi: GJL, përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi nr. 2/4: “Pasivet Afatshkurtra”.

Në le

D	FONDI I KONSOLIDUAR :	119,491,793	94,045,698
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti i akumuluar	118,305,434	94,150,097
12	Rezultatet e mbartura		
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	1,186,359	-104,399
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta te investimeve		
E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	134,955,813	104,954,901

Burimi: GJL, përpunuar nga grupi i auditimit

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

